



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja I / 2025 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 27 shkurt 2025, filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 30 anëtarë të Kuvendit të Komunës, u bashkëngjitën edhe anëtarë të tjerë.

Të pranishëm në mbledhje ishin, Nënkrjetari dhe Drejtorët Komunal.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit e medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuar anëtarë të kuvendit, i nderuar nënkryetar i komunës zotëri Gashi, i nderuar zëvendëskryesues, drejtor, media, ojç, të gjithë ju të pranishëm, përshëndetje. Për të gjithë, për sot siç jeni të njoftuar me kohë kemi thirrur mbledhjen e parë të rregullit të kuvendit për vitin 2025. Të pranishëm jemi 30 anëtarë të kuvendit, ku konstatoj se kemi kuorum për me i vazhdu punimet e seancës. Pas shqyrtimit të rendit të ditës nga Komiteti për Politikë dhe Financa është rekomanduar ky rend dite.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 19 dhjetor 2024 (mbledhjes së rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ‘‘Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit’’ sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Planit për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e ‘‘Muzeut të Nënës Terezë’’ në Prizren;
8. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2024;
9. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
10. Raporti vjetor për planin e Integritetit për vitin 2024;
11. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2024;

- Komitetit për Politike dhe Financa,
 - Komitetit për Komunitete.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e ndarjes së mjeteve në përqindje për projektet bashkëfinancim me fermerë në Komunën e Prizrenit;
 13. Diskutim për mundësinë e subvencionimit të dëmit të shkaktuar nga fishekzjarrët në fund vit.

Këto pra janë pikat e rendit të ditës. Po kalojmë me pikën e parë.

Pika e Parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 19 dhjetor 2024 (mbledhjes së rregullt):

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Sa i përket procesverbaleve, a ka dikush diçka, ndonjë koment, ndonjë vërejtje? Në qoftëse jo atëherë po e hedhim në votim pikën e parë, prezent jemi 32 anëtarë. Kush është për që të miratohen procesverbalet? 31 jemi për, kundër a ka? 0 kundër. Abstenim? 0 abstenim. Atëherë miratohet pika e parë. Faliminderit.
Kalojmë te shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Pika e Dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës:

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka dikush diçka rreth rendit të ditës? Nëqoftëse jo atëherë po e hedhim në votim. 32 jemi prezent, kush është për që të miratohet rendi i ditës? 31 jemi për. Kundër a kemi? 0 kundër. Abstenim? 0 abstenim. Ju faleminderit gjithëve.
Kalojmë te pika e tretë, pyetje e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

Pika e Tretë

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme:

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë ju lutem ta kërkonit fjalën me rradhë, po Agim Muçaj dhe kisha kërkuar nga të gjithë kolegë kuvendar ta respektoni kohën prej dy minutash.

Agim Muçaj (AAK): Përshëndetje kryesuese, ekzekutiv, të nderuar kuvendar, media, qytetarë të nderuar. Unë sot para jush do të filloj me kërkesën e parë apo një vërejtje për drejtorinë e shëndetësisë, pikërisht zotëri Simir Krasniqin, e dimë që jeni veç një vit si mandator apo drejtor i kësaj drejtorie. Mirëpo nga kërkesa e bashkisë lokale në Korish, e cila është dërguar më 19.4.2023, një kërkesë e cila ka të bëjë me emërimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Korish. Kjo kërkesë nuk e di a të ka rënë në dorë dhe apo e keni parë apo nuk e di, sepse e di që jeni veç një vit në funksion. Kështu që kërkesa e bashkisë lokale është që kjo që qendra e mjekësisë familjare të emërohet me profesor doktor Zenel Kabashin. Besoj që për ju kuvendar të nderuar dhe ekzekutiv për profesor doktor Zener Kabashin. Besoj që për sot nuk ka nevojë që të flas më shumë, vetëm se që kam sjell një kërkesë që ta keni si dëshmi. Ju lutem kisha kërkuar që ta dimë shkaktarin sepse e dimë që veç e keni prur tabelën edhe e keni vendosur në objekt. Dhe kërkoj që të marrim një sqarim publik dhe e dyta rreth këtij objekti kërkoj nga ju në bazë të planit dinamik që keni kur pritët të funksionalizohet. A jeni të përgatitur edhe për stafin i cili do të jetë sipas projektit i cili është bërë kërkesa dhe ndërtimi i kësaj QMF-je. Faleminderit. Kurse për drejtorinë e turizmit,

zotërinj Tarashaj rreth projektit të ujvarët e Korishës, aty është bërë me të vërtetë një investim, ku për të cilën duhet të falendrojmë ju dhe të gjithë komunën. Mirëpo sigurisht se ndoshta është bërë ndonjë gabim, sepse aty vijnë me qindra familjarë, organizime të ndryshme, e dimë që aty kanta të bërllotut nuk ka, edhe ajo çka është më e keqe dhe esenciale, vc publike nuk ka, ku gravitojnë pra shumë njerëz nga Prizreni, Kosova dhe anemban, ndoshta edhe Ballkanit. Kështu që kisha kërkuar që para sezonit deri në muajin maj të rregullohet kjo çështje. Faleminderit. Edhe një sekond. Për njeriun dhe drejtorin i cili e ka dhe kuletën më të madhe zotëri Çel Lamaj. Kemi në një lagje në Korishë, lagjen më të vjetër do të thotë në fshatin Korish ku ka problem me kanalizimin e ujrave të zeza ku është njëme një diametër shumë të vogël, i cili është vendosur para 50-60 vitesh dhe kërkojmë që të futet në projekt buxhet të këtij viti apo në qoftë se është e mundur këtë vit që jo, sëpaku në vitin e ardhshëm. Duhet që të vazhdoj njëjtë, mendoj se do t'i përket drejtorisë së juaj në vazhdim, këtë vit e di që ndoshta mundësitë janë të vogla, mirëpo që të rregullohet komplet infrastruktura e ujëvarave për të cilët veç është investuar mjaft deri tash, dhe që të arrijmë qëllimin që së paku të rregullojmë edhe rrugën me asfalt apo së paku me kubëzim dhe të bëhet elektrifikimi i komplet kësaj dhe që të kompletohet ky projekt i cili deri tash me të vërtetë ka arritur një dinamikë për gjithë qytetin dhe Kosovën. Ju faleminderit zotëri drejtor.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Muçaj. Ju lutem që ta përfshini kohën prej dy minutash të jeni pak më të shkurtër në kërkesat e juaja. Shqipe Shatri fjalën e ka.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit kryesuese. Kërkesën e parë i adresoj Drejtorisë së Shëndetësisë. I nderuar drejtor zotëri Krasniqi, kërkoj nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF me organizu në shkolla disa aktivitete duke ofruar këshilla dhe kontroll për nxënësit lidhur me shëndetin oral, përkujdesin dhe shëndetin e dhëmbëve. Është mirë që në një të ardhme të afërt në bashkëpunim me DKA-në, t'i pajisni të gjitha shkollat me kabinetet dentare që do të ofrojnë shërbime stomatologjike për nxënësit. Gjithashtu i nderuar drejtor, në qendrat e mjekësisë familjare ju lutem të kërkonin nga personat përgjegjës të kenë më shumë mbikëqyrje, përkushtim në punë e në veçanti për t'i dhënë më shumë rëndësi higjenës në institucionet shëndetësore. Faleminderit. Ndërsa kërkesën e dytë ja drejtoj Drejtorisë së Shërbimeve Publike. I nderuar drejtor zotëri Lamaj, porsa ta kalon shkollën e mesme në fshatin Romaj të Hasit, e para rrugë majtas të qon të një puntori konkretisht në biznesin e rrobaqepësisë të udhëhequr nga gratë. E që tani për rreth saj ka dhe shtëpi banimi, pra është ndërtuar një lagje e re. E fatkeqësisht rruga e cila te shtëpie te kjo lagje nuk është në gjendje të mirë. Pra nuk është asfaltuar dhe gjithashtu ka nevojë të investohet në kanalizime. Kjo rrugë nuk ka edhe aq shumë kilometra dhe mendoj që nuk do një kosto të madhe për investim. Shpresoj dhe nuk dyshoj që këtë kërkesë do ta realizoni, ngase të gjithë kemi për qëllim mirëqenien e qytetarëve e sidomos në këtë rast për t'i dhënë në veçanti përkrahje dhe mbështetje bizneseve të udhëhequra nga gratë. Faleminderit për mirëkuptim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Shatri, Bajram Kastrati fjalën e ka kërkuar.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje ekzekutiv, kolegë kuvendarë. Pyetje për drejtorinë e urbanizmit. A kemi të angazhuar një operator për vendosjen e tabelave për emërtimin e rrugëve? Apo e keni paraparë ndonjë procedurë në lidhje me këtë? Në anën tjetër kam një kritikë për drejtorinë tuaj i nderuar drejtor. Në emër të komisionit për emërtimin e rrugëve, në lidhje me neglizhencën e çështjes të emërimit të rrugëve dhe shesheve pasi që ne si komision, i formuar nga kuvendi, vazhdimisht ju kemi ofruar mundësi bashkëpunimi t'i ndihmojmë procesit

në atë që kemi mundësi ligjore. Siç janë emërtimet e rrugëve të reja, plotësimi i listës rezervë, përmirësimi i gabimeve në tabela etjera, por jemi të pakënaqur me angazhimin tuaj jo serioz. Për Drejtorinë e Kulturës, i nderuar drejtor memoriali i dëshmorëve në Landovic, nuk është duke u mirëmbajtur. A mund ta dimë se pse? Gjithashtu edhe lapidari i dëshmorëve dhe martirëve në Arbanë ka nevojë për renovimin e pllakave pasi që shumë nga ato janë të dëmtuar dhe të demoluara. Lapidari i Xhavit Elshanit, Lopardit në Piranë ka nevojë për një rrethojë që të ruhet nga kafshë të ndryshme që qarkullojnë dhe mund ta dëmtojnë. Për drejtorinë e inspektoriatit, i nderuar drejtor në shumë rrugë brenda qytetit hasim në pengesa në lëvizje me automjete nganjëherë edhe në këmbë. Shkallët e vendosura jashtë objekteve, prezantimi i produkteve dhe gjësendeve në trotuare po bëhen edhe pengesë për lëvizje dhe sigurisht që po duken pamja jo e mirë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Kastrati. Tajar Susuri fjalën e ka kërkuar.

Tajar Susuri (LVV): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Kam disa kërkesa për drejtorin Çel Lamaj dhe disa pakënaqësi nga banorët e Lumës dhe Vrinit. Tek rruga e Hoqës që lidhet me lagjen TUsuz, është krijuar një hendek ose një gropë e cila po vështroi komunikacionin e banorëve të Hoqës dhe anasjelltas. Trotuari nga nënkalimi deri te shkolla e fshatit Vlashnjë së bashku me ndriçimin publik, aty punimet kanë daluar, ka më shumë se 1 vit. Si drejtor, a mund të na thoni se kur do të përfundojnë këto punime? Unë kam disa kërkesa, kam bërë disa kërkesa për vendnalime të autobusëve dhe për këto janë bërë shumë pak nga ana juaj drejtar. Janë vendosur disa kabina për pritjen e autobusëve dhe kemi nevojë edhe për pesë copë të tjera. Po t'i përmendim me emra. Një copë na duhet në udhëkryqin e Vlashnjë- Poslisht, dy copa të tjera në fshatin Shkoz dhe dy të tjera në fshatin Vërmicë. Shumë herë edhe këtë herë po e potencoj për ndriçimin publik në Zhur. Tash po vjen edhe muaji i shenjtë i Ramazanit, ndriçimi publik në Zhur është i gjymtuar. Edhe pse i keni vendosur disa poqe nuk mjaftojnë për Zhurin. Zhuri i ri s'ka ndriçim, lagjja Gorishta, aty nuk ekziston ndriçimi dhe shumë lagje të tjera brenda në Zhur s'kanë ndriçim. I bie që vetëm rrugët kryesore janë vendosur poçat. Gjithashtu edhe sheshi i dëshmorëve është në terr drejtor. Është mirë të merrni masa për këtë komunitet. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit e zotëri Susuri. A ka anëtarë të tjerë të cilët dëshirojnë me marrë fjalën? Zonja Ymran Fusha, Egzona, pastaj Selman.

Ymran Fusha (PDK): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për të gjithë, ekzekutivin, koleg kuvendar dhe mediat. Një faleminderit të veçantë shkonë për drejtorin e shërbimeve publike, drejtor Qelë Lama, faleminderit për masa që keni marrë për realizimin e kërkesave. Drejtori i Kulturës, drejtor kam bërë një kërkesë, ku jeni me atë kërkesën se kur do të filloni me realizimin e terrenit sportiv në Bajër të Kurillës, edhe mbasi që kryetari s'është atëherë për nënkryetarin shkon një kërkesë brenda mundësive. Nënkryetar për nder të festave fetare dhe shtetërore udhëtimi i qytetarëve të jetë pa pagesë me autobusa urban. Domethënë nuk kushton kjo shumë është një vendim, ju do të merrni atë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Fusha. Fjalën e ka Egzona Hoxhaj, përgatitet Selman Sokolaj.

Egzona Hoxhaj (PDK): Faleminderit e nderuar kryesuese, i nderuar nënkryetar, ekzekutiv, koleg kuvendar, media, shoqëria civile, të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit. Unë i kam me i

paraqit disa shqetësime konkretisht për fshatin Bregdri. Drejtori i shërbimeve publike, kërkesa realisht është prej juve për shkak që prej banorëve kam marrë kërkesë që ka nevojë për intervenim në infrastrukturë brenda asaj zone, ku rrugica brenda atij fshati ka afër rreth 1 km. Në të njëjtën kohë mungon ndriçimi publik, po nuk kanë as trotuar, përgjatë rrugës kryesore ku fëmijët vazhdimisht janë të rrezikuar gjatë kohës kur shkojnë në shkollë. Gjithashtu kërkesa e fshatit Bregdri është që të rregullohet edhe një fushë sportive brenda hapësirës së shkollës. Në të njëjtën kohë kërkesë tjetër është për lagjen Cakaj ku gjendja brenda lagjes është në një gjendje goxha të mjerueshme edhe kërkoj që drejtor brenda një afati i caktuar me dërguar një ekip atje me pa dhe me u bë intervenimi i nevojshëm. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Hoxhaj. Fjalën e ka Selman Sokolaj, përgatitet Sevil Kazaz.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Unë po e nisi me një rast që mbase nuk ka të bëj direkt kështu me punën tonë, mirëpo është e ndërlikuar, ka të bëjë me është i përfshirë këtu kryetari i komunës. Në Kosovë domethënë të gjithë jemi dëshmitarë që gjyqësori është shumë neglizhent edhe rastet presin me vite të tëra për t'u zgjidhur edhe për të filluar një rast nëse bëhet një padi nëse ndodh diçka edhe për t'u zgjidhur. Mirëpo, e kemi një rast të çuditshëm ku kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj ka pretenduar që është fyer prej një qytetari në bazë të një postimi. Një pushtetari i PDK-së, po ndihet i fyer nga një qytetar i rëndomt, mbase mund të ketë bindje politike, por është megjithatë një qytetar i komunës së Prizrenit. Edhe padija, ajo çka është interesant këtu është padija e kryetarit të komunës së Prizrenit trajtohet në kohë record! Domethënë ne gjithë jemi dëshmitarë që prej pas luftës ka vonesa të jashtëzakonshme në rastet gjyqësore. Mirëpo padija e kryetarit të komunës së Prizrenit nuk merr tri javë kohë, që edhe avokatët që kanë më së shumti raste në Kosovë janë habitur me këtë shpejtësi. Kështu që si qytetarë, si assembleist edhe i kisha kërkuar këtu këshillit gjyqësor që të interesohet te kryetari i gjykatës në komunën e Prizrenit edhe gjyqtari që e ka rastin konkret të Shaqir Totajt, se si është e mundur në një vend ku lëndët presin me vite të tëra, ajo për kryetarin për një pushtetar të PDK-së, të vihet në shprehje në një afat rekord. Tjetra ka të bëjë me bordin për mbikqyrjen dhe dhënien në shfrytëzim të objekteve kulturore sportive në Prizren. Ne e dimë që e kemi një rregullore, mirëpo drejtorit i kulturës në një moment këtu na ka thënë se ne investojmë edhe ne do të vendosim çka do të bëjmë me to. Kemi dëgjuar, kemi parë raste që mbase edhe nuk ka, mirëpo është folur nga kolega asambleistë që drejtorja ka dhënë disa objekte kulturore sportive në shfrytëzim. Edhe kishte qenë mirë auditori me i audituar ato nëse ka raste të tilla. Këtë kryesuese do ta bëjë edhe me shkrim, për shkak se ta evidentojmë a ka shkelje ligjore, a është respektuar bordi që jemi si kuvend komunal. Për drejtoreshën e emergjencave zonjën Ramize Shala. A ka raste të zjarreve në 2024-ën ose në 2025-ën, po në 2024-ën e tutje, që komisionet përkatëse i kanë vlerësuar që ka nevojë për dëmshpërblim, për shkak se ne e dimë që ekzistojnë rregullore që ekonomitë familjare, mbase edhe bizneset, kur kanë raste, kur kanë ndonjë fatkeqësi, atëherë komuna e bën një kompensim në shumë të caktuara të parave, qysh e parashikojnë rregullat. Domethënë pyetje është a ka raste edhe a i keni kompenzuar pronarët e objekteve të dëmtuara. Një problematik tjetër ka të bëjë me nxemjen në fshatin Gjonaj, në shkollën e fshatit Gjonaj. Kam pasur ankesa nga tre burime të ndryshme edhe prej punëtorëve, edhe prej prindërve, edhe prej nxënësve që në Gjonaj, në një pjesë të shkollës, nuk ka mjaftueshëm nxemje edhe ajo shkakton tani probleme të tjera të mësimi. Është edhe një vendim i çuditshëm qysh Këshilli i prindërve, mbase drejtoresha është shumë e vëmendur që e ka vërejtur. Këshilli i prindërve paska kërkuar prej drejtorisë me i shkurtu orarin e mësimi. Diçka kështu e habitshme,

e çuditshme! Edhe drejtoria në shkollën Gjonaj ka shkurtuar orarin e mësimi. Paska bë mësim dimëror, se paska mësim edhe dimëror edhe veror. Një zbulim kështu! Drejtoresh, a je në dijeni edhe a ke marrë masën për këtë? Për shkak se është skandal definitivisht, nuk është me qesh kjo. Domethënë me kërkesë të prindërve po e shkurtuam orarin e mësimi. E fundit kryesuese 10 sekonda. Ndriqim publik në kohë të fushatës zgjedhore për zgjedhjet nacionale, kanë filluar goxha shumë në komunën e Prizrenit, u kryen zgjedhjet. Shpresojmë që do të vazhdojnë punimet. Unë po flas konkretisht për rastin në fshatin Krajk. Në fshatin Krajk janë hapur disa gropa ku është bërë bazamenti që do të futen shtyllat. Mirëpo një kërkesë që e kam bërë për qasjen në dokumente zyrtare, më është kthyer përgjigje nga zyrtarët, e përmes këtyre drejtorisë shërbimeve publike, që poçat elektrike do të vendosen në shtylla elektrike. Kam qenë në vend të ngjarjes, kam bërë disa fotografi, aty paralelisht janë hap bazament për vendosje të shtyllave, veç janë hap bazamentet, ndërsa në përgjigje thotë nuk ka, se kam kërkuar koordinata kur do të vendosen ato për shkak se duhet me pas një planifikim ku të vendosen. Mundesh me i pengu dikujt ose mundet mos me qenë rasti më i mirë kur e vendosni shtyllë. Përgjigja e drejtor ka qenë kjo. Ka ndodhur një gabim ose çka është puna të lutem na e sqaro. Faleminderit. Shumë faleminderit kryesuese, po je e vëmendshme ndaj meje kështu!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Sevil Kazaz përgatitet Petrit Hoxha.

Sevil Kazaz (YTHP): 23:04 – 24:43 min.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Kam një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike. Drejtor ka që dy kërkesa jemi duke i bërë për largimin e deponisë që është duke krijuar në mes fshatit Muradem dhe Vlashnje. Kërkoj që mbasi veç ke filluar do të thotë me këtë fushatë të rregullohet edhe kjo dhe të pastrohet sepse me të vërtetë nuk është faj i komunës, por është faj edhe i vetë qytetarëve dhe i vetë banorëve të cilët i krijojnë këto deponi. Ndërsa tjetra, ka të bëjë me drejtorinë e bujqësisë, drejtor të përgëzoj për fillimin e ndërtimit të strehëmorës. Me të vërtetë qyteti i Prizrenit ka pasur nevojë për një ndërtim të tillë sepse, sepse qentë endacakë veç filluan në të gjitha lagjet e komunës tonë dhe shpresoj që ky ndërtim të përfundojë brenda këtij viti dhe më nuk do të shohim qentë endacakë në sheshin e Shatërvanit apo edhe në lagje të tjera. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit e zotëri Hoxha. Fjalën e ka Islam Thaqi, përgatitet Faruk Tahiri.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë e ripërsëris një kërkesë time që e kam bërë në seancën e parafundit, kam kërkuar nga drejtoria e inspektorateve, drejtoria e shërbimeve publike, që të ndërmerret një aksion për largimin e veturave nga hapësirat publike, që nuk kanë regjistrime edhe nuk janë në gjendje për qarkullim. Edhe atëherë, edhe tashmë e përsëris, aksioni duhet të bëhet në bashkëpunim me policinë. Ngase sot, vetëm në parkingun mbrapa kësaj shtëpie, në parkingun publik, diku i numrova mbi tetë vetura janë që nuk kanë regjistrim edhe zënë hapësirat për parking për qytetarët. Pyetje e dytë apo shqetësimi i dytë është për drejtorinë e kulturës. Drejtor, e dijmë që një pjesë bukur e madhe e fshatrave tanimë kanë shtëpi të kulturës. Mua më intereson se kush është bartës i shpenzimeve të të pagesës komunale, rrymës e të tjera në këto shtëpitë e kulturës, ngase kam një shqetësim apo një informacion që njëra shtëpi e kulturës me njërin fshat keqpërdoret, është hapur një lokal. Me

sa di unë nuk është në qiradhënje. Kështu që kërkoj nga ju që të dilni edhe t'i inspektoheni më shpesh. Pata edhe disa pyetje për kryetarin por meqënëse nuk është këtu, nuk e kam në praktikë t'i adresoj pa qenë prezent. Ju faleminderit.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese, të nderuar kolegë kuvendar, të nderuar ekzekutiv, media, qytetarë të nderuar. Unë kam dy pyetje, një për drejtorinë e financave dhe një për drejtorinë e shërbimeve publike. Unë po e bëj pyetjen, po shoh që drejtori s'është këtu, po besoj që në seancën e radhës ose kur të vjen mund me më dhënë përgjigje. Pyetja është në këtë raport sa është borxhi i komunës ndaj operatorëve ekonomikë? Edhe pse kjo praktikë e marrjes së mjeteve nga operatorët ekonomikë që kanë kryer shërbimet ndaj komunës me përmbaruës dhe me procese gjyqësore dhe jo në mënyrë të tregut. Vetëm në vitin 2023 kemi pasur mbi 4 milion euro ekzekutim përmbarimor nga buxheti i komunës edhe i dimë cilat janë tarifat e përmbaruesve dhe sa mund të ketë humbur komuna me këto ekzekutime. Prandaj, unë e nderuar kryesuese, kisha pasur dëshirë me marrë një përgjigje prej drejtorit edhe me shkrim nëse ka mundësi ja përcjellni. E dyta, sa i për të parkingjeve drejtor, u bën katër vite qeverisje dhe hala nuk kemi një rregullim të parkingjeve në komunën tonë, kanë filluar të vizatohen disa parkingje në rrethin e parë, në unazën e parë të qytetit. Po ajo që është shqetësuese shumica e qytetarëve nëpër lagje të ndryshme po marrin dënime të shumta nga policia e Kosovës për parkingje të palejuara edhe unë mendoj që nuk është faj i qytetarëve që parkojnë në mënyrë të palejueshme në lagjet e tyre, po është faj i komunës që nuk i krijon shërbimet qytetarëve. Pa marrë parasysh, mund të bëhen ato me pagesë ose pa pagesë parkingjet, po qytetarët do të duhet ta ketë hapësirën ku ta lë veturën dhe mos merr dënime nga policia për shkak të mossërbiimit ose mos kryerjes së punës nga komuna. Gjithashtu i nderuar drejtor, në kuvend ka kaluar dhe është miratuar rregullorja për taksitë. A ka mundësi me e ditë numrin e taksive që janë regjistruar sipas rregullores së re deri më tash. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zoti Tahiri, po zotëri Shukri Quni, pastaj Shukrije Berisha.

Shukri Quni (Nisma): Po më jep përparësi pak se pak më i vjetër jam. Faleminderit Kryesuese, përshëndetje kolegë kuvendarë. Kam për Drejtorin e Shërbimeve Publike. Drejtor unë shikova do pastrime të mbeturinave që jeni duke i bërë nëpër deponitë e egra, ku në fakt aty s'jen fajtor ju, janë ato kompani të cilat i hudhin ato mbeturina. Edhe në Nashec kërkoj se kemi edhe ne aty një deponi që po hudhen bërllloge, materiale të forta. Kisha kërkuar që t'i pastroni edhe aty disa vende, pasi po pretendojmë me bë fshat turistik. Poashtu megjithëse këtu ka punë inspektoriati për këto punë, ata duhet me i kryer. Drejtor, është bërë dhe vendosja e shenjave të komunikacionit në disa fshatra, s'po i cekim ku, po kanë ardhur deri në mexhë në Nashec edhe nuk kanë vazhduar. A do të vazhdohet edhe nëpër fshatra të tjera, mirë është me u vazhduar shenja sidomos ku ka nevojë aty para shkollës, edhe të gjitha fshatrat kanë nevojë para shkollave me i vendosur shenjat. Po ripërsëris prapë një rikërkesë, është fjala për ndriçimin në fshatin Nashec drejtor. Kjo u bë veç goxha tepër kjo kërkesë, besoj që ndoshta kryhet. Kërkoj edhe të pastrohen shkurret apo lluga t'ju them bash me kuptu më mirë, rreth rrugës po Nashec, pastaj vazhdon rruga për Kujush, edhe rruga Nashec-Tupec. Kush kalon aty pari s'ka mundësi me kaluar prej degëve dhe prej llugëve që është zana dhe rruga. Për Drejtorinë e Arsimit, deri ku ka arritur përgatitja për tenderimin e rregullimit të kulmit të shkollës fillore Luigj Gurakuqi në Nashec dhe kërkoj që të mirret parasysh sa më shpejtë sepse nëse nuk e rregullojmë kulmi është kah dëmtohet edhe më shumë. Drejtorja për Kulturë, kërkoj që të rregullohet një fushë e sportit në fshatin Nashec për rininë e fshatit sepse ajo

pos që e shpëtojmë rininë e shpëtojmë edhe nga uzurpatorët një pjesë ku pretendoj unë me rregulluar aty, se vendi është i rrafshët veç që ja keni bërë gati tash edhe me qu me hedh mbeturina aty, po të tregoj para kohë, nëse nuk e shfrytëzojmë atë. Edhe drejtor çështja e lapidarëve, kërkoj edhe këto të mirëmbahen sepse ta kam bërë një kërkesë shumë herë, po tani jam detyruar me ta bërë edhe përmes Kuvendit Komunal. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Quni, fjalën e ka Shukrije Berisha.

Shukrije Berisha (Nisma): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Kërkesë drejtuar Drejtorit të Shërbimeve Publike. Drejtor, në emër të timin dhe banorëve të lagjes Xhavit Bajraktari, ju falenderojmë për kubëzimin e trotuareve të kësaj lagjeje, mirëpo banorët e kësaj lagjeje kanë një shqetësim lidhur me vendosjen e disa shtyllave të vogla në trotuare. A ka qenë projekt apo është kërkesë individuale e ndonjë banori të kësaj lagjeje? Poashtu drejtor, në vazhdimësi kam bërë kërkesë edhe për kubëzimin e trotuareve të lagjes Vëllezërit Dehiri, banorët e kësaj lagje duan të dine se a do të vazhdojnë punimet edhe në këto lagje, pra kubëzimi i trotuarve të kësaj lagjeje. Poashtu, kërkesë që nga muaji korrik i vitit të kaluar është bërë nga banorët e lagjes Emin Shehu lidhur me ndriçimin dhe ende nuk është ndërmarrë asgjë drejtor, ku qëndron problemi që ende nuk po realizohen këto kërkesa të kësaj të këtyre banorëve. Poashtu, edhe në lagjen Vëllezërit Dehiri ka mungesë të ndriçimit në disa shtylla. Ju lutem drejtor që t'i merrni seriozisht kërkesat e këtyre banorëve. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Berisha. A ka anëtarë të tjerë apo po kalojmë te pjesa, po Brikena?

Brikena Karavidaj (LDK): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje të gjithëve. Kam dy kërkesa të cilët i kanë shprehur banorët e fshatit Zym, të cilët kanë probleme me dy çështje. Çështjen e transportit edhe mjekun familjar. Ky fshat është pa linje të transportit, ku personat janë të obliguar që gjatë ditës të qarkullojnë në qytetin e Prizrenit me lloj-lloj transporti, duke përfshirë këto edhe kamionat të cilat punojnë me bartjen e madrave. Pra, kërkoj që sa më shpejtë të bëhet një zgjidhje për për ta. Dhe çështja e dytë është që po ashtu banorët kanë pakënaqësi me çështjen e shëndetësisë se nuk kanë ku të drejtohen për vizita familjare ose çfarëdo. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Karavidaj. Por urdhëro Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit Kryesuese, të nderuar ekzekutiv, kam një pyetje lidhur me Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Drejtor parku tek Marashi, ulëset i ka të demoluara thujse të gjitha. Ju kisha lutë ta bëni meremetimin e atyre por jo të vendosni ulëse që kushtojnë 1700 euro, mundësisht diçka më modeste. Edhe mirë është me, po më shtrenjtë është 1700 që se 99, po thash. Sa i përket Drejtorisë së Inspektoriateve, dua të informohem se a janë ndalë punimet e kolegut tuaj të Drejtorisë së Kulturës ku po punon pa leje? A keni reaguar si inspektoriat? Edhe sa investime kapitale do të vazhdoni me i bë pa leje ndërtimore edhe a po ju vjen marre me dal këtu edhe me reaguar edhe, qysh çka është ky fjalor? A po ju pengon me ju pyet apo ju vjen marrë që po punoni, pa leje? Po duhet me ju ardhë marrë që po punoni pa leje, se janë investime kapitale, investime kapitale të cilat janë në shërbim të qytetarëve. Qetësohu, pi pak ujë...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtor, ju lutem jep përgjigje mandej, drejtor ta dëgjojmë kolegën.

Dafina Alishani (LVV): Qetësohu, numëro deri në tre se kjo arogancë kur kërka nuk të qon kjo arrogancë. E kam të drejtën me pyet, qysh ka mundësi Drejtoria e Kulturës me investu pa leje ndërtimore? Si ka mundësi që secilën herë unë duhet me e ngritur këtë shqetësim, secilën herë çohet drejtori thotë nuk është e vërtetë edhe del që nuk ka leje! marre është kjo me u bë. Edhe nuk e di qysh qysh keni mundësi hala me buzëqesh! Duhet me dal me i kërkuar falje qytetarëve. Me thënë për interesa të mia personale po mundohem me bë investime pa leje. Nuk është kjo, nuk është kjo për mu me u trahu këtu edhe me na sulmu lidhje pa lidhje. Mësohuni, keni përgjegjësi, jeni drejtora, e keni një përgjegjësi karshi qytetarëve. Po keni përgjegjësi edhe karshi legjislativit mos me gënjy. Po të lutna, ma unë s'di saherë duhet me të lutë me të thënë mos gënje se është turp. Po fatkeqësia është që hala je qaty. Fatkeqësia e këtij kryetarit që as nuk vjen në seanca, është që hala man drejtorat të cilët nuk e respektojnë ligjin, është për të ardhur keq. Edhe dua të informohem edhe në lidhje me web-faqen e komunës. A ka qenë për shkak që ka pas probleme teknike, pse është bërë një web-faqe e re? Edhe tash e mbas, a duhet vetëm me atë web-faqe me u monitoruar gjërat, apo ka me pasur edhe tek kjo e vjetra? Mirë është me informuar edhe qytetarët në këtë aspekt, për shkak që nuk është bërë ndonjë kampajë informuese ose vetëdijësuese në aspekt të kësaj. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Alishani. Prej anëtarëve të kuvendit a ka të tjerë? Shkëlzen Kastrati, po se e ka kërkuar fjalën.

Shkelzen Kastrati (PDK): Përshëndetje për të gjithë, të nderuar kolegë kuvendarë, ekzekutiv. Një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Më së pari faleminderit për të gjitha këto shërbime, punë që i keni kryer. Mirëpo ka punë ende për të bërë edhe kërkesat janë vazhdimisht. Fjala është nëse është e mundshme janë dy rrugë të quajmë fushore. Njëra është mes Petrovës dhe Fabrikës Liri, që është e dëmtuar shumë, ka nevojë për zhavor. Edhe një rrugë tjetër është mbrapa Petrovës, i bjen prej urës te tranziti i vjetër që e lidh me Petrovë. Një pjesë është shtruar më herët, mirëpo është edhe një aneks tjetër që duhet të shtrohet për me u kompletuar. Tash pyetje, dhe kërkesën e bëna, kështu që dy drejtorat të fortë i kemi, besoj që nuk lihet anash kjo punë. Po e kemi edhe Drejtorinë e Bujqësisë edhe Shërbimeve Publike, kështu që këta dy po garojnë cili me e kryer më përpara këtë punë. Kështu që faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Kastrati, fjalën e ka kërkuar Adem Shabanaj, pastaj Alban Bislimaj.

Adem Shabanaj (LVV): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për ekzekutivin, kolegë kuvendar, të nderuar media dhe të tjerët të pranishëm. Është një kërkesë e banorëve të lagjes Bajram Curri përkatësisht rruga Rezistenca e Vrrinit tek Xhamia në lagjen Bajram Curr. Është një devijim i rrugës për shkak të pronësisë së Bashkësisë Islame me disa prona private aty, mirëpo ajo rruga ka mbetur pa u shtruar me kubëza. Ka dhe biznese të cilat funksionojnë në atë pjesë, është kontrollimi teknik, është qendra e rekreative sportive, ka edhe ndërtime të larta të cilat po bëhen në atë pjesë, mirëpo rruga ka mbetur ashtu e devijuar pa kubëzim. Do të thotë kjo rrugë shkon edhe deri tek lidhja e urës Tusuz-Bajram Curr. Po besoj që është e nevojshme që e gjithë rruga të bëhet me kubëza të reja. Dhe çështja tjetër është ura Tusuz-Bajram Curr, jemi dëshmitarë që është bërë

pastrimi i deponisë ilegale në atë pjesë aty, mirëpo kërkoj nga Drejtoria e Inspektoriatit që tash e tutje të jetë pak më e vëmendshme përsa i përket hedhjes e mbeturinave në në atë pjesë. Dhe nga drejtori çela Lamaj a do të jetë ajo trase siç është tani e rrugës Bajram Curr-Tusus që bën lidhjen, apo do të ketë prerje direkte në pronat të AKP-së apo nuk e di a janë pronat private apo të AKP-së, ajo që e bën prerjen direkte, apo do të jetë në atë rrugicën që siç është sot nuk është kalueshme dhe kur do të bëhet asfaltimi i asaj rruge? Faleminderit.

Levent Bus (Zëvendëskryesues): Faleminderit. Fjalën e ka Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit. Përshëndetje ekzekutiv, kolegë kuvendar, media dhe qytetarë. Unë e kam një sqarim dhe një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Sqarimi do të ishte domethënë me vendndalje të autobusëve të cilën kolegu Tajari e ngriti si çështje, drejtori ndoshta e din por unë veç kam dalë në teren me i përcaktuar vendalje të autobusit bashkë me Petrin. Petriti e di shumë mirë që në Vlashnje veç nuk ka pasur mundësi me u vendosur vendndalje të autobusit për shkak të pronarëve që janë aty, domethënë i pengon përballë dyerve ose shtëpive, por edhe në Vërmicë e përmendi, domethënë aty veç janë vendndalje të autobusëve dhe janë mirë të ndërtuara. Bashkë me kryetarin e Vërmicës dhe kemi parë të arsyeshme që mos të hiqet ai vendndalje, ai stacion, por të lihet ai dhe mos të investohet kot. Dhe në vende që ka pasur mundësi dhe s'ka pasur vendndalje, domethënë, janë vendosur për atë pjesë ku foli Tajari. E dyta është kërkesa, drejtor edhe me shkrim ta kam dhënë për ndriçimin publik, domethënë ato ekzistueset prapë nuk kanë ardhur me i përmirësuar, me i mirëmbajtur, po dhe kemi folur për rrjet të ri pasi veç kanë filluar ndriçimi public, nëse kemi ndonjë rend, mirë ish kanë me na shti edhe neve në rend si si fshat Kobaj. Faleminderit shumë, kaq

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Bislimoj. Atëherë po kalojmë te pjesa e drejtorëve. Ju falenderoj të gjithë anëtarëve të kuvendit për kontributin që i dhatë në këtë pjesë. Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport.

Adem Morina (Drejtor DKRS): Faleminderit kryesuese, të nderuar kolegë drejtor, të nderuar kuvendarë, të nderuara media dhe qytetarë të Prizrenit. Do të mundohem të jem i shkurtër dhe i qartë në lidhje me përgjigjet për t'ju dhënë për pyetje të shtruar nga të gjithë kuvendarët. Fillojmë nga kuvendari Bajram Kastrati, në lidhje me memorialin Landovicë. Ky memorial Bajram nuk menaxhohet nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, ka qenë pjesë e Drejtorisë e Administratës, kurse ne si drejtori e kemi një kontratë të cilat merren me mirëmbajtjen e të gjitha memorialëve dhe lapidareve. Në kontratë domethënë të gjitha kërkesat që janë paraqitur në drejtori, jemi duke munduar që në bazë të planit dinamik të bëjmë intervenime në të gjitha memorialet dhe lapidaret që janë në komunën e Prizrenit dhe po shpresojmë edhe në memorialin e Landovicës sepse ka nevojë për një investim të tillë dhe po besojmë se në një ardhme shumë të afërme do të intervenohet dhe do të renovohet memoriali i Landovicës. Kurse sa i përket pyetjes së memorialit Xhavit Elshani-Leopardit, atë veç vitin që shkoj e kemi bërë, e kemi inauguruar dhe për arsye që memorialet në përgjithësi dhe lapidarët nuk kemi pasur dëshirë që të jenë në një rrethojë, po të jenë të hapura të jetë domethënë që kanë mundësi edhe vizitorët edhe gjithë ata që kalojnë nëpër ato pjesë qoftë të bëjnë fotografi apo të vizitohen, për atë arsye është paraparë nga arkitektët që kanë marrë planifikimin e projektit të jenë të hapura, të jenë hapësirë dhe mos kenë rrethoja. Por megjithatë pyetja është e thjeshtë dhe po kërkohet për arsye të mbrojtjes se mos dëmtohet nga kafshët në këtë rast. Pyetjen e dytë e ka shtruar Ymrane Fusha, në lidhje me një terren sportiv në Kurill, janë duke

vazhduar domethënë planifikimi për projektet dhe po aty do të ketë një projekt që do të intervenohet dhe do të bëhet edhe një terren sportiv pikërisht në Kurillë. Pyetjen e tretë e ka shkruar Egzona Hoxhaj në lidhje me një teren sportiv në fshatin Bregdri. Ju e dini që fshati Bregdri nuk ka hapësirë të mjaftueshme edhe për hapësira ku nxënësit të rinjtë kalojnë pushimin e jo për terren sportiv, por megjithatë ata kanë kërkuar që më herët aty ku ekziston një barakë apo improvizim që ka qenë i shkollës, do të mundohem që brenda mundësive dhe hapësirave që ka, jemi në kontakt me drejtorin e shkollës, këtë kërkesë e kam pranuar para një viti dhe brenda mundësive do të shikojmë që aty të ketë një infrastrukturë sado që të jetë e vogël për nxënësit të asaj shkolle. Pyetjen e katër e ka parashtruar Selman Sokoli, në lidhje me bordin e objekteve në këtë rast që i jepet në shfrytëzim.

Shkelzen Kastrati (PDK): Drejtor më fal a bënë një sqarim me dhënë këtu nëse ka mundësi pasi që unë jam kryetar i këtij bordit. Atëherë unë mendoj që kolegu im Selmani respekt për të, është anëtar i këtij bordit. Mirëpo realisht përveç mbledhjes së parë që ka ardhur, asnjëherë më nuk ka ardhur. Unë mendoj që njëherë paraprakisht asambleisti nëse merr një pozitë një anëtar të një bordi duhet me dhënë vetë kontributin e vetë aty, me u interesuar çka është duke ndodhur dhe çka mund me dhënë kontribut më tutje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem Shkëlzen, ju lutem mos e ndërprerni drejtorin për përgjigjet.

Selman Sokolaj (LVV): Jo po e ndërprej edhe unë Kryesuese.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ke replikë, ke prit.

Selman Sokolaj (LVV): Tash në këtë moment, po e vazhdoj...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo jo të lutem, mos i ndezni mikrofonat pa leje. Të lutem Shkelzen drejtori pastaj replikë ke edhe ti.

Selman Sokolaj (LVV): Tash menjëherë.

Shkelzen Kastrati (PDK): Kryesuese, respekt për juve se përndryshe nuk kisha ndalë mikrofonin.

Antigona Bytyqi (PDK): Jo jo respekt, por s'ke të drejtë me ndërhyrë ashtu. Të lutem mos e ndez mikrofonin. Jo jo, drejtori përgjigjet. Dëgjo Shkëlzen, mendova që po lyp qartësim diçka prej drejtorit në lidhje me ato, përndryshe nuk bënë kështu me ndërhyrje nëpër fjalime, ju lutem, ju lutem. Po drejtor të lutem vazhdo.

Adem Morina (Drejtor DKRS): Pyetjen e parashtruar te kuvendari Selman Sokoli në lidhje me bordin që është për dhënie në menaxhim të të gjitha objekteve të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport. Selman, bordi është i cili i jep në menaxhim objektet, ta dallojmë domethënë menaxhimin e objekteve dhe shfrytëzimin e objekteve. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport i jep për shfrytëzim të gjitha kërkesat që vijnë në DKRS, të gjitha objektet që i ka DKRS-ja, qoftë sportive, qoftë kulturore, i japin pelqim për shfrytëzim. Kurse për menaxhim është bordi i zgjedhur në Kuvendin e Prizrenit në këtë rast në këtë sallë. Asnjë objekt nuk e kemi dhënë në menaxhim, të gjitha

objektet të cilat janë në kuadër të DKRS-së marrin pelqim për shfrytëzim. Të gjitha edhe klubet sportive, edhe kulturore domethënë e kanë e kanë pelqimin për shfrytëzim. Dhe normalisht ne e kemi vlerësuar, e kemi respektuar çdo objekt që ka dhënë bordi edhe normalisht ashtu ka funksionuar. Sa i përket pyetjes tjetër të shtruar nga kuvendari Islam Thaçi edhe pse s'është këtu, unë do të mundohem t'i jap përgjigje për hir të opinionit dhe të qytetarëve. Të gjitha, të gjitha shpenzimet komunalit të të gjitha objekteve të DKRS-së, qoftë kulturore dhe qoftë sportive i ka, i mbulon Drejtoria e Kulturës në këtë rast të Komuna e Prizrenit, kurse nëse Islami e ka dhe e di ndonjë lokal që është duke punuar në kuadër të ndonjë Shtëpi e Kulturës, është mirë me njoftuar sepse nuk kemi informacion. Ka qenë para nja para nja tri vjete apo katër vjete, në momentin që kemi dalë në vend ngjarjes ka pasur një rast i tillë, e kemi ndaluar menjëherë e kemi mbyllur. Kurse nëse Islami dhe të gjithë ju që keni informacione që ekziston ndonjë lokal afarits që punon në ndonjë kuadër të drejtorisë tonë, normalisht e mirpresim me na informuar dhe normalisht do t'i ndërprejmë ato aktivitete. Dhe krejt në fund Shukri Quni ka shtuar pyetje në lidhje me terenet sportive. Është e nevojshme në fshatin në Nashec, ne e dimë që në secilin vendbanim ka nevojë për terene sportive dhe ne do t'i shohim mundësitë buxhetore si i kemi dhe mbrenda mundësive buxhetore jemi të interesuar jo vetëm në Nashec, por kudo që ka hapësira për rekreacion sportiv, jemi të gatshëm me investuar. Sa i përket Lapidarëve, e dini që e kemi dërguar kompaninë në fjalë për renovimin e memorialit në këtë rast apo Lapidarit të Komandant të Petritit, e dini që keni pasur takim me të dhe ju nuk jeni dakorduar që e njëjta kompani e cila ka fituar të drejtën për intervenimin dhe mirëmbajtjen e lapidarëve, nuk keni pranuar që të bëjë intervenim dhe normalisht është kthyer prap. Kurse kisha kërkuar mirëkuptim nga të gjithë ju kuvendarët që jeni të pranishëm, e kemi pikën e shtatë që është Muzeu Nënë Tereza, për arsye që është një, e kemi një takim me një komision nga Austria që ka ardhur një arkitekt në lidhje me renovimin e Shani Efindisë, e kemi në ITP, po duhet me ju kërkuar mirëkuptim që nuk duhet të jem në atë pikë, po në lidhje me lidhje me të gjitha sqarimet çka do që i keni, jam i gatshëm t'ju jap përgjigje me shkrim, po pjesën e një sqarime do ta ketë edhe Nënkrjetari Gashi, që t'ju jep sqarim çkado që keni nevojë. Po duhet me ju kërkuar mirëkuptim për këtë pikë për arsye që e kemi shumë të rëndësishme një takim i cili ka ardhur nga Austria dhe e kemi të pamundur që mos të jemi të pranishëm aty. Përndryshe do të kisha qëndruar dhe të gjitha pyetjet e parashtruara do të mundohem t'ju jap me shkrim. Kërkoj mirëkuptim. Faleminderit prej jush.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Selman të lutem shkurt replikë.

Selman Sokolaj (LVV): Më duket servilizmi duhet me ja ndërruar emrin me ja ngjitur Shkëlzen, se nuk ka nevojë me ndërhy kështu. E para, bordi e vetmja mbledhje e bordit kur s'kam qenë prezent është kur në një moment kur kam qenë jashtë shtetit, kam tentuar dy herë të tjera me i thirrë s'kam pa gatishmëri. Drejtori iku, menaxhim dhe shfrytëzim. Rregullorja për dhënie e objekteve kulturore sportive në menaxhim dhe shfrytëzim e thotë shumë qartë. Unë dasa me kërkuar prej drejtorit, ky e konfirmoj vetë tash, nuk e di a nga naiviteti apo nga siguria që nuk ndien për ligj, për rregullore, po ky tha na i japim në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe menaxhim dallon, nuk dallon Kryesuese. Edhe ju si kryesuese duhet me kujdes që me u zbatuar rregulloret që i nxjerr Kuvendi Komunal, për shkak se që je një Kryesuese e Kuvendi Komunal edhe rregulloret e Kuvendi Komunal mbizotërojnë mbi vendimet e ekzekutivit, ata duhet me ju nënshtruar rregulloreve. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit. Drejtoresha e Arsimit pastaj Çelë Lamaj.

Luljeta Veselaj Gutaj (Drejtoreshë DKA): Faleminderit Kryesuese.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Vetëm pak drejtoreshë, zotëri Quni edhe ka një replikë e keni të drejtë.

Shukri Quni (Nisma): Është fjala për pikën që jemi kah diskutojmë për Drejtorin e Kulturës e Rinisë dhe Sportit. Ai e dha njëfarë përgjigje por jo çka kërkova unë. Unë e di që kanë nevojë të gjitha fshatrat për fusha të sportit dhe ishallah do zoti i mbushni fshatrat me fëmijë e qytetin me luajtur ka të munden ata, ne e kemi kryer atë obligim tonin po ta shohim ju gjenerata e re. Por Nasheci kur ka pasur fushë të sportit kush ka qenë atëherë që ka qenë i ri në Nashec, që kur kur ka pasur fushë të sportit Nasheci, dikush nuk e ka ditur çka është edhe topi, futbollit po flas tash. Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport më herët kam bërë kërkesë, 100.000 euro i kanë ndarë Ministria për Kulturë, ka qenë Ministër Kujtim Gashi, 100.000 euro i keni ndarë në atë kohë, po nuk ke në gjendje komuna me i investuar ato mjete edhe shkun. Ta kam bërë këtë kërkesë, këtë ankesë kur ka qenë kryetar Mytaher Haskuka. Vendi ekziston, nuk ka nevojë me më dhënë ai mu kështu përgjigje dhe me dalë përjashta, por duhet me ndeji këtu edhe me u ballafaqur. Nuk është hera e parë që është bërë kjo kërkesë, kjo kërkesë bile Kujtimi e din edhe më herët kur e kam bërë. Vendi rrezikohet për me uzurpuar edhe duhet me investuar me ndërtuar fushën e sportit. Sa i përket lapidarëve që tha, e kam dërguar tha x personin me firmë me rregulluar, nuk lejoj mjetet e qytetarit me i keqpërdorur lloj-lloj firme, me ardhur aty, mos me punuar asgjë edhe me i marrë paratë, unë e dua me rregulluar aty. Kjo çështje ka qenë dashtë me marrë si pikë në një ditë me qitë edhe me diskutuar krejt kolegët këtu për firmat apo tash qysh po i quajnë kompanitë apo operatorët, që po i marrin punimet edhe nuk po i kryjnë deri në fund. Ne duhet me diskutuar si pikë këtë, të gjithë kuvendarët këtu. Problemi më i madh është këtu, derisa ta marrin atë tender, kush e di çfarë intervenimi bëjnë, a kush ja jep, a bën vaki s'ka firma ai fare, as kolic të dorës nuk ka në shtëpi të vetë, e merr tenderin, ja jep diku tjetër, ai vjen zotëria dhe nuk i kryen punët ose i kryen do punë të vrashdë aty këtu, ja japin mjetet, edhe ai ta lenë punën pa kryer. Nuk e lejojnë me ardhur me hyrë ai aty edhe mos me kryer punën. I njëjti lapidar është në Nashec, i njëjti lapidary në Kojush, i njëjti, po mendoj punimet që i kanë bërë, të njëjtit lapidar që i di edhe në Lez, mjetet janë marrë, punët nuk janë kryer. Urdhëroni shkoni, këqyrni a i kanë kryer punë a jo. Unë i kam edhe mjetet që janë ndarë për ato, e për ata se kam lejuar, por ai shkoj doli jashtë edhe kam dësht me më dhënë përgjigje. Besa duhet me shkuar në prokurori ajo, se me i filluar punimet edhe me i çelë me i bërë do punë të vrashdë aty, me i marrë do para të majme aty edhe mos me u kryer puna, nuk e ka hangër qatë asnjë, punën kryje edhe shko merr para aty. Këtë deshta pak me u ballafaqu me të po i shkoj edhe so në rregull.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Quni. Shkëlzen Kastrati të lutem replikën e fundit edhe shumë shkurt, pa ofendime, pa fyryje, ju kisha lutë.

Shkelzen Kastrati (PDK): Unë desha vetëm një sqarim edhe shkurt. Po ashtu qysh e bëni pyetjen, përgjigja ime normalisht kishte me qenë kështu. Nëse shpifja ka emër, e ka emrin Selman, po unë nuk po dua me e thënë këtë. Sepse kam respekt për qënien njerëzore. Nëse nuk janë qënje njerëzore, atëherë e bëjnë nivelin tjetërku edhe munden me u shpreh qysh të dojnë. Por realiteti është që për hir të së vërtetës me diskutu, me fol, sepse jemi në një komision që është votu nga kjo asamble, edhe nuk jam veç unë aty anëtar, janë shumë anëtarë, e dinë të gjithë kush janë anëtarë

dhe sa kemi punu, sa jemi angazhuar, Mirëpo disa në këtë rast kolegu Selmani, në mbledhje ka marrë pjesë hajde dy edhe do të thotë nëse duhet me ditë dikush më shumë për këtë komision është vetë anëtarë i këtij komisionit. Nuk duhet me i lajthit njerëzit me bë pyetje ose me thënë që në emër të qytetarëve po bëj diçka, që realisht ai është vetë përgjegjës. Nëse do me ditë, mundet me i nisur një rast, një takim me kryetarin, me komplet anëtarët me diskutuar çka ka o tu ndodh, a mundem me dhënë një kontribut, a mundem me bë një zgjidhje? Edhe në këtë formë mundemi me ju dhënë shërbim qytetarëve. Vetëm që me i akuzuar të tjerët për mospunën e vetë edhe kjo nuk është fer. Unë qetë desha me dhënë një sqarim. Për pjesën tjetër, drejtori e ka pjesën e vetë, kërkush nuk i stervilohet kërkujt secili është përgjegjësi për veprimet e veta, punën e vet. Vetëm që e vërteta është që nuk duhet qytetarët t'i mashtrojnë me idenë që jemi tu punu në emrin e tyre, realisht nuk tuj punu punuar kërkush. Të paktën personat le të jenë vetë përgjegjës për veprimet e veta. Bordi, sipas kërkesës të drejtorisë ka punuar, është angazhuar, e-mailat i kanë shkuar secilit anëtar, prej zyrtarit Veton Xhemaj, edhe prej meje, po edhe prej grupit në viber. Ndoshta disa anëtarë më vonë për shkak të mungesës të numrit nuk janë kanë pjesë e e viber-it, por e-mailat zyrtarë i kanë shkuar të gjithëve. Mirëpo a janë kanë jashtë shtetit, a s'kanë mundur me ardhur, nuk është përgjegjësia e jemja. E vërteta është që ata të cilët duan sqarime shitesë, duan njëherë që janë vetë përgjegjës për punën që duhet me bë, njëherë duhet me u angazhuar vetë, masanej duhet me ja gjujtë fajin diku tjetër, drejtor apo kushdo që është, për me thënë që ne jemi duke punuar diçka. Ky bord, në bazë kërkesës së drejtorisë, i ka kryer të gjitha obligimet e veta, i ka dhënë shfrytëzim dy salla, dy fusha dhe një sallë, kur ka kërkesë angazhim, jemi të gatshëm të mbajmë mbledhje edhe të angazhohemi për zgjidhjen e shumë problemeve sa i përket përgjegjësi të këtij bordi. Mirëpo lajthija edhe dezinformata me të vërtetë nuk është korrekte për qënien njerëzore, për ata të tjerët nuk e di. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit.

Selman Sokolaj (LVV): Shkurt shumë Kryesuese.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po edhe ti e ke replikën e fundit edhe kalojmë te drejtoresha.

Selman Sokolaj (LVV): Dezinformata apo qenia njerëzore e bënë dezinformatën, se qenia jo njerëzore nuk bënë dezinformatën, po ne jse nuk po hyjmë në këto, çka me folur në këtë rast më shumë, Drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Adem Morina, po e parafrastoj, ka thënë që ne nuk lejojmë që ju me i dhënë në menaxhim këto objekte, ne po i paguajmë. Është në njëra nga seancat, është e inçizuar, është video. Këtu është problemi, këto cilësime të tjera besoj që nuk ja vlen. Mirëpo unë e thashë atë çka duhet me thënë. Bordi, kryetar i bordit nuk ka vullnet politik me u marrë me këtë punë, drejtori, nëse e keni dëgjuar, na konfirmoj se jemi t'i dhënë në menaxhim! Është tuj bë shkelje ligjore, për këtë unë kisha informacionet paraprakisht, e ka thënë edhe drejtori, e rikonfirmoj edhe çfarë na duhet neve, tash duhet me bë një auditim të këtyre rasteve. Nëse auditori gjen shkelje, atëherë vazhdojmë me hapa të tjera, nëse nuk gjen shkelje që shkelje ka gjithsesi, domethënë as s'kemi të bëjmë me dezinformata, s'kemi të bëjmë me shpifje, krejt kategori të tjera janë ato, nuk nuk është rasti këtu me i përmend. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Drejtoreshë fjala për juve.

Luljeta Veselaj Gutaj (Drejtoreshë DKA): Faleminderit Kryesuese, i nderuar Nënkyetar, të nderuar koleg drejtorë, të nderuar asambleist, media, qytetarë që na përcjellni. Janë dy pyetje. E para nxëmja në shkollën Gjonaj, jo vetëm në Gjonaj por në secilën shkollë në Komunën e Prizrenit jemi kujdesur që të ketë nxemje dhe të ketë kushte të cilat zhvillohet mësimi në kushte të mira dhe të rregullta. Sa i përket rregullimit të kulmit në shkollën e Nashecit, zoti Quni, ne si Drejtori e Arsimit, kemi bërë kërkesë te Kryetari i Komunës, mirëpo për revidimin e problemit i cili është në kulmin e shkollës në Nashec, për shkak që projekti për ndërrimin e kulmit dhe renovimin e tërësishëm është në vitin 2026 i paraparë me buxhet ashtu siç e dini edhe ju. Mirëpo në një nga seancat e vitit të kaluar ju keni ngritur shqetësim dhe keni kërkuar me ndërpre këtë revidim për shkak që ka me u bë kompletme ose rregullimi i tërësisht i kulmit dhe presim derisa të vijnë afatet ligjore për të vazhduar me këtë pjesë. Faleminderit. Në buxhet ka qenë i parapam për vitin 2026, për atë arsye edhe ne kemi përgatitur kërkesën edhe projektin për me reviduar problemin, por pas kërkesës së juaj që e keni bërë në seancë, unë e kam tërhequr kërkesën nga Zyra e Kryetarit për mos me nxjerrë vendim dhe me vazhduar më tutje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtoreshë. Hajde të lutem sa më shkurtë.

Shukri Quni (Nisma): Drejtoreshë unë për shkak të mos investimit dy herë e kam pasur. Unë falendrova edhe kryetarin për një vendim të tillë edhe kërkesën që e keni bërë ju si drejtoreshë. Unë kërkoja që mos të investohet dy herë në kulëm. Po qaj 2026 vjen në 2025 edhe qeky investim që e patët në 2024-tën kalon në 2025-të, kështu që të punojmë në këtë drejtim, bile të filloj në qershor edhe në shtator të fillojmë me punë. Se ajo është duke u shkatërruar për çdo ditë, kjo është kërkesa ime. Se ne kishim intervenuar prapë në 2026-tën, kishim intervenuar e për k ëto mjete ne që jemi ka investojmë nga dyherë nëpër projekte, mos jemi duke i paguar shtrenjtë. Unë vetëm për këtë e kam pasur. E tash mos ta zhgagojmë në 2026-tën, por ta krijojmë në 2025-tën, edhe kemi zgjedhje ndoshta fitojmë ndonjë votë helbete.

Luljeta Veselaj Gutaj (Drejtoreshë DKA): Na do të bëjmë përpjekje për me bërë në këtë vit edhe pse jemi tepër të ngarkuar, se qysh në fillimvit i kemi pas nga detyrimet kontingjente edhe nga kontrata kolektive rreth 1 milion euro të cilat na kanë gjobit si Drejtori e Arsimit dhe sfida me buxhetin ju e dini sa është mbështetja nga Ministria e Arsimit, sa është nga qeveria edhe sa ka buxhet komuna. Po e kemi të pamundur për me i harmonizuar, por do të bëjmë përpjekje edhe me pa se çka mundemi me bë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Atëherë kalojmë te drejtori Çelë Lamaj.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Faleminderit Kryesuese. I nderuar Nënkyetar të dashur kuvendarë, qytetarë të nderuar të Komunës së Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, a po e dëgjojmë me vëmendje përgjigjen e drejtorit? ju lutem.

Çelë Lamaj (Drejtor DSHP): Pyetjes së kuvendarit Agim Muqaj. Ne e dimë që në fshatin Korishë kemi disa aktivitete në rregullim të infrastrukturës rrugore, në këtë rast ka edhe ujësjellëse dhe kanalizime, kështu që edhe kjo kërkesë e juaja domethënë veç është në zhvillim e sipër. Opinioni në Korishë e din që Drejtoria e Shërbimeve Publike ka bërë goxha do investime pro nuk do të

ndalemi se janë kërkesa dhe nevoja të qytetarëve. Shqipe Shatri, kërkesa e juaj për një rrugë. Gjatë këtij vitit mos them a di kështu që edhe tremujorshin e parë ndoshta do të shohim mundësitë si drejtori dhe do të rregullohet edhe kjo rrugë. I përgjigjem pyetjeve të Tajar Susurit, sa i përket rrugës që qon për Hoqë, është shumë e vërtetë që aty kur ka rreshje, është në një hapësirë ku grumbullohet një sasi e ujit, aty kemi disa probleme me pronarë privat, aty është dhënë veç urdhnesë të bëhet një lëshesë, normalisht që janë procedura të cilët na kërkojnë edhe po na marrin kohë pëlqimet e pronarëve, ndërhyrjet e tyre, mirëpo edhe ajo pjesë do të rregullohet. Përndryshe aajo pjesë nuk është grop, por është një hapësirë e tillë e cila kërkon vetëm një lëshesë. Kurse sa i përket vend ndalimeve për autobusë, Albani ja dha një përgjigje, ne kemi tentuar prej vitit të parë që të vendosen ato dhe ka pasur probleme dhe ato kabina apo vend ndalime për autobusë janë bërë nëpër lokalitete të tjera. Kurse sa i përket ndriçimit publik që është pyetje e rëndomtë e kuvedarëve, mund t'ju them që me një kontratë të tillë Drejtoria e Shërbimeve Publike bënë shumë, urdhëresa ka normalisht që edhe në Zhur edhe në lokalitete të tjera që të ndriçohen rrugët kryesore dhe rrugët të cilat na çojnë deri në institucione si janë ambulancat, shkollat, çerdhet apo edhe institucionet fetare. Por me një kontratë, nuk ka mundësi një komunë si komuna e Prizrenit, duhet me i pasur edhe nja tri kontrata të tilla për me i mbuluar komplet lagjet. Jemi në zhvillim të aktiviteteve dhe në brendësi qytetit por edhe nëpër shumë lokalitete, nëpër fshatra. Kështu që, besoj që me një kontratë tjetër do të zbutet sadopak, do të zbuteten edhe kërkesat e qytetarëve për ndriçim. Pyetje se Egzona Hoxhës, rreth projekteve infrastrukturale në Bregri, veç e kemi një projekt të cilin e kemi në procedurë, kështu që gjatë këtij viti edhe Bregdrini do të trajtohet me gjithë infrastrukturën e kërkuar. Selman i ke marrë përgjigjet, ke pasur një kërkesë rreth ndriçimit publik në Krajë. Ke marrë një përgjigje të cilin ke kërkuar qasje, edhe ngelim pranë asaj përgjigje të cilën e keni marrë zyrtarisht. Sevil ky problem rreth atij ujit, edhe ajo është ujë i njëjtë i cili na lidh këto dy rrugë dhe kalon rrugën kryesore, magjistralen për Prishtinë, e cila është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës. Edhe aty ka probleme rreth rreshjeve atmosferike kur bëhen edhe normalisht që thashë zoti në një qeveri tjetër të ardhshme të Republikës së Kosovës, do të kemi një koordinim më të mirë edhe të kemi me mundur me intervenuar në shumë projekte të cilat na bashkojnë bashkë, edhe nivelin komunal edhe nivelin qendrorë. Sa i përket rrugës së Medinës, unë po ju them vetëm një diçka që në zonën e pare historike është duke u punuar me kalldërm, nuk do të ndalemi s'punuari me kalldërm, edhe do të punohet të gjitha rrugët që janë në zonën e parë historike, do të vendoset edhe kalldërmi dhe ndriçimi public, dhe gjithë ajo infrastrukturë që të jetë jetëgjatë edhe njëherë e përgjithmonë t'i zgjidhim problemet e qytetarëve nëpër këtë zonë. Kurse sa i përket zebrave, po ne kemi një kontratë e cila është lidhur vonë, diku në muajin tetor, shtator, në fund të shtatorit, tetor. Kemi filluar me aktivitet, tani duhet të priten temperaturat më të ngrohta që me mujt me u vendosur shenjëzimi horizontal, shenjëzimi vertikal veç është aktivitet dhe është duke u vendosur. Sa i përket pyetjes e kuvendarit Petrit Hoxhaj, rreth largimit e mbeturinave mes Murademës dhe Vlashnjës. Sinqerisht është me të ardhur keq që Drejtoria e Shërbimeve Publike është bërë sikur një drejtori e cila do të merret tërë kohën me largimin e pikave të zeza rreth hudhjes e mbeturinave vend e pa vend. Është tmerr kur në lagjen Bajram Curri, në lagjen Tusuz te ura aty, ku kemi intervenuar para dy-tri ditësh, vitin e kaluar janë mbjellë edhe fidane, shkatërrohen nga njerëzit e jo ndërgjegjshëm, krejt ajo hapësirë edhe hudhen mijra tonë, po ju them mbeturina që duhet operatori tri-katër ditë me makinerinë e vetë me larguar. Ka shumë kësi deponi të zeza, normalisht që Drejtoria Inspektorateve, me një inspektor të ambientit, është problem për me mundur me identifikuar, por këtu duhet të jemi më të vetëdijshëm edhe të bëjmë apel te qytetarët që të lajmërojnë rastet kur njerëzit e pa ndërgjegjshëm hudhin mbeturina. Tash unë në mes Murademës dhe Vlashnjës nuk e di, po them që s'ka prej qytetit po me siguri edhe që aty për rrethi

shkojnë, po është mirë me identifikuar ata të lajmërohen edhe atëherë gjohet të cilat i ka të rregulluara Drejtoria Inspektoriateve me siguri do t'i parandalojë. E sa i përket pyetjes së Islamit, Islami Thaqi s'është këtu. Faruk Tahiri, ne kemi kaluar në këtë kuvend vitin e kaluar një vendim për formimin e një ndërmarrjes publike parkingjet me banesa, i kemi kryer tërë gjitha procedurat edhe kemi dërguar në ministrinë relevante për themelimin e asaj ndërmarrje e cila kishte me na bërë një zgjidhje afatgjate të menaxhimit të parkingjeve po edhe mirëmbajtjen e banesave, deri me sot nuk kemi asnjë përgjigje nga ata. Normalisht që ne jemi kah e bjmë shenjëzimin e të gjitha parkingjeve të hapura të komunës tonë edhe janë porositur shenjëzime që në ato vendparkingje mund të parkohen qytetarët pa marrë ndonjë kompenzim, se kemi dhe disa lokacione që kemi informacione që marrin edhe pare nëpër prona publike. Kështu që, urgjentisht ne do t'i shënojmë, do t'i qesim shenjat edhe me siguri atëherë edhe inspektorët e komunikacionit edhe policia, ata keqbërës ose ata të cilët marrin mjete prej qytetarëve do t'i parandalojnë. Në numrin i taksive diku deri tash ka mbërritur diçka diku mbi 180 taksi, ne me rregullore i kemi 200 taksi, normalisht që është kërkuar që këta taksi duhet ta kenë taksimetritin e licencuar për shkak të kostove shumë të larta ka pasur hezitime. Sot në mëngjes me informuan dhe unë e kam menduar qysh kështu më paten thënë se ka qenë 400 tash është 500 e diçka euro, ju ka bërë, që është një taksë e jashtëzakonshme e madhe. Është përcaktuar nivelin qëndror edhe ne pa dukenmoment nuk mundem me licensu. Shukri, normalisht që ne do të shohim mundësitë që jo vetëm edhe në Nashec, edhe nëpër vende të tjera e kemi dhënë vetëm urdhresë, jo edhe për anë të tjera, edhe për anë të tjera që ne e kemi dhënë vetëm urdhresë që të pastrohen rrugët prej tashit, kemi dhënë urdhresë që të fillohet edhe me pastrimin e varrezave aty ku ka nevojë dhe për me ndërhyrë që normalisht që tash e kemi festën e ramazanit edhe Bajramit ku qytetarët kanë me pasur me siguri të rregulluar me këtë infrastrukturë që kërkohet. Shenjat e komunikacionit normalisht që kemi me fillu, kemi me fillu edhe në Nashec, bile jemi shumë të interesuar se nëpër disa lokalitete ku ka edhe frekuencë më të madhe, po një kontratë është, me mundësitë buxhetore që i ka komuna derisa ta shpenzojmë atë kontratë dhe fillojmë me siguri lidhjen e një kontratë të re, por komunën e Prizrenit do ta pajisim me shenjëzim edhe horizontal edhe vertikal. Ndriçimi në Nashec, të premtoj që atje një pjesë e madhe atje e din që është përfunduar, po ka me u kryer edhe ajo gjatë këtij viti, para zgjedhje. Shukrije pengesa, ato pengesa që i kemi vendosur në atë rrugë ka qenë edhe kërkesë e komunitetit tuaj aty sepse ne bëmë një trotuar vendosim drunjë dekorativ edhe mes drunjëve filloi parkimi i makinave edhe ma keq, se nuk kishin mundësi ta zinin trotuarin kështu, por gjysma e makinës mbetke në rrugë. Normalisht trotaret dihet që janë për këmbësorë edhe për njerëz të pandërgjegjshëm edhe policia që s'është tuj mujt me reaguari në momente të dhura në mungesë të kapaciteteve apo nuk e di çka, ne jemi detyruar me vendosur si pengesa, jo vetëm te ju po kanë me u vendosur edhe nëpër shumë lagje të Prizrenit pengesa që t'ia pamundësojmë parkimin. e gabum të gjithë vozitësve të pandërgjegjshëm. Brikena, pyetjes për transportin Zym. Kam pasur kërkesa të qytetarëve, ne jemi afër shpalljes publike edhe për Zym, ka me pasur, më herët është bërë shpallja, s'është lajmëruar asnjë operator. Kështu që dhashë zoti që të lajmërohet dikush edhe normalisht që ne jemi, kemi me e mirëpritur atë ofertim edhe kemi me i dhënë një linjë e cila është e domosdoshme për qarkullim. Dafina Alishani rreth parkut të Marashit, të ulëseve. Dafina, ne kemi nënshkruar një marrëveshje me KFOR-in Turk, ata janë të gatshëm me bërë një investim, normalisht që e kemi kërkuar ne parkun e Marashit, kemi pasur të planifikuar edhe ne si drejtori të interveojmë. Ata duan me bërë një donacion, tash ta shohim se çka bëjnë ata. Çdo element tjetër i cili s'kanë me mujt se mundësitë buxhetore sa e pashë unë i kanë të vogla, mirëpo ata na u zotuan që kanë me rregulluar, ai park që është, veç kanë me riparuar pak, por nëse eventualisht ka me pasur nevojë edhe për ndonjë mobileri tjetër urbane, ne kemi me vepru. Rrugë fushore, e kemi Drejtorin

e Bujqësisë Shkëlzen edhe me siguri do të japë përgjigje. Adem Shabanaj, ai rreth është mire boll. Ndriçimi publik edhe në Kobaj edhe në lokalitete tjera e thashë që ka me u bërë. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Dëgjoni, vetëm nganjëherë keni të drejtë të kjo pikë me marrë fjalën. Tash me ndërhy tek secili drejtor.

Selman Sokolaj (LVV): Tek Dokumenti i drejtorit është.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo jo, ju lutem, ju lutem.

Selman Sokolaj (LVV): Dokument i drejtorit është Kryesuese.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jemi te përgjigjet e drejtorëve, të lutem ndale mikrofonin, ndale mikrofonin.

Selman Sokolaj (LVV): Një sqarim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ndale mikrofonin, të lutem. Jo, tash po e kërkojnë edhe nga njëherë fjalën, vetëm një herë keni të drejtë.

Selman Sokolaj (LVV): Ky po insiston që kanë me u vendosë shtyllat e janë hapur gropat

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dëgjoni ju lutem, ju lutem se po e përsëris disa here. E kemi në rregullore vetëm shtatë-tetë faqe i ka, na shkruan shumë qartë, te qekjo pikë kemi...

Selman Sokolaj (LVV): A e bëjmë ne vetëm sa për sy e faqe a për sqarim?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dëgjo, të lutem, çkado që ke pas me sqaru, kur e ke marrë fjalën në fillim u dashtë...

Selman Sokolaj (LVV): I thash a ke gabu në përgjigje? Tha qëndroj mbrapa përgjigjes.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, ke marrë përgjigje, jo edhe njëherë me marrë fjalën.

Selman Sokolaj (LVV): Qysh, ke hapur gropa o drejtor e po thua....

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Pyetjet i ka marrë drejtori, tash përgjigjet drejtori, jo nga dy here, vetëm një herë keni të drejtën.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese a bënë veç me sqaru?

Antigona Bytyqi (LVV): Jo nuk bënë, të lutem nuk bënë.

Selman Sokolaj (LVV): po qysh nuk bënë?

Antigona Bytyqi (LVV): Vetëm në fillim keni pasur të drejtë me marrë fjalën. Ato që i ke marrë sqarimet, leji për seancën tjetër se kemi edhe shumë të tjerë. Dëgjo...

Selman Sokolaj (LVV): Veç 10 sekonda.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): 10 sekonda nëse ju jap juve fjalën, atë duhet të gjithëve me radhë.

Selman Sokolaj (LVV): ky po thotë shtyllat kanë me u vendosë...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A nuk po i sheh mbrapa që të gjithë po e kërkojnë fjalën. Ju lutem ta respektoni rregulloren.

Selman Sokolaj (LVV): Ka hap, ka hap gropa për shtylla të reja, qysh i hap?

Antigona Bytyqi (LVV): Ju lutem drejtor, ju lutem drejtor e keni përfunduar. Kalojmë tek Drejtori i Shëndetësisë. Të lutem zonja Shukrije, nëse fillojmë nga dy here..

Shukrije Berisha (Nisma): Jo por s'mi kthej përgjigjet për dy. A e di ku qëndron problemi? Se banorët janë duke e përcjellur seancën edhe unë i thashë i merrni përgjigjet, direkt përcjellne.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, ato përgjigje që nuk i ka dhënë, drejtor tu kisha lutur me shkrim ja u bjen në seancën tjetër. Jo edhe njëherë tash me u kthyer me marrë fjalën secili me radhë. Drejtor i Shëndetësisë, drejtor të lutem përgjigju.

Simir Krasniqi (Drejtor DSH): Faleminderit Kryesuese, të nderuar drejtor, të respektuar kuvendarë. Unë pata pyetjen nga zoti Agim për emërimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Korishë. Unë nuk kam marrë shkresë me shkrim nga banorët e fshatit Korishë, por jam njoftuar nga disa banorë që kanë kërkuar që të emërohet kjo Qendër e Mjekësisë Familjare. Ju e dini që Statuti i Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare edhe emërimi. A ka mundësi ta...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju kisha lutur ta respektojmë, drejtori e ka fjalën. Ju lutem ta dëgjojmë drejtorin. Drejtor vazhdo të lutem.

Simir Krasniqi (Drejtor DSH): Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare është votuar këtu në kuvend dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e mbanë emrin doktor Nexhip Berisha. Ne kemi 46 qendra mjektore pra dhe 15 qendra të mjekësisë familjare. Neve nuk na lejon ligji që këto qendra t'i emërojmë pra në këtë rast me propozimin e juaj të profesor doktor Zenel Kabashit, ne nuk e kemi atë mundësinë ligjore që të na jepet e drejta ta emërojmë këtë qendër të mjekësisë familjare. Kjo është përgjigja ime përse i përket juve zoti Agim. Kurse te pyetja e zonjës Shqipe. Ju e dini, punoni në arsim, ne në disa shkolla kemi stomatolog, në disa shkolla të qytetit dhe gjatë viteve kalendarike shkollore ne i kryejmë rregullisht vizitat sistematike me nxënësit e klasave të para, të pestat dhe të nëntat. Ne do të jemi shumë më tepër të interesuar se ju po të kemi kapacitet mjekësor që edhe ato shkolla ku nuk kanë stomatolog, t'i mbulon të paktën me karrika stomatologjike dhe njëherë në javë të shkoj stomatologu. Por ku e marrin shërbimin këta, kemi qendrat e mjekësisë familjare në ato fshatra që nuk kanë shkollat stomatologë edhe i marrin shërbimet stomatologjike që të kenë një kujdes oral sa më të mirë ata nxënësit, ata fëmijët tone,

kjo ishte përgjigja juaj. Kurse sa i përket aspektit higjenik, ne jemi kujdes shëndetësor, duhet maksimum ta kemi higjenën nëpër të gjitha këto objekte. Pata edhe një pyetje nga zonja Brikena. Ku do marrin pra pacientë informata rreth shërbimeve shëndetësore? Ju e dini që në çdo fshat, në çdo qendër kemi ambulantat dhe qendrat e mjekësisë familjare. Pacientët, ata që kanë nevojë për me marrë kujdesin shëndetësor, orientohen te mjekët familjarë, në qoftëse kanë nevojë që të shkojë te specialisti, ata i marrin raportet dhe orientohen për kujdesin sekondar. Ne si kujdes primar i kryejmë të gjitha shërbimet që na takojnë. Këto ishin përgjigjet. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor. Atëherë drejtoresha Ramize Shala fjalën e ka.

Ramize Shala Sinanaj (Drejtoreshë DES): Faleminderit Kryesuese. I nderuar Nënkryetar, të nderuar drejtorë, të nderuar asambleistë. Unë pata një pyetje prej Selmanit se a janë subvencionuar rastet gjatë vitit 2024, rastet e zjarreve? Selman, kemi pasur raste të tilla edhe i kemi procesuar ne si drejtori, ende nuk janë subvencionuar për arsye të mungesës së mjeteve. Kështu që po shpresojmë se shumë shpejtë kemi mi subvencionu këto raste gjatë këtij viti. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Atëherë drejtori Pranverim Berisha fjalën.

Pranverim Berisha (DUPH): Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Bajram, zakonisht ti dish me kanë i meqëm edhe i kujdesshëm po në këtë rast kurqysh. Për shkak se kërkohe një proces që ka ndodhur para disa vitesh edhe Drejtoria e Urbanizmit e ka asistuar këtë proces përmes dy zyrtarëve të vetë. Mirëpo ne nuk kemi vendosur tabela për emërtimin e rrugëve shesheve të tjera. Kështu që, domethënë krejt një drejtori tjetër këtë punë e ka bërë atëherë në atë kohë. Edhe ne me vetë faktin që ja kemi pru edhe një zyrtar tjetër ligjor me asistuar, domethënë edhe me ndihmuar komisionin jemi shumë seriozë. Me të vërtetë edhe vërtet kemi vullnet me ndihmuar këtë proces deri në fund. Unë kam qenë para teje në këtë komision edhe vërtet do një përkushtim të jashtëzakonshëm. Mirëpo vetë kryetari i komisionit duhet me qenë serioz atje. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Hajde kryetar replikë.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit drejtor. Drejtor, veç kqyrëm në sy. Sa i përket pyetjes për tabela, vendosjen e tabelave, unë të bëra pyetje a keni në procedure? se ka plot tabela që duhet me i ndërruar. E dyta, zyrtarin ligjor, nuk ka qenë takim, që ku i kam kolegët që kanë qenë prezent. Zyrtari ligjor edhe ju si drejtor e keni konfirmuar që keni me qenë prezent, s'keni qenë asnjëri. Qe ta konfirmon edhe shoku Marin këtu përpara dhe kolegë të tjerë. Kështu që më serioz s'po di qysh me kanë, veç kqyrëm në sy mundësisht.

Pranverim Berisha (Drejtor DUPH): Dëgjo, s'jam unë fajtor pse ti nuk je i informuar? Domethënë nuk je i informuar për pyetje që po i parashtrojsh. Interesohu kush është kompetent me ta dhënë përgjigjen edhe merren nga njerëzit kompetent, jo nga unë.

Bajram Kastrati (AAK): Atëherë kush është kompetent drejtor?

Pranverim Berisha (Drejtor DUPH): Nuk jam i detyruar bre unë me u marrë me ty.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, jo jo Marin, të lutem.

Pranverim Berisha (Drejtor DUPH): Domethënë interesohu kush e ka ndjekur procedurën 2015, 2016 e 2017 edhe gjen edhe përgjigjen, me të vërtetë a din, bënu pak serioz.

Marin Përgjoka (LDK): Kryesuese, është duke e atakuar komisionin ku jam pjesë edhe unë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Vetëm pak, Marin, do ta kesh fjalën me radhë. Zoti Quni e ka kërkuar para teje. Po priteni, mos i nderoni mikrofonat pa leje, ju lutem. Zoti Quni të lutem, replikë urdhëro.

Shukri Quni (Nisma): Kryesuese, ky vit është vit i fushatës për ne tash, se ka kaluar për këta që kanë për deputet, plus që dy muaj s'kam folur këtu në asambëlë unë fare, mua bile më ka rënë malli pak. Se disa që kanë qenë kandidat për deputet, ata janë shfryer, kanë folur, e kanë kryer atë dhe këta duhet me shujt pak, mos me marrë shumë herë fjalën. E sa i përket këtij viti, po të tregoj që e ke kështu, po ruaje qetësinë, mos u gut ngadalë-ngadalë, le të shfryhen këta, ka pesë minuta le të folin, ka 10 mos ja ndal fjalën hiç, se sen sun bëjmë më ne këtu, ne veç kemi me fol, punë me kry asnjë sen hiç. Sun i kemi kry që tri vite, kjo veç ka me qenë edhe ata na ka rënë malli që dy muaj e gjysmë s'jemi kanë në kuvend, mos na zen për të madhe shumë. Në temë nuk po kyqna hiç edhe mos u gut se nuk e kemi kry, hala jemi në kualicion me ju.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nuk është çështja tek unë që unë s'po duroj apo diçka, por e kemi një rregullore. Unë nuk e di emir i Marinit a u përmend. Po mirë de, tash komisioni krejt rend Marin me marrë fjalën a. Të lutem sa më shkurtë edhe po e përfundojmë.

Marin Përgjoka (LDK): Drejtor, sa për punë të kompetencës në komision për emërimin e rrugëve kanë qenë dy zyrtarë që kanë ardhur prej drejtorisë juaj, në drejtorinë e juaj punojnë ata. Tash nëse ju nuk jeni kompetent, pse kanë ardhur ata punëtorë prej drejtorisë të cilën ju, atëherë pse me na ndihmuar nëse s'je kompetent, më fal? Jo po nëse s'je kompetent s'ke nevojë as për me ndihmu.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem Marin ta përfundojmë. Ju falenderoj të gjithëve për kontributin që e keni dhënë në këtë pikë si anëtar të kuvendit edhe si drejtor. Urdhno Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Me pas ndodhë ndonjë asambleistë me i thënë ndonjë drejtorit s'je normal ose diçka, ja kishte ndalë fjalën. Ekzekutivi kur sulmon asambleistë e lëni deri në fund.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo për besë nuk e kam ndëgju, kërkoj falje, ndoshta pa mikrofon.

Dafina Alishani (LVV): Seancën e radhës edhe unë Shqipëri Totës kam me thënë, kam menduar që je i i menqem, po s'koqe.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jo, ndoshta pa mikrofon.

Dafina Alishani (LVV): Jo jo, me mikrofon e ka pas, ka dalë te mikrofoni i kolegut, se s'ka mikrofon i shkreti, edhe e ka sulmuar asambleistin me fjalë që s'duhet me u përmend në kuvend. Unë vetëm po të lutna me mbajt qet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Unë e dëgjova që i tha jo serioz.

Dafina Alishani (LVV): Live e ke pas, kur sulmohen asambleistët e keni kështu për adet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Unë e dëgjova që i tha jo serioz, për jo normal nuk do dëgjova.

Dafina Alishani (LVV): Jo i tha kom menu që je i meqëm por s'koke hiç, të lutna. Jo s'është në rregull prej juve, prej anës së juve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit të gjithëve për kontributin që e keni dhënë këtë pikë edhe prej anëtarëve të kuvendit edhe prej drejtorëve. Kalojmë te pika e radhës, ju lutem te pika e katërt.

Pika e katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e planit rregullues të hollësishëm, Zona e Parkut për industri të lehtë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuar anëtarë, ashtu siç e keni parë në fund të këtij propozim-vendimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas udhëzimit administrativ numër 05/214, është kërkuar edhe raporti i shqyrtimit publik. Këtë raport ekzekutivi ja ka bashkangjitur këtij propozimi-vendimi edhe neve na mbetet vetëm që ta miratojmë edhe ta përcjellim te ministria, domethënë raportin, mungesa e raportit. Kush dëshironi me marrë fjalën rreth kësaj pike? Marini i pari e ka kërkuar fjalën, pastaj edhe Dafina. Po Marin urdhno.

Marin Përgjoka (LDK): Kjo është hera e pestë që e votojmë, nëse s'gabojmë është e katërta ose e pesta që e votojmë këtë planin rregullativ për zonën industriale. Në vazhdimsi, kemi bërë kërkesa, në vazhdimsi kemi bërë kërkesa te zyrat ligjore përkatësisht te drejtorët e zyrave ligjore që le t'i bëjnë aktet konform ligjit që mos të kthehemi me një punë me u marrë 100 herë. Këtu ka mundur me qenë një pikë e rendit tjetër të ditës që ka qenë ndoshta shumë më thelbësore për qytetarët se sa me u kthi na tash për neglizhencë ose për mos kompletim të aktit sipas ligjit që e parasheh. Mos mos të bëjmë gabim në vazhdimësi, janë me dhjetra pika të rendit të ditës në seanca që jemi kthyer, plotësimi, kthimi, plotësimi, kthimi. A bëhen në konform ligjit edhe kërkesave të Ministrisë këtu? A çfarë t'ju bie ndërmend bashkëgjithnjë këtyre kërkesave për Ministri?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, urdhëro Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Po të njëjtin shqetësim e kam edhe unë. Këtë gabim ose këtë lëshim kush e ka bërë dhe a ka marrë ndonjë masë? Për shkak që nën një keni pasur premtim që brenda gjashtë muajve aktivizohet zona ekonomike, nuk është bërë. Po na sjellni këtu vendime gjysmake edhe pse sa herë i kemi bërë thirrje që a janë kompletuara dhe a janë gjithçka konform ligjit. Tash a ka

mundësi me ditë bile që ai zyrtar që e paska harruar? A ka ndonjë përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe ndaj legjislativit që sa herë që vijnë të pakompletuara dikush ish dashur me dhënë përgjegjësi drejtor.

Pranverim Berisha (Drejtor DUPH): Po Dafina, këtu fjala është për dokumenta shtesë që është kërkuar nga Ministria tek shqyrtimi public, domethënë te raporti i shqyrtimit publik me ja bashkangjitur edhe në bazë të nenit tetë, domethënë të udhëzimit administrativ. Kjo është, ja kemi plotësuar domethënë atë kërkesën e Ministrisë edhe në rregull.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, urdhëro Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Ky neni tetë, a doli pas aplikimit tuaj apo? A nuk ka qenë lista e dokumenteve të cilat duhet, Ministria ka të drejtë me i kërkuar ato që ja kërkon ligji. Unë nuk besoj që pas aplikimit tuaj kanë dalë nene të reja tash edhe po ju kërkojnë ekstra punë me bë. Nuk është mirë bre me na lajthitë, a bënë me pranë që ka gabuar drejtoria? Nuk është në rregull me na lajthitë kështu. Edhe pyetja tjetër për zonën ekonomike, ç'ka mbas kësaj? Tash kjo pjesa e urbanizmit po besoj e po shpresoj që përfundon. Ju s'jeni kompetent, mos e merrni ju për. Tash ju drejtor, çka tash e mbas, po shpresoj që u votua, në rregull është me Ministri të Ambientit, çka pas kësaj?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, a keni drejtor përgjigje? Ani nëse s'ke në rregull. Po Sel mani e ka fjalën rreth kësaj pikë. I marrim anëtarët e kuvendit mandej drejtorët që kanë përgjigje në fund rreth kësaj pikë.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, para disa muajsh në një takim të Ministrisë së linjës kemi qenë me disa prodhues të Prizrenit edhe është trajtuar, veç kemi dëgjuar bashkë me kolegun Faruk, me të vërtetë biznesmen, prodhues vendor shumë të përgatitur edhe shumë të interesuar me funksionalizuar atë zonë sa më shpejtë. E e-mailave të Ministrisë, se u pretendua aty që nuk ka qenë i ftuar Kryetar i Komunës, asistentët e Ministrisë me ne i nxjerrën telefonatat, e-maillet që Krytari i Komunës kishte qenë i njoftuar, mirëpo krytari vetë nuk ka marrë mundin me shkuar, por edhe nuk e ka deleguar askënd, as nuk e ka njoftuar drejtorin në fjalë, as më duket zoti Tarashaj s'ka qenë i njoftuar. Ministria atje u zotua edhe publikisht edhe para prodhuesve, pra atynve që kanë me e shfrytëzuar atë zonë potencialisht që është e gatshme me dikë prej ministrisë në çdo hap me punuar bashkë, mos me ardhur puna për kësi probleme edhe për kësi vonesa. Kështu që duhet me lënë anash gjithçka, zgjidhni personat që doni me i qu në ministri, takojnë me ministren, kushdo që të jetë ministër, kushdo që është aktualisht edhe zgjidhni këtë problem se u bë gjashtë muaj funksionalizim, jemi në gjashtë mujorin e fundit edhe prapë na vjen e na rivjen e na rivjen me votuar e pasmi harruar diçka, duhet me shtuar diçka. Kështu që, ju çka keni kompetencë në atë punë merreni seriozisht, shkoni takohuni me ministren zonjën Rozeta është aktualisht mund të me qenë dikush tjetër, edhe ka ofruar asistencë për shkak se, po qeshtu tuj qesh i keni lënë gjërat në asgjë, ose po doni me vazhduar këtë formën tjetër se po i qeshet drejtorit, domethënë po presin biznesmen çfarë probleme, çfarë telashe ju shkaktohen prodhuesve që s'po funksionalizohet ajo zonë. Edhe ne këtu e marrim me hajgarellëk kështu tuj qesh. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër rreth kësaj pike, zoti Thaçi?

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit kryesues. Realisht po bëhet që thujse ka katër vite që kemi ngecur në funksionalizimin e zonës ekonomike. Kaniher është mirë edhe me pranuar fajin, pavarësisht kohës dhe e momentit. Po mendoj se ky ekzekutiv fillimisht qysh vitin e parë u ngut, formoi një komision që duhet të jetë i fundit në funksionalizim, pa i shikuar procedurat se ku ka mbetur në procedurë funksionalizimi. Duke shikuar materialin, drejtor vërejtja diçka që është thujse dukuri një kohë e gjatë në dëgjimin publik që po organizohen mos prezenca e qytetarëve, do të thotë në dëgjimin publik këtu po e vërejtë që gjithsejt nëntë veta kanë qenë, prej tyre punonjës të komunës janë shtatë ose gjashtë e të tjerët janë nga kompania e angazhuar në këtë rast. Po kthehem te kjo se prapë faji bie mbi ekzekutivin për zhagjitjen e mosfunksionizimin e kësaj qendrës ekonomike. Arsyeja dy i përmenda, po e treta është që me nguti është pruar harta zonale duke veqar, do të thotë kjo është vërejtja e parë me sa di që e kemi marrë për shkak të mospërfshirjes së zonës ekonomike brenda hartës zonale, a ka qenë kështu? Do të thotë me fillim të mandatit janë marrë veprime të ngushme, duke menduar që do t'i realizojme premtimet e kryetarit. Do të thotë dy hapa gabim kanë krijuar vënezë tri vjeçare, a është kështu? Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër a ka? Në qoftëse jo, atëherë jemi në proces të votimit. Ju lutem nëpër vendet tuaja, meqë jemi në proces të votimit. Atëherë pikën e katërt po e hedhim në votim. Prezent jemi 34 anëtarë. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit ditës? 32 jemi për, kundër a ka, zero kundër, abstenim, zero abstenim. Atëherë miratohet pika e katër e rendit të ditës. Si të doni po vazhdojmë edhe me një pikë edhe mandej shkojmë për pauzë.

Pika e pestë:

Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, plani i punës i ka kaluar të gjitha procedurat. Fillimisht është themeluar grupi punues me përfaqësues të subjekteve politike, e kemi marrë konfirmimin e ligjshmërisë, pastaj e kemi ftuar edhe punëtorinë ku kanë marrë pjesë grupi punues, shefat e grupeve parlamentare, përfaqësues të ekzekutivit si dhe përfaqësues nga OSBE. I kemi marrë propozimet për pikat e planit të punës që parahihen të shqyrtohen dhe miratohen gjatë vitit 2025. Kjo agjendë e punës së kuvendit është planifikuar deri në muajin shtator 2025 për shkak të zgjedhjeve lokale të cilat parahihen të mbahen në tetor. Mirëpo nëse paraqitet nevoja kuvendi mund të mbajë mbledhje edhe pas shtatorit derisa të çertifikohen rezultatet e zgjedhjeve. Kështu që nëse kemi propozime të tjera mund t'i përfshijmë edhe ato. A ka dikush ndonjë propozim në lidhje me planin e punës? Në qoftëse jo atëherë po hedhi në votim. Prezent jemi 32 anëtarë. Kush është për që të miratohet edhe ky plan i punës? Plani i punës së kuvendit. 31 jemi për, kundër, a ka? 0 kundër, 0 abstenim? A jeni të pajtimit me vazhduar edhe me një pikë meqë s'është ora 12:00. Është miratuar plani i punës, ju faleminderit. Kalojmë te pika tjetër, te pika e gjashtë.

Pika e gjashtë:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit për vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera për komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtoreshë fjala për juve.

Ramize Shala Sinanaj (Drejtoreshë DES): Faleminderit kryesuese. Këtu është zyrtari i kompanisë i cili e ka projektuar këtë plan edhe ai do ta prezantoj këtë plan.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Në rregull atëherë e ftojme zyrtarin i cili ka me prezantuar. Presim pak derisa të përgatiten, pa problem presim. Po fjala për juve është i nderuar.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Faleminderit përshëndetje për të gjithë. Unë jam Idriz Shala, me profesion jam gjeograf,

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem për vëmendje, po fillojmë. Po fjala për juve është i nderuar.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Faleminderit. Do të mundohem shkurt ta prezantoj domethënë vlerësimin e projektit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për komunën e Prizrenit. Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën saizore dhe cilësore të natyrës dhe rrethanat e tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Si çdo pjesë e Kosovës edhe komuna e Prizrenit mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore, me qëllim të ngritjes së vetëdijës qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më me kualitative dhe më të sigurtë. Ka probleme teknike, më falni. Dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Komuna e Prizrenit është përgjegjëse për organizimin, mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për qytetarët të komunës së Prizrenit. Kemi probleme teknike.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): S'është problem, mos u ngut. Nëse ju duhet shumë kohë me pritë?

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Jo, jo.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Në rregull.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Domethënë ne kemi përdorur infrastrukturën ligjore për rregullimin e projektit. Është përdorur rregullorja e metodologjisë së hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, rregullorja 2025/2020, prap probleme. Jo nuk është problemi me lexuar, por problemi është me i prezantuar hartat.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A kishim kaluar tek pika tjetër derisa ta rregullojnë, meqë e kemi edhe një pikë për votim derisa zotëriu ta rregullon laptopin. Që mos të humbim kohë edhe mos të ngutet zotëriu. Atëherë po kalojmë te pika e shtatë.

Pika e shtatë;

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Nënës Terezë në Prizren.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Siç e keni parë edhe materialin, neve na duhet me marrë një vendim për themelimin e këtij Muzeu. Në qoftë se keni ndonjë pyetje, drejtori e tha që nuk do të jetë prezent këtu. E keni ndonjë pyetje me parashtruar pastaj edhe me shkrim mundet me jua dhënë

përgjigjen. Prej anëtarëve të kuvendit nëse dëshironi me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Po zonja Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Sikurse gjithmonë DKRS-ja vepron dhe pastaj e sjell në kuvend. Ne kemi qenë në hapje të Muzeut, është hapur zyrtarisht, tash me ardhur këtu me marrë vendime pas hapjes tregon shumë për neglizhencën e ekzekutivit kundrejt legjislativit! Me gjasë po e keni të sigurt që i keni votat blanko edhe po vazhdoni me vepru' kështu, por nuk është në rregull. Muzeu është hapur para dy javëve edhe është hapur pa këtë dokument, edhe tash kjo tregon prapë për arrogancën e Drejtorit të Kulturës edhe për veprimet e tija të jo logjikshme. Andaj le ta vlerësojnë qytetarët edhe legjislativi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po ne këtë çështje e kemi...

Dafina Alishani (LVV): Po nuk është në rregull edhe prej anës të juaj Kryesuese sepse besoj edhe ju keni qenë atë ditë në hapje, ishte dashur me i thënë që kjo nuk është votuar. Tash për hir të bashkëpunimit që është edhe një OJQ, edhe Ministria, edhe drejtoria. Ne po jemi në pozitë të keqe mos me e votu, plus edhe vlera e Nënës Tereze, po nuk shkon kështu, nuk ishte dashur me vazhdu kjo qasje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Në rregull Dafina. Që po thua nuk ju kam thënë, është e vërtetë që ju kam thënë, meqë ka pasur këtu punë Ministria dhe organizata dhe DKRS-ja, nuk kisha unë. Jo ndëgjo, nuk e di që, jo jo absolut, nuk e thashë këtë. Thashë meqë kanë pasur bashkëpunim të triat këto edhe nuk e di qysh kanë rrjedhë procedurat kështu. Kështu që më mirë është ndoshta tash me e marrë sesa hiç me e lënë pa vendim, këtu është arsyeja. A për që ju kam thënë, ju kam thënë se më thatë që nuk i keni thënë. Po thashë, meqë kanë të bëjnë këtu edhe OJQ, edhe Ministria, edhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, edhe nuk e di pse qysh ka ardhur deri te ky moment. Por në qoftëse keni nevojë, mundet edhe zoti Naim Kukaj ndonjë sqarim e dhënë. Po zoti Kukaj fjala për ju.

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Përshëndetje. Neve na ka dhënë një detyrë, një obligim me bërë vendimin për aktin e themelimit, i kemi konsultuar ligjin, njëri prej tyre ligji për Institucionet e Kulturës që e thotë themelimi i Institucionit të Kulturës që i bjen edhe Muzetë. Ne e dimë që nuk ka pasur vendim për themelim të Muzeut Nënë Tereza edhe kemi patarsysh me bërë një vendim. Pjesa tjetër nuk e di qysh ka shkuar dhe çka ka shkuar. Mbas kësaj ne kemi me e bërë Statutin e Muzeut, që llogariten ato organe drejtuese, funksionimi, buxhetimi, punësimi, krejt ato shkon me statut që ka me qenë ndoshta në periudhën e ardhshme tash e tutje. Për momentin ne e kemi obligim ligjor me e votuar. A u kan dashtë tash a para një muaji, unë nuk mundem me e ditur, por mendoj që jemi konform ligjit ne si zyre e kuvendit.

Dafina Alishani (LVV): A është conform ligjit me u hapë pa këtë vendim?

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Ajo çështje politike, ndoshta edhe organizative. Nëse keni ndonjë pyetje, kjo është.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Kukaj. Atëherë në qoftë se nuk ka edhe dikush tjetër, po e hedhim në votim. 27-të jemi prezent. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit

të ditës? Ju lutem ta mbani pak më lartë dorën. 24 jemi për, kundër a ka? Atëherë me sa e pamë pak me vonesë, po unanimisht është votuar pika e shtatë e rendit e ditës. Ju faleminderit të gjithëve. Po kalojmë, po rikthehemi përsëri te pika e gjashtë nëse jemi gati për prezantim.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Të nderuar, problemet teknike ende nuk janë riparuar, por mund të fillojmë kështu. Po, mund të vazhdoj kështu.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Vazhdojmë, ju lutem.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Faleminderit. Domethënë për hartimin e projektit janë përdorur ligjet kompetente, gjithashtu edhe rregullat për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë. Domethënë rregullorja numër 25/2020. Komuna e Prizrenit, ka një superfqare rreth 627 km², kufizohet me komunat fqinje, domethënë Gjakovën, Mamushën, Rahovecin, Suharekën, Shtërpçën dhe në jug me komunën e Dragashës, si dhe kufizohet me dy shtetet fqinjë, domethënë në perëndim me Republikën e Shqipërisë dhe në jug-lindje me Maqedoninë Veriore. Komuna e Prizrenit gjithashtu ka 76 vendbanime zyrtare, gjenden në lartësi mbidetare 300 metër deri në 2000 metër në lartësi mbidetare. Komuna e Prizrenit thamë që përbëhet prej 76 vendbanime, të cilat hiten 147.246 banorë, siç dhe dendësia e popullsisë është 235 banorë për km². Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë së mbajtur vitin e kaluar, shfrytëzimi i tokës domethënë në komunën e Prizrenit rreth 58% e superfqares është e mbuluar me toka bujqësore dhe kullotë, 31% me pyje, 5% me toka ndërtimore, ndërsa pjesën tjetër përfshinë kategoritë të tjera si transporti, sipërfaqe ujore, industri, tregti e tjera. Në territorin e komunës së Prizrenit kemi gjithsej 1177km, prej tyre 2.3% janë autoudhë, rrugë nacionale 2.7%, 7.5% rrugë regjionale si dhe 87.6% rrugë të tjera. Janë digjitalizuar gjithashtu 167 ura, pastaj janë identifikuar rreziqet nga rrugët të cilat kanë ngrica sidomos gjatë sezonit të dimrit, ku gjithëjt kemi 146 km në tërë territorin e komunës së Prizrenit. Janë identifikuar gjithashtu rreziqet nga vërshimet, janë të prezantuara të gjitha me harta, mirëpo fatkeqësisht s'mundëm me u lidhur me projektor. Rrjeti hidrografik i komunës së Prizrenit është relativisht i dendur, kjo paraqet pasojën natyrore të komunës dhe në një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktivitetet njerëzore. Lumi Drin i Bardhë edhe pse nuk buron në komunën e Prizrenit, të gjitha procat dhe lëmejtë derdhën në të, të komunës së Prizrenit. Janë hartuar skenarët, si masë parandaluese, domethënë grupi grupi punues për hartimin e dokumentave të vlerësimit të rrezikshmërisë rekomandon të bëhet pastrimi dhe rregullimi shtratit te disa procka të cilët janë të degraduar nga materialet inerte. Inspektoriat komunal duhet të ndërmerr masat e nevojshme për inspektimin dhe rritjen e kontrollit dhe pengimin e ndërtimit rreth lumnjëve dhe veprimeve pa planifikim dhe leje urbane që mund të rrisin rrezikun nga vërshimet, të ndalohet ndërhyrja e pa autorizuar dhe denigruese e lumnjëve në komunën e Prizrenit që mund të çojnë deri në rritjen e rrezikut nga vëshimet. Të hartohen programet dhe projektet konkrete vetëdijësuese të popullatës si dhe ndërmarrja e masa ligjore ndaj të gjithë atyre që hedhin mbeturinë në vendet e palejuara. Janë hartuar gjithashtu skenarët për tërmete, gjithashtu janë nxjerrur të dhënat për sipërfaqet e rrezikuara nga erozioni. Domethënë sipërfaqja pa erozion gjithashtu është 7%, erozion shumë i dobët 15%, erozion i dobë 21%, erozioni i mesëm 36%, erozioni i fortë 11% dhe shumë i fortë është 10% e territorit të komunës së Prizrenit. Gjithashtu janë analizuar domethënë dhënat për pasojat nga Breshëri, vazhdimisht domethënë Breshëri ka bërë dëme në bujqësi në dëmtimin e produkteve bujqësore të cilat Ministria e Bujqësisë dhe Komisioni Qendror për vlerësimin e dëmeve vazhdimisht është munduar me i kompenzuar dëmet tek ekonomitë familjare bujqësore. Gjithashtu janë identifikuar dhe digjitalizuar pikat e karburantit. Kemi gjithashtu 57 pompa të

derivate në komunën e Prizrenit. Janë digjitalizuar dhe analizuar kapacitetet shëndetësore publike. Detyrat e ekipeve për shërbimet mjekësore në situata emergjente janë ofrimi i ndihmës e parë medicinale në vendin e incidentit, evakuimi dhe bartja e adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësive në qendrat spitalore dhe repartet e tjera të specializuara. Marrja masa preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes e tyre. Aplikimi i sistemit të mbrojtjes, karantinë në rastin e shfaqjes të sëmundjeve të ndryshme infektive të tjera. Gjithashtu janë digjitalizuar objektet e ndryshme edukative, duke filluar nga parashkollre, filloret, të mesmet, universitetet publike, private e tjera. Gjithashtu janë digjitalizuar edhe objektet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, të cilat janë të paraqitura me harta në dokument, si dhe objekte me rëndësi të veçantë për hapësirat qeveritare në komunën e Prizrenit. Janë digjitalizuar gjithashtu shfrytëzimi i tokës si sipërfaqet pyjore të cilat janë njëkohësisht edhe vatrat e zjarrit mund të quajmë, pjesën lindore dhe juglindore të komunës së Prizrenit janë më të theksuara pyjet si dhe në pjesën perëndimore të komunës, domethënë zonën e Pashtikut. Hartimi skenar domethënë është kompletuar sipas metodologjisë e dhënë nga institucionet përkatëse, Janë hartuar domethënë tre skenare për zjarret, dy skenare janë marrë si shembull zonat pyjore dhe një skenar për zonat urbane. Janë hartuar tre skenare për përmbytjet, janë hartuar tre skenare për zonat erozive dhe rreshitjet e dheut. Është e hartuar një skenar për tërmetet, domethënë janë identifikuar nëpërmjet hartave dhe vatrat e zjarrit ku kanë ndodhur në komunën e Prizrenit. Gjithashtu janë siguruar të dhënat nga zjarrëfiksit për llojin e zjarrit si edhe numri i tyre sipas vite, të cilët janë prezantuar me anë të grafikoneve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem i nderuar, pa dashur me ju ndërhy vetëm se nuk po kam dëshirë me u lodhur ju më shumë meqë e kemi pasur materialin disa ditë. Nëse pajtohen anëtarët e kuvendit, nëse kanë ndonjë pyetje me e parashtruar, kështu që mos të hyjmë edhe një herë me i përsëritur ato. I kemi pasur materialin nëpër dorë. Po Petrit, a ke diçka? Po, në qoftë se kanë anëtarët. Ju kërkoj falje që si po deshta me ju lehtësuar edhe juve. Po Petrit Hoxhaj, pastaj Qemal Krasniqi.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit Kryesuese. Unë kam një pyetje se a është bërë ndonjë analizë e tokës në ndërtimet e larta të cilët janë duke u ndërtuar në komunën e Prizrenit? Po ashtu banesa të cilat janë ndërtuar, a kanë shkallë emergjente secila në komunën e Prizrenit dhe nëse jo, a keni dhënë ndonjë rekomandim ndaj ndërtuesve dhe personave të cilat kanë bërë ndërtimin e tyre? Dhe a keni vërejtur edhe në institucionet shtetërore në komunën e Prizrenit, a janë të pajisur me shkallë të emergjencës? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po nëse keni përgjigje mundeni më përgjigj?

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Faleminderit për pyetjen. Në këtë projekt nuk është bërë analizë e llojit e tokës për ndërtimet e larta, por janë dhënë sipërfaqet e rrezikuara nga erozionet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, zotëri Qemal Krasniqi.

Qemal krasniqi (LDK): Faleminderit. Edhe unë kam një pyetje. I drejtohem përfaqësuesit të grupit punues. A mundet me na treguar cilat janë ato pjesë të rrezikuara nga Vërshimet dhe Breshëri?

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Po, zonat e rrezikuara nga vërshimet janë të prezantuara edhe në harta, më e theksuar është zona te fshati Piranë, fshati Krajk, domethënë afër lumit Drini Bardhë, mirëpo si zonë e rrezikut është paraparë edhe pjesa e Lumbardhit në daljen e qytetit të Prizrenit në drejtim të Vermicës. Por janë të identifikuar disa pika të tjera, sikurse siç ishte rasti vitin e kaluar në fshatin Lobinjë që ka pasur raste, domethënë janë kontaktuar kryetarët e fshatrave për historikun e këtyre ndodhive të fatkeqësive që kanë ndodhur dhe të gjitha domethënë janë prezantuar në hartën tematike të vërshimeve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po urdhëro zotëri Qemal.

Qemal Krasniqi (LDK): Zotëri më shumë keqkupto. Unë ndoshta edhe u prezantuat, unë as nuk arrita me u kuptu nga jeni, se sikur të jeni qytetarë të Prizrenit, banorë i komunës së Prizrenit, ju shumë më lehtë do sene i kishit pasur mundësi me i ditë. Jo vetëm komuna e Prizrenit po gati edhe gjithë Kosova e dinë se çfarë rrezikshmërie ka pjesa nga Mamusha deri në Piranë, jam pjesë e atij lokaliteti dhe e di që Lumi i Toplluas që fatkeqësisht nuk e përmendët fare, ka një rrezikshmëri të jashtëzakonshme. Për këto ne kemi bërë kërkesa, kemi kërkuar ndihmë nga ministritë përkatëse për rregullimin e infrastrukturës të Lumit Topllua, sepse ka shumë vërshime dhe ajo pjesë ndihet goxha e rrezikuar nga lumi. Ju nuk e përmendët këtë, s'di a keni qenë atje.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): A mundem të përgjigjem. Po, fillimisht unë jam i lindur në Prizren, jam nga komuna e Rahovecit, jetoj në Prishtinë, jam shumë i familjarizuar me territorin e komunës së Prizrenit. Fakt është që s'e përmenda Lumit Topllua, mirëpo këtu në hartë janë të prezantuara të gjitha dhe zona më rrezikuar është pjesa kur Lumi Topllua bashkohet me Drinin e Bardhë, sidomos te fshati Piranë, aty te ura. Janë të paraqitura të gjitha në hartë, por fatkeqësisht nuk mujat me u lidhur me projektor dhe me i po zonat.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po sqarohu tash deri në fund meqë.

Qemal Krasniqi (LDK): I ndrum, pikërisht bash te Pirana aty s'ka kurrfarë rrezikshmërie, bash hiç s'ka, prej pjesës të dalimit prej Mamushës deri afër Piranës ka vërshime, në atë pjesë ka vërshime, por krahasim me këto të tjera, unë e di mirë atë pjesë. Po po më duket që nuk e paskët analizuar, nuk e paskët vlerësuar qysh duhet, më vjen keq, por po detyrohem me të thënë.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Mund t'i shikojmë hartat, edhe të rejat edhe të vjetrat edhe do të bindesh për saktësinë e të dhënave.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, Bajram fjala për juve.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit Kryesuese. Përshëndetje i nderuar. Rrezikshmëria nga fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësi të tjera në komunën e Prizrenit. Tek fatkeqësi të tjera a është e paraprë rreziku nga rrjeti elektrik, nëse s'gaboju quhet 52 a 92, s'di qysh është i emërtuar, që është i shtrirë në mes të qytetit. A janë të parapara edhe këto rreziqe?

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Faleminderit për pyetjen. Po, hyjnë në kategorinë e rreziqeve të tjera, mirëpo tash, këtë rast për infrastrukturën e rrjetit elektrik është përgjegjës organizata e KEDS-it, ata duhet të eliminojnë problemet nëse ka, domethënë hyjnë në atë kategori. Përndryshe

në kategori të tjera hynë edhe shpërthimi i pendave, sulmet terroriste, me një fjalë të gjitha ato probleme që shkaktohen nga dora e njeriut.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. A ka dikush tjetër diçka me shtu? A keni pyetje të tjera? Ertan urdhëro.

Ertan Simitçi (YTHP): Faleminderit shumë për prezentim. Vetëm sa për informatë. Qeky raport që e keni përgatitur apo prezentim, për çka na duhet? Domethënë, kush duhet të analizojë këtë raport, cila drejtorja apo a i vlen drejtorit që i bëjnë planifikimet për infrastrukturë, që japin leje Drejtorja e Urbanizmit a ka me me marrë si vlerësim këtë raport apo jo? Apo veç me pas si me plotësuar kushtin ligjor.

Idriz Shala (Përf. i kompanisë): Faleminderit për pyetjen. Natyrisht që ky raport është i rëndësishëm për të gjitha drejtoritë, mirëpo në bazë të këtij raporti, Drejtorja e Emergjencës së bashku me institucione të tjera komunale, po edhe në bashkëpunim me Agjencinë Emergjence, mund të bëjë planet e reagimit emergjent. domethënë nga skenari që janë hartuar prej këtij dokumenti, domethënë bëhen planet e reagimit në raste të fatkeqësive natyrore, apo ushtrimeve të ndryshme nga ky dokument. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dikush tjetër? Po zoti Muçaj, urdhëro.

Agim Muçaj (AAK): S'di ndoshta kot po inkuadrohen, po në këto dëgjimet që i bëmë deri tash, sigurisht se ne këtu si kuvendar nuk jemi ekspertë të kësaj lamije, besoj që Drejtoresha për Emergjencë ka njohuri më shumë dhe ato përgjegjësi që i takojnë drejtorisë dhe stafit të vetë. Mendoj se këta duhet të merren më shumë me këtë analizë, ku duhet të jipen leje apo intervenime. Kështu që mendoj se ne si kuvendarë sigurisht se veç kot jemi kah i dëgjojmë se sen s'jem kah kuptojmë se çfarë do të ndodhë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtoreshë, urdhno.

Ramize Shala Sinanaj (Drejtoreshë DES): Faleminderit Kryesuese. Fillimisht po ju tregoj se ky është një dokument shumë i rëndësishëm për komunën e Prizrenit, është obligim ligjor që secila komunë duhet ta ketë këtë dokument. Fatmirësisht komuna e Prizrenit e ka hartuar këtë dokument. Fillimisht është bërë vendimi, një vendim ku prej secilit institucion është nga një anëtar për me marrë pjesë në këtë plan, në këtë vlerësim të rrezikut, në mënyrë që me i marrë të dhënat prej secilit institucion. Këtu ka pasur të përfshirë edhe prej FSK-së, ka pasur anëtarë edhe prej Hidroregionit, ka pasur anëtarë edhe prej Spitalit, ka pasur anëtarë prej secilës drejtori. Ky dokument ka për qëllim me i identifikuar zona të cilat na paraqesin rrezikshmëri, qoftë cila zonë është e rrezikume prej tërmetit, cila zonë është e rrezikume prej vërshimeve, cila zonë është e rrezikume prej thatësirave? Edhe në momentet që neve na paraqiten njëra prej këtyre fatkeqësive, ne në bazë këtij dokumenti e dime se cila pjesë është më e rrezikume edhe mundemi me u fokusu. Kështu që, të jemi të qartë, ky është një obligim ligjor, ky dokument është obligim ligjor i secilës komunë, jo veç prej komunës së Prizrenit. Ne e kemi hartuar, e kemi tenderuar si projekt edhe ky projekt është duke u bërë, që një vit ka marrë kohë për me u finalizuar. E kemi dërguar edhe në AME, AME-ja janë ekspert të kësaj lamije. Disa herë na e kanë kthyer, na kanë sugjeruar në pikat ku duhet me ndryshuar. Edhe për atë punë ka zgjatur një vit derisa është shoshitë shumë mirë edhe kur na e ka

dhënë miratimin AME-ja, se tash ky dokument i plotëson të gjitha kriteret, ne e kemi qit në shqyrtim publik, ka qenë në shqyrtim publik, tash e kemi pru edhe në kuvend për me votu edhe pastaj do ta dërgojmë edhe në MAPL për me marrë ligjshmërinë. Unë, po mendoj se ky ka qenë vërtet një dokument shumë voluminoz, nëse secili prej juve veç pak e kishit shfletuar në pika të trasha, kishit me parë rëndësinë e këtij dokumenti edhe pse është shumë voluminoz. E di, ju kuptoj se nuk jeni ekspert fushës qysh nuk jam edhe unë. Mirëpo dritën e gjelbërt na e kanë dhënë ekspertë e AME-së. Pa, na e dhënë miratimin AME-ja, ne nuk kemi mundur me sjellë edhe në kuvend. Nuk di nëse keni diçka pyetje mundeni me parashtru.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. A ka dikush tjetër? Në qoftë se jo, po e hedhim në votim. Po zotëri Quni urdhno.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit Kryesuese. Drejtoreshë, megjithse ky 53 faqe i ka për me lexuar, për me kqyrë, i kemi kqyrë, se tha s'di a keni kqyrë, po kemi shikuar, po edhe mu pak po dyshoj disa po thua ekspert profesional. Valla do emra që po i shoh këtu, ekspert profesional kurrë s'janë. Gjithçka munden me qenë veç ekspert profesional jo. Mos shkoj me emra tash, po është mirë ky dokument, ishalla do zoti nuk na ndodhë se sa për këta ekspertë sen sun bëjnë këta hiç, veç aty më tepër.

Ramize Shala Sinanaj (Drejtoreshë DES): Jo, nuk më kuptove. Ekspertë janë të AME-së, ata na e kanë dhënë dritën e gjelbërt, ne kemi ofruar veç informacion, ndërsa ekspertë profesionalë janë zyrtarë të AME-së për të cilët nuk na e vërteton vetëm komunën e Prizrenit këtë dokument por të gjitha komunave në nivel të Kosovës. Unë e pata fjalën për ekspertë profesionalë zyrtarë që janë të AME-së.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Atëherë jemi në procedurë të votimit. Hajde urdhëro Faruk.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit Kryesuese. Se disa herë po duhet me marrë fjalën por po folin kolegë të tjerë, ne jse. Unë mendoj që është një dokument shumë i rëndësishëm për orientimin dhe investimet që bënë komuna edhe për sigurinë e qytetarëve në përgjithësi. Mirëpo, ajo që po më brengos dhe po më shqetëson se sa do ta marrin parasysh institucionet ekzekutive, se kjo nuk ka të bëjë me qytetarin. Qytetari mund me ditë informatën se me një pozicion të rëndësishëm të qytetit mund me pasur tërmete, mirëpo drejtori i urbanizmit i jep leje pa siguresa shtesë për mbrojtjen nga tërmeti. Prandaj, është mirë që këto informata që i kemi këtu, është një dokument besoj shumë i rëndësishëm për të gjithë drejtorët, që të aplikohet gjatë implementimit të apo investimeve të projekteve që i bënë komuna apo dhe investorët e jashtëm në qytetin tonë, që të jenë më të siguar për arsye se nëse ndodh një fatkeqësi dhe ka aplikuar zotëria për leje në atë pjesë ku ka ndodhur fatkësia dhe këto informata nuk i ka marrë parasysh drejtorja përkatëse, unë mendoj që duhet me shkuar në përgjithësi për mos angazhimin e mjaftueshëm që të mbrohen shtetarët nga rreziku që i pret.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, urdhno drejtoreshë.

Ramize Shala Sinanaj (Drejtoreshë DES): Po Faruk, po më vjen shumë mire, që shumë mirë e ke theksuar edhe pasi që ta marrim ne ligjshmërinë prej MAPL-së, jemi të obliguar me ja dërguar

të gjitha drejtorive edhe PZHK-ja, duhet me u bazu në këtë plan për me vendosur në të ardhmen. Për atë po e theksoj se është një dokument shumë i rëndësishëm për të gjitha komunat. Por, realisht unë në këtë rast po flas vetëm për komunën e Prizrenit edhe siç e thashë sigurisht që secila drejtori duhet me, kur ka me investuar diçka duhet me e kqyrë në këtë plan se a duhet në vendin të cilin e ka përcaktuar çfarë rreziku paraqet ai vend.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë në procedurë të votimit, e hedhim në votim pikën e gjashtë. 31 anëtar jemi prezent. Kush është për që të miratohet pika e gjashtë? Ju lutem mbani dorën pak më gjatë derisa t'i numërojmë. 28 jemi për, kundër a ka? zero kundër, abstenim? 3 abstenim. Miratohet edhe pika e gjashtë e rendit e ditës. Shkojmë me një pauzë prej 1 orësh, domethënë kthehemi në orën 13:30.

PAS PAUZE

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë të nderuar anëtarë të kuvendit meqë kemi korum edhe janë duke ardh dhe anëtarë të tjerë atëherë po fillojnë për mos me humb më shumë kohë ashtu ashtu kemi filluar me vonesë. Ju falenderoj edhe një herë që jeni kthyer në pjesën tjetër të mbledhjes. Kemi mbetur te pika e tetë raporti financiar për periudhën tetor-dhetor 2024. E ftojme zotërin Likaj për prezantimin.

Pika e Tetë

Raporti financiar për periudhën tetor-dhetor 2024

Halil Likaj (Zyrtar komunal): Faleminderit kryesuese, përshëndetje drejtorit, përshëndetje kuvendarët. Për periudhën shpenzimeve tetor-dhjetor. Totali është 20.752.192 pra prej buxhetit 29.08% është shpenzuar. Sipas kategorive faktikisht edhe prej të hyra vetanake janë realizuar 2.261.373 pra 22.18% dhe tetor-dhjetor faktikisht gjithsej prej investime kapitale janë shpenzuar 8.782.563, pra 34%. Në përgjithësi, buxheti është realizuar nejtë muajin tjetër do të jetë raporti vjetor, po vetëm me ju cekur që 96.22% është shpenzuar buxheti 2024. Po. Këto gjithë janë aty. Faleminderit. Keni ndonjë pyetje?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A keni po anëtarë të kuvendit? Dafina, po të lutem.

Dafina Alishani (LVV): Zotri Likaj, në Komitetin për Politikë dhe Financa u dakorduar që do të na raportoni për suficitin, do të na raportoni për borxhet e operatorëve ekonomik, edhe premtuat që në kuvend do të shfaqen këto statistika me gjithë anëtarët e kuvendit. A nuk kemi të dhëna a po çka është problemi?

Halil Likaj (Zyrtar komunal): Është çështja që vazhdon punimet vjetore domethënë raportit. Kështu që mos të cekim diçka që nuk është definitive, po besoj që në fund muajit mars do të keni

raportin në detaj. Raportin vjetor. Domethënë në tre mujor nuk përfshihen ato domethënë se ende janë në punim. Raportin domethënë përmbyllet në mars. Ende janë në vazhdim domethënë informata që duhet edhe nga thesari me marrë edhe me i krahasu edhe me i kompletuar. Faleminderit.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Unë e bëra një pyetje në kur kishte çështje të pyetje dhe përgjigje nga kuvendarët. Çështja e borxhit të komunës ndaj operatorëve ekonomik sa ka shkuar deri më tash, edhe sa është vlera që operatorët ekonomikë kanë realizuar të drejtat e tyre në buxhet nëpërmjet përmbaruesve apo proceseve gjyqësor.

Halil Likaj (Zyrtar komunal): Lidhur me këtë çështje, mirë është të bëni një kërkesë drejtpërdrejt drejtorit Financës edhe u japim përgjigje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dikush tjetër në lidhje me këtë pikë? Në qoftëse jo atëherë ju falenderoj të gjithëve.

Pika e Nëntë

Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë, të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar të pranishëm, me kënaqësi ju paraqesim raportin vjetor që përmbledh me kujdes aktivitetet, punët, angazhimet, arritjet dhe sfidat e kuvendit. Raporti ka pasur për synim themelimin e një marrëdhënie të fortë dhe të hapur me qytetarët tonë të nderuar. Atëher kuvendi i komunës është organi më i lartë i komunës, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetari dhe funksionon në bazë të ligjit për vetqeverisjes lokale, statutit dhe akteve të tjera nën ligjore. Përbërja e kuvendit të komunës së Prizrenit, faleminderit. Legjislatura aktuale e kuvendit të komunës së Prizrenit është zgjedhur nga zgjedhjet lokale të vitit të tetorit të vitit 2021. Komuna e Prizrenit si qytet i dytë me numrin më të madh të banorëve në Republikën e Kosovës, përbëhet nga 41 anëtarë të kuvendit me përfaqësim të 10 subjekteve të ndryshme politike. Po kalojmë te numri i mbledhjeve të kuvendit. I kemi paraqitur edhe me anë të grafikut ku gjithsej i kemi mbajtur 12 mbledhje të rregullta, të jashtëzakonshme dy, solemne tri dhe zero mbledhje urgjente. Gjithashtu kemi paraqitur nëpërmjet grafikut edhe numrin e pikave, ku vendime janë gjithsej 53 vendime, 4 rregullore, 17 proces verbale, informata dhe raporte 17, rekomandime 0 dhe çështje të ngritura gjithsej 11. Si përmbledhja e aktiviteteve të miratuara sipas muajve dhe mbledhjeve. Mbledhja e rregullt me 31.01.2024, ku në këtë mbledhje është bërë miratimi i procesverbalit të kaluar si dhe është dhënë betimi nga anëtarja e re e kuvendit të komunës zonja Dafina Bllaca. Pastaj mbledhja tjetër e rregullt me 9 shkurt. Mbledhja e rregullt me 6 mars e vazhduar me 12 mars, ku gjithsej i kemi miratuar 12, 24 akte. Mbledhja e rregullt tjetër e 28 marsit ku i kemi gjithsej gjashtë akte. Meqëse i kemi këtu të shkruara për mos me marrë shumë kohë se janë shumë për me i lexuar një nga një. Mbledhja e jashtëzakonshme me 23 prill 2024 ku kemi pas vendimin për bartjen e mjeteve nga të hyrat

vetanake të rritura nga ato të planifikuara të vitit 2023 në vitin 2024. Mbledhja tjetër e rregullt me 30 prill e vazhduar me 03 maj, ku gjithsej këtu një vendim e kemi marrë. Mbledhja tjetër me 30 maj e vazhduar me 3 qershor, gjithsej i kemi pesë akte të miratuara. Dhe mbledhja e rregullt tjetër me 27 qershor gjithsej tri vendime. Mbledhja e jashtëzakonshme me 18 korrik viti 2024. Mbledhja tjetër e jashtëzakonshme me 12 shtator pra vendimi për miratimin e projekt buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027. Mbledhja tjetër e rregullt me 26 shtator 2024 e cila ka vazhduar me 30 shtator. Në këtë mbledhje u miratuan vetëm procesverbalet, kishte diskutime rreth pikave të rendit të ditës. Një nga ato pika u votua kundër dhe nuk u miratua. Ndërsa pikat e tjera kuvendaret lëshuan mbledhjen për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja u mbyll. Mbledhja tjetër e rregullt me 31 tetor 2024. Mbledhja tjetër ku janë miratuar gjithsej shtatë akte ka qenë më 13 nëntor 2024 dhe mbledhja e rregullt tjetra me 19 dhjetor të miratuara gjithsej shtatë akte ku të gjitha këto i gjeni të publikuara dhe në web-faqe të komunës së Prizrenit. Pastaj kemi edhe aktet e kuvendit të kthyer për rishqyrtim nga organi mbikqyrës ku gjithsej i kemi i keni në faqen 11 janë 14 , të tilla të cilat janë kthyer për rishqyrtim. E dini që 13 vetëm që në njërin prej mbledhjeve që i kemi marrë vendimin. Bëhet fjalë për vendimin për mbrojtjen e vlerave të natyrës siç kanë qenë në trungu i qarit në fshatin Vlashnjë e të gjitha këto me radhe. Dhe vendimi tjetër vendimi për miratimin e planit rregullues të hollësishëm zona e parkut për industri të lehtë në Prizren, parku i biznesit sipas hartës zonale të komunës së Prizrenit. Realizimi i planit të punës, plani i punës së kuvendit dhe komunës së Prizrenit për vitin 2024 ka paraparë të mbahen 10 mbledhje të rregullta, por duke mos u kufizuar në ato, pra është përmbushur një obligim i kuvendit, pasi që më shumë se 10 mbledhje të rregullta janë mbajtur. Po ashtu, nga 53 pika që janë paraparë që të diskutohen shqyrtohen dhe miratohen nga kuvendi, numri i të cilëve është përmbushur është 42 prej tyre. Sfidat në realizimin e planit të punës. Sfidat gjatë vitit 2024 kanë qenë kryesisht në sjelljen apo paraqitjen e pikave të planit të punës nga ana e ekzekutivit komunal, më poshtë e kemi paraqitur edhe listën, të cilat nuk janë sjellë. Raporti i Bordit për dhënie në shfrytëzim të objekteve kulturore sportive, shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të KKSBB-së për vitin 2024. Ju kërkoj falje se s'po mund edhe me i lexo krejt. Besoj që i keni faqen 12. Edhe transparenca dhe llogaridhënia. Kuvendi i komunës gjatë vitit 2024 ka demonstruar nivel të lartë të transparencës në procesin e vendimmarrjes për t'i siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Disa aspekte thelbësore që tregojnë që tregojnë transparencën janë si vijon: publikimi i shpalljeve dhe njoftimeve, transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve, publikimi i dokumenteve të mbledhjeve, publikimi i akteve të miratuara nga kuvendi, bashkëpunimi dhe mirëmbajtja e dialogut me shoqërinë civile. Gjithashtu ka qenë një bashkëpunim i mirë. Sfidat dhe problemet kryesore, identifikimi i tyre janë këto, mungesa e stafit në sektorin e kuvendit të komunës, ngecja e përkthimeve në gjuhë zyrtare të dokumenteve të kuvendit, mosrespektimi i kohës së përcaktuar të diskutimeve gjatë seancave të kuvendit dhe moszbatimi në tërësi i planit të punës së kuvendit nga ana e ekzekutivit. Hapa që janë ndërmarrë për të adresuar këto sfida, përpjekjet kanë qenë të vazhdueshme nga ana ime si kryesuese e kuvendit dhe besoj që do të kemi në përmirësim në ato. She prioritetet e planifikuara për vitin 2025. Një nga prioritetet kryesore të përcaktuara për vitin 2025 për kuvendin e komunës sonë është funksionalizimi i plotë në secilën sferë të veprimtarisë së tij. Përmbledhja e përgjithshme, ky raport është pra një përmbledhje e aktiviteteve kryesore që kanë ndodhur në periudhën janar-dhjetor 2024 në kuvendin e komunës së Prizrenit. Pas diskutimeve të këtij raporti në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvend të komunës, planifikohet publikimi i tij në

faqen zyrtare të komunës së Prizrenit. Dhe ky raport do të jetë në dispozicion për të gjithë qytetarët në faqen zyrtare të komunës së Prizrenit, duke theksuar përkushtimin ndaj hapësirës së transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut. Ju ftojme që të ndani mendime dhe vlerësimet tuaja në lidhje me ngjarjet e raportuara dhe të jeni pjesë e këtij procesi të rëndësishëm për zhvillimin e komunitetit tonë. A keni diçka, ndonjë pyetje, ndonjë vërejtje, diçka? Nëse jo, faleminderit.

Pika Dhjetë

Raporti vjetor për planin e integritetit për vitin 2024.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Atëherë, faleminderit shumë. Kam kënaqësinë që të komunikojmë. Komunikimi rrit besim, rrit cilësi, rrit kulturë, rrit gjithçka. Nëse e bëjmë mirë, e kemi fituar betejën me kohën. Jeta jonë bazohet në atë që koherojmë. Domethënë pak sekonda do t'i marrë unë për ju. Plani i integritetit do të vihet në tre dimensione. Integriteti i komunës si institucion, domethënë ku bëni pjesë edhe ju si kuvend, gjatë vitit 2024 kuptohet. Integriteti i personelit në komunë, që i bjen të punësuarit në administratë, por personeli jeni dhe ju në kuvend gjatë punës kur realizon mbledhje kuvendi. Integriteti i vendimmarrjes si proces. Ka dy fusha, procesi ligjor duhet të jetë me patjetër, i praktikave të mira dhe i mundësisë së demokratizimit sa më të madh që është e mundur. Komuna e Prizrenit me kërkesë të liderit të saj, kryetarit të komunës, nënkryetarit të komunës, kryesueses dhe ne si këshilltarë profesional të këtyre fushave kemi kërkuar që komuna jonë të jetë komunë kredibile, komunë konkurruese. Lajmi i mirë është se gjatë vitit 2024 me raportime, kemi arritur që jemi përfitues një granti mbi 2 milion euro, jashtë parave të taksapaguesve të komunës së Prizrenit. Kështu që, unë i përgëzoj qytetarët e komunës së Prizrenit, juve për punën që keni bërë në kuvend. Pra, mbi 2 milion euro kemi të hyra nga jashtë planifikimet që e kemi pasur dhe ato do të shkojnë në ngritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve. Dhe për këtë është lajm i mirë dhe ne ndihemi mirë si komunë në tërësinë e saj ku bëni pjesë edhe ju. Integriteti i personelit në komunë si fushë e dytë. Jemi duke u munduar që me zyrën e burimeve njerëzore të shohim cilat janë nevojat për trajnime eventuale ose për ekspertizë profesionale të secilit të punësuar në komunë. Qëllimi i vetëm është zbatimi i ligjit edhe vendimmarrja mbi zbatimin e ligjit dhe asgjë më shumë e asgjë më pak. A jemi të kënaqur në lartësinë të mëdha? Jo. Ka hale hapësirë duke filluar nga unë. Hale po ndjek modelin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe një lloj mësimi është sot edhe e folura ime sot këtu me ju. Integriteti i vendimmarrjes si proces. Mund t'ju informoj gjatë vitit 2024 e gjithë vendimmarrja e komunës është bazuar në ligj. Nuk kemi asnjë organ i ligjit i cili e atakon ose e konteston vendimmarrjen e komunës e Prizrenit në këtë rast të kryetarit Totaj dhe të tjerëve drejtorive me të cilët administrojnë me mundësinë e nënshkrimit, hapjen e tenderve, shpenzimin e parave publike edhe në politikat e rekrutimit. Çka është në mbetje ose në kërkesë e sipër, ju e keni parë qeveria e Republikës së Kosovës e shpërndan këtë planin e domethënë të integritetit për të gjitha komunat e Kosovës dhe i sheh fushat nga duhet të orientohet vendimmarrja ose puna që duhet ta bëjnë komunat. Tani komuna Prizren në këtë rast normalisht që ka një kuadër të specializuar për shkak të jetgjatësisë në institucione dhe jemi më mirë krahasuar me komunat e tjera. Por me kërkesën që e kërkojnë dokumenti. Jo. Jo, më vjen keq. Po më vjen keq kur reflektohet mungesa e kulturës, më vjen keq po nuk mund me ndryshuar unë. Duhet me ndryshuar ai që e reflekton këtë. Kështu që domethënë në këtë drejtim jemi relativisht

mirë dhe kemi synime elitar. Synimet elitare janë çka? Data 1 janar, 31 dhjetor e secilit vit komuna e Prizrenit, ligjin, zbatimin e tij edhe realizimin e projekteve që i parasheh buxheti ku aprovohet këtu te ju ose te ky institucion. Aspekti tjetër që na vyn me e rregulluar është kjo komunikimi i brendshëm, jo gjithherë sikur që edhe te ju i vërej disa folës të kuvendarëve që të nuk pajtohen me përgjigjet që marrin nga ekzekutivi ose kohën e tjera. Domethënë këtu duhet të punojmë pak më shumë që t'i besojmë njëri-tjetrit. Çfarë na duhet me bë krejt në integritet është ta ndjejmë veten të gjithë të punësuar në komunë dhe komuna është e jona barabërësisht. Jo tash ta e zëm ta reflektojmë shumë kur jeni në karrikën e kuvendarit të jeni ekskluzivist partiak. Keni hequr dorë në momentin kur merrni mandatin me përfaqësu, komunën do të duhej të gjithë ju 41 me qenë në kuadër të vendimeve që shkojnë për llogari të interesit i qytetarëve. A do të mundem me reflektu ta shohim, jemi tu e pa analizat çfarë po i bëjmë. Aspekt tjetër i kemi edhe dy edhe po e mbyll, kemi burimet njerëzore kur hapet një konkurs konkurrojnë me dhjetra për një pozitë që merret. Tash ato 9 pozita të tjera që s'e fitojnë atë pozitë, sikur nuk besojnë që janë zhvilluar barabarësisht krejt këto kritere. Hale na vijnë me punu ose me automatizuar këtë proces ose thjesht me e krijuar, e kemi si të njohur. Jemi duke bërë përpjekje maksimale që me e rregullu. A do të mundim? Shohim dhe bëjmë. Edhe fusha e dytë e ndjeshmërisë së madhe është konkurenca e biznesit, tenderet. Hapet tenderi, ata që nuk e fitojnë tenderin, pastaj kanë zëra se komuna ndoshta eventualisht nuk krijon kushte të barabarta për të gjithë. Edhe në këtë fushë ne e kemi marrë feedback-un e ekonomisë ose bizneseve që operojnë ose që e kanë hapur kanë shprehur dëshirën me punuar me komunën e Prizrenit, por jemi të vetëdijsëm që pa e automatizuar është është problem me e pas besimin e një që e humb dhe domethënë mundësinë konkurese. Por sidoqoftë të jetë në fund edhe njëherë kërkesa e planit të integritetit edhe e qeverisë së Republikës së Kosovës për krejt komunat e Kosovës është: Kosova është e jonë, qytetaria është e jona, kultura është e jona, individuale dhe e përgjithshme se kemi dhe kulturë kombëtare ose shoqërore. Ata që e manifestojnë më së shumti, ata janë burra dhe gra më të mira, ata që e manifestojnë më pak, le ta marrin si përgjegjësi që ta rrisin këtë nivel të komunikimit ose të kulturës. Faleminderit dhe pata kënaqësinë që isha sot.

Dafina Alishani (LVV): Zotëri Berisha, faleminderit për këtë prezantim. E përmendët zyrën e burimeve njerëzore, e përmendët zbatimin e ligjit bashkë me këtë zyrë. Po a mundemi me qujt që ka integritet në një institucion që lejon hala me pas zyrtar me aktakuza në vendimmarrje. Edhe nëse kjo është integritet atëherë si po mendoni me vazhdu me këto veprime ku ki dy zyrtarë të cilët kanë aktakuza edhe vazhdojnë punën e tyre kurse me ligj duhet që me ja suspendu deri në vendim final si dhe meqë po flasim shumë për integritet e vlerësuat gjithmonë pjesën e legjislativit, por nuk pashë ndonjë vlerësim në ekzekutiv. Do të duhej edhe ju si person përgjegjës mbasi keni punuar me këtë plan, integriteti i kuvendarëve si në këtë mandat që është është humb prej qasjes së ekzekutivit, unë nuk mbaj mend që ka pasur ndonjë mandat tjetër. A është edhe mungesa e integritetit nëse një drejtor me seanca të tëra nuk kthen përgjigje? A është mungesa e integritetit nëse një ekzekutiv i tërë nuk ka as respekt, as vlerësim ndaj legjislativit, apo jemi këtu për plane të cilat domethënë ka mundësi me dhënë rekomandime vetëm për legjislativin, a ekzekutivi është i përkryer? Ose po flitni për punësime? Tash ka plot punësime të cilat janë bërë jo për shkak të pakënaqësisë qytetarëve që nuk kanë arritur. Ju e dini shumë mirë çfarëlloj punësime kanë ndodhur në këtë mandat. Nga djali, nga mbesa, nga nusja, të gjitha me rend i ka vazhduar kryetari. Andaj para se të folni këtu në kuvend për integritet, unë uroj që këtë plan ja keni shpalosur edhe kryetarit

edhe ekzekutivit, të cilët vetëm integritetin e legjislativit nuk e kanë hiq prioritet. Edhe kjo është për keqardhje. Prapë po ju them, në secilin vit ju përgëzoj për kësi lloj planesh, për kësi lloj dokumentesh jeni të hatashëm. Po në praktikë po çalojmë. Kështu që për votim ok e votojmë s'ka problem, po nëse nuk shfrytëzohen këto nëse nuk praktikohen këto atëherë po mbesin këto rregulla vetëm në letër e jo në praktikë.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Tani kështu. Persona me aktakuza ligji nuk lejon diskrecion, po e lejon edhe prezumimin e pafajësisë. Asnjë shërbyes civil i komunës së Prizrenit nuk ka të formalizuar aktakuzë. A të kuptova drejtë? Jo jo. Të formalizuar që ka nisur procesi nuk ka edhe prezumimi i pafajësisë. Është diskrecioni i kryetarit të komunës dhe lidërshit, a mund të shfrytëzojë ato të drejta që i ka ai për masa të caktuara. Por ligji nuk është i lehtë që mund me lexu një anshëm. Një person që është në shkelje ligjore e humb të drejtën e punës, madje ka raste kur e humb të drejtën e lirisë së jetës edhe shkon në drejtim të burgut. Mos dyshoni fare, këto saktë ta them, edhe tash, interpretimet mund t'i bëjmë çfarë të doni. Kuvendarët edhe ekzekutivi që tha ekzekutivi e cënon integritetin. Të kuptojmë diçka, integriteti është i secilit individual, kush s'mund mundet me ma cënuar që tu çohet të gjithë ju, dhe thonë Ymer Berisha është kriminel, është e thënë e juaja. Nëse nuk ka krim kërkush të bëhet, unë jam okay. Integriteti im është krejtësisht i rregullt. Mund të ketë perceptime, mund të ketë çfarë të do kush. Integritetin e kuvendit të komunës e Prizrenit nuk mundet me cënuar as kryetari e as ekzekutivi as kërkush. Mundet me cënuar vetëm secili individualisht ose të gjithë bashkë nëse në ndonjë vendim del jo ligjor, jo administrativ, jo korrekt. Atëherë cënohet që kjo që po ja jap edhe një shembull që ka pasur raste kur është votuar edhe është kthyer për rivotim, si e patëm sot një vendim të tillë. Tash këtu është i cënuar integriteti. Është votuar nga 41 kuvendar, ka shkuar në qeveri, qeveria thotë duhet të plotësohet, se kemi votuar krejtësisht korrekt që unë po jap edhe një shembull. Por nuk e cënon ekzekutivi kurrë në integritetin e kuvendit. Punësimet, ju a garantoj, punësimet në komunën e Prizrenit gjatë vitit 2024 ekskluzivisht janë ligjore. As një zero person mund të punësohet nëse nuk i përmbush kërkesat ligjore. Tani diskrecioni se s'ka ndodh gjatë procesit, unë nuk e marr atë përgjegjësi. Secili i punësuar në komunën e Prizrenit, është në plotni me ligjin ose kërkesën e konkursit. Dhe absolutisht ushtroni të drejtat, e tash, unë thashë nëse për një pozitë 10 konkurrojnë, nëntë janë të pakënaqur. Beteja morale ose beteja e të folurit është e humbur se nëntë flasin keq, një flet mirë. Por ne duhet të mësohemi si institucionalistë, unë për atë arsye thash, unë jam i njëjtë me 41 kuvendarët. Librezat edhe flamujt partiakë bien kur vijmë në institucione. Nëse do ta reflektoni këtë, vitin tjetër kur raportoj unë do ta reflektoj edhe në dokument. Se në komunën e Prizrenit për interesat qytetare jemi të gjithë bashkë, kundër ligjit kundër asaj jemi të gjithë kundër. A do të mund me bë? Unë nuk e kam në dorë.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Unë nuk deshta me u inkuadru fare. Po te punësimet që është më e ndjeshme. Nuk është mirë, shumë me i marrë do, tash s'po di në çfarë aspekte, po po të flas kështu në kështu në mënyrë zyrtare, disa barrë të cilat ndoshta nuk takojnë, nuk ju takojnë juve. Tash kuptom, te punësimet që po je aq shumë i sigurt, se janë duke u kryer mënyrën, po thu në mënyrë ligjore, po me letra, shumë e vërtet. Të punësimet, veç ma gjej një që ka hy' me atë që e ka thënë me të vërtetë që e meriton me hy' në vend të punës. Këtu, po s'ki intervenim, po s'jep pare, po s'ke njerëz, këtu s'do hy'n në punë. Këto mundeni me ja thënë dikujt tjetër. E mua që jam këtu që sa mandate e në këtë kuvend, harroni. Bile s'kam dashur me i diskutu'

këto hiç fare. Ma pat thënë dikush edhe më herët këtu tha, "A ke argumente", tha. Thashë, i vogël je me më thënë ose e vogël me më thënë mua, a ke argumente? Argumentin më të madh e kam, ma gjej një punëtor që keni shti që ka hy me intervistë, që i ka plotësuar të gjitha kriteret. Ose kur i kanë dhënë pyetje, pyetjet e gatshme, po. Këtu është më e ndjeshmja është, zotëri Ymer. Po, po. Këto duhet me qenë krejt të sinqertë. Këtu i ceka për me hy në punë çka duhet. Ai i cili e meriton me hy'n në punë, kurrë s'ka hy. Kurrë hiç. Ajkën më të mirë të atyre studentëve që kanë kryer me 10, e kanë marrë në lloj-lloj, ta quaj kështu, certifikata të ndryshme që i kanë kryer edhe trajnime. Ata na e i ka marrë Europa, duke filluar prej doktorit e deri te mësuesit. Po flas, i kemi dy dy femra këtu të Hasit. Kurr se kanë ngritur çështjen këtu në këtë asamble, që sa vajza është në Has, që ka kryer mësuese, çohet mësuesja vjen prej komunës tjetër edhe shkon i jep mësim atje. I paguhet edhe rruga, edhe shpenzimet edhe shkon jep. A vajzat sillen mos ta folin edhe ndonjë fjalë, sillen rrugë, ato nuk sillen rrugëve, po janë pa puna. Ku me e quajt këto të drejtë? Të gjithë jemi prindë, mos harroni. Unë e kam pritur që këto kanë me e ngritur këtë çështje. Edhe me bile me ju ardh keq, që dojnë me emra i them, hiç s'e kam dert atë punën. Le të ma thotë cila e ka kryer intervistën si duhet edhe ka hyrë në punë. Plus ka me emërime. Veç që ka ndërruar vendet e punës. Shko atje, hy'n atje, hy'n atje. Veç mos ma thuaj fjalën sikur që ma pat thënë a ki argumentat? Nuk kam qejf me shkuar me emra, se unë s'e kam dert, kur tu më kris, hiç s'e kam dert atëherë, shko me emra, me mbiemra, me qysh doni. Veç këto është më e ndjeshmja është qekjo. Sidomos te femrat. Prej Gorozhubit filloj, nga ajo ana ku unë e përfaqësoj, e deri në Kushnin të Hasit, kanë shkue edhe prej komunave të tjera. S'jam unë kundër asaj. Ama, pse me i pague rruga? Ose që ku kam Nashec unë, katër, pesë, gjashtë, a shtatë mësuese, që janë martuar. Dhe s'ka mundësi me hy'n në punë. Vjen i paguhet rruga dhe vjen e jep mësim aty. Qysh don me hy' më thell, unë e eksplodoj edhe me emër edhe hiç s'e kam dert atë punë. Mos thoni që është, është në rregull çdo send. Faleminderit.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Zoti Çuni, unë ti e dish korrektësinë personale që... Edhe plani i integritetit nuk e ka për detyrë me marr, kur hapet konkursi edhe me e bë analizën e procesit. Plan i integritetit e ka vetëm kur Ymer Berisha punësohet diku, ne e hulumtojmë, vetëm që Shukri Çuni, Ymer Berishën e hulumtojmë. A ka pasur diplomë sipas kërkesave të kësaj? Nëse na rezultojnë, po, autoriteti im është veç qeky. Nuk është ti imi, ta zëm për ato të tjerat. Unë thashë diskrecioni është i tillë si ne, por bij e bëj edhe një shembull krejt pozitiv. Vajza ime është juriste e diplomuar, kam tentuar me punësu në komunë. Sot punonte te një avokat Blerim Mazreku atje si bashkëpunëtoresh profesionale, nota mesatare 10.00 edhe e masterit. E vërteta është shkoni verifikoni dëshmoni, veç kur e bëj personale, a lejoj dikujt. Me u pas me u pas punësuar një fëmijë juaji, unë krejt çfarë kam mundur me bërë është veç me parë vajza e Shukri Qunit, a e ka diplomën dhe a i përmbush kërkesat e ligjit. Nëse burimet njerëzore më thonë po edhe i ofrojnë, unë e mbyll si lëndë se autoriteti im është vetëm deri këtu. Por po them që është pak punësimi, pak problem edhe kam aplikuar me vajzën time në spital, po ju tregoj, kam biseduar me disa të vetëvendosjes më kanë premtuar, nuk është mbajtur. Po deshe emra jap edhe emra. Nuk është punësuar, po jemi në rregull. E vërtetë po. Okej okej. Faleminderit.

Ymrane Fusha (PDK): Faleminderit kryesuese. Një pyetje kam zotëri Ymer, a është e integritetit me pas kolegun kuvendar këtu i akuzuar edhe është në mesin tonë është. Edhe kemi një deputete në parlament e cila është me aktakuza edhe është ka qenë kandidate prap për deputete a është e integritetit edhe kjo. Faleminderit.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Tash, zonja Ymrane, faleminderit shumë për kontributin edhe shqetësimin, por prap po them veç të kuptoj, të paktën mua. Ideja është kështu, mua nëse ma jep ti që të shishe ujin këtu kam me bërë analizë, jo prej ka erdhë uji. Domethënë ma ke dhënë këtë, këtë s'kam, jo realisht po po mundohem me thënë. Gjyqësia e ka një rrugë krejt tjetër. Unë thashë, personi e humb të drejtën e lirisë dhe kemi njerëz tu punu. Ama kur e humb, veç në momentin kur gjykata thotë, "Ti jaran" nuk e ushtron me këtë detyrë, por shkon në burg pushon. Organe të tjera janë administrative dhe ne veç mund t'i komentojmë, nëse e hapim këtë fushë, unë besoj që është veç diskrecion, tash unë e mirëkuptoj, sikur që e mirëkuptova zhurmën që erdhi nga ata tre kuvendarët e LDK-së, po manifestohet si mungesë e reflektimit të kulturës. Nëse dojmë me shkuar ashtu shkojmë, nëse jo, jemi krejt ok.

Selman Sokolaj (LVV): Zoti Berisha, për momentin, personi në këtë sallë më pa integritet, me na fol për integritet jeni ju. Sapo thatë, kam folur me disa të vetëvendosjes me punësu vajzën në spital. Ky do të ishte interesant për prokurorinë, kujt ke dashur me i dhënë mito, nga ke dashur me ndikuar, ose kush ka dashur ty me të bë në favor jashtë ligjit, pa marrë parasysh kush është edhe pa marrë parasysh çfarë cikël partiake ka, e para. Domethënë është shumë shumë shumë e ulët kjo me marrë fjalën edhe me etiketu një subjekt komplet tash, e godite një subjekt, atë tonë kohën po mundohesh me i mbrojtur personat e caktuar. Tjetra është qasje moniste me na drejtuar neve me thënë ju jeni të gjithë një, sjemi një, është ekzekutivi, legjislativ, ta përfundoj unë tani ke kohë, kështu, edhe ashtu i do debatet. Ne jemi legjislativ, ka ekzekutiv, brenda legjislativit ka bindje, ideologji, preardhje, kultura të ndryshme që i përfaqësojmë. Edhe interes i përgjithshëm, çka është për ju mundet mos me qenë për mua. Për shembull, unë nuk mendoj që Prizreni e ka luksin me ble në thojza bandera 32.000 euro, ndoshta janë të mirë, po Prizreni ka 80% të qytetit dhe fshatrave, si komunë pa mbuluar me ndriçim publik. Edhe nuk e ka luksin me ble aso shtylla aq të shtrenjta. Kështu që interesi i përgjithshëm është çështje definicioni edhe çështje ku e orienton ai subjekt financat. Tjetra, Totaj thatë se ka cënuar integritetin e legjislatit. Kryetari i komunës me fuqinë e tij, me kompetencat, me levat që i ka në dorë të pushtetit, e ka cënuar më së shumti ndoshta nga të gjithë kryetarët e komunave integritetin e Kuvendit. Jo nga të dhënat që i kemi, po edhe nga bisedat, audio që i kemi dëgjuar qysh ai e konsideron kuvendin si një institucion që duhet me ja ble asambleistët, për shkak se një kryetar që s'e kontrollon asamblen, ku me dit sa me qenë i mirë prap ai s'është kryetar, po e citoj Totaj. A thuhet ashtu? Tjetra, a është cënim i integritetit? A e keni vërejtur ju kur persona që nuk kanë licenca të duhur lejohen të vazhdojnë më tutje në konkurse edhe si pasojë dy persona, dy zyrtarë kanë aktakuzë. Jo që s'është marrë masë ndaj tyre, mirëpo ka aludime që të njëjtët po pretendohet edhe me u ngrit. Domethënë si shpërblim për shkelje po i ngrit në detyrë. Cënim më të madh të integritetit të një institucioni nuk ka. Folëm më herët për një projekt publik. Edhe pyetja ndaj një ekzekutivi, pse integriteti është institucional, ne s'na intereson, integritet personal është diçka tejtër. Një person që pa fije turpi gënjen në asamble, vazhdimisht edhe është përballë me ato gënjeshtër, ta marrë shembull konkretisht drejtorin e Kulturës, ai nuk skuqet hiç. Ai nuk e dëmton integritetin e vet personal, ajo po se po. Po e dëmton integritetin e institucionit, e dëmton integritetin e një institucioni të Kulturës në Prizren, në një qytet që ndihet edhe si qytet i kulturës. Kemi rastin te projektet këtu tash që thash. Unë flisja për një projekt edhe për një kërkesë për qasjen në dokumenteve publike që më është afruar. Të dhënat që më kanë ofruar mua prej komunës, nuk korrespondojshin me deklaratat gojore të drejtorit përkatës. Ku ka cënim më të integritetit, se ai person ose nuk e ka idenë çka është duke bërë, ose është duke vepruar

diçka ilegalisht, po dikush e ka hetuar edhe kqyr me largu vëmendjen, ose nuk është i aftë me e kryer atë punë. Edhe ajo ja cënon integritetin. Kështu që kur të flasim për integritet, qysh ekzekutivi s'ia cënon integritetin legjislativit edhe qysh vazhdimisht shigjetat i kishe ka legjislativit, ekzekutivi ja cënon shumë integritetin. Ne duhet me marrë masa, duhet me gjetur mekanizma qysh me ja ndaluar pushtetit, me përdorur leva të pushtetit që me na ble në thonjëza themi neve edhe ne me vepru tani jo në interes të qytetarëve ose asaj qysh ne e mendojmë që është në interes të qytetarëve. Siç ju thashë, krejt është çështje qysh ne e mendojmë, po me vepru në bazë të asaj që ne e kemi marrë besimin e qytetarëve me ardh këtu edhe me ushtruar një funksion, i cili e ka një kohë zgjatje të caktuar. Faleminderit.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Zoti Sokoli, unë të falenderoj shumë që domethënë unë e mora si fyerje atë që qenkam personi më pa integritet këtu dhe përjetova fyrjen e parë. Në këmbim për me të kthyer përgjigje është faleminderit shumë, ndihem i vlerësuar. Ndërsa sa i përket të folurave të tjera, unë thashë sa herë që shkojmë në diskrecione, mundësia për gabim është mbi 90% për gabim se e flasim mendimin ne që e kemi. Kur ne e korrektojmë me të drejta ligjore, mua, qeveria e Republikës së Kosovës, nuk më ka thënë, shko ti e bjere ligjin këtu, e ka kryetar i komunës. Mua më ka thënë, me planin e integritetit shko mbaj kontroll të caktuar. Edhe unë thashë, ndash te punësimet, ndash ku duash. Unë veç e marr lëndën, Selman Sokoli, është zyrtar prej datës kaq. A i ka dokumentet, a flasin dokumentet jo se Selmani ose Ymeri? A flasin dokumentet që e meriton punën sipas ligjit? Nëse po, tik i gjelbërt, shkojmë tutje. Domethënë mandati është këtu. Sa jam kuptuar unë të ju, domethënë ti ma prune një epitete që s'do të doja me dëgjuar, por e dëgjova, okay, shkojmë tutje. Ekzekutivi, kërkush kërkon nuk e cënon. Që jeni një është se me të thënë ty, cila pozita publike, ke me thënë kuvendar? Cila pozita publike e secilit juve veç e veç, është kuvendar. Del, kuvendi është një, nuk ka kuvende më shumë. Këtë e thashë që jeni të gjithë një nga një dhe të gjithë bashkë, se jeni kuvendarë dhe prezantoni kuvendin e komunës së Prizrenit. Sa i përket partive politike që e përmenda, unë s'po marr tashmë emra, po të tregoj unë jam në nevojë, nëse eventualisht mund të ushtrosh 10.00 me notë e bachelor edhe këtë, kur duash fillojmë prapë, bisedojmë edhe nëse e punësoj vajzën time, ka me të qenë mirënjohës. Faleminderit shumë.

Selman Sokolaj (LVV): Vajza juaj, se hytë në personale, që s'është punësuar në komunë, nuk ke parimore kjo. Se ju thatë kam biseduar me dikë me e punësu dika tjetër. Domethënë ju nuk i keni thënë vajzës shko apliko edhe beso në aftësitë tuaja. Ti ke biseduar me disa të s'po e përmendi prap. Kështu që kjo s'është parimore dhe sa i përket kuvendit, kuvendi është i komunës së Prizrenit. Më fal zoti Berisha, ju e dini që më pëlqejn debatet me ju, mirëpo këta kolegët e tu nuk e di ose s'kuptojnë kurrëgjë kur të hynë pak më jashtë gjërave ose se vazhdojnë vazhdimisht një farë kështu një farë sjellje cinike. Kështu që unë, domethënë, me me qejf i bëj debatet me ju edhe përfitoj. Vajza juaj nuk ka aplikuar me aftësitë e veta në spital. Po ju pasket biseduar me një zyrtar të filan partisë. Prandaj unë të thashë që në këtë rast i bie që je i pa integritet me na fol për integritet. Shumë faleminderit.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Selman, tash po të ftoj publikisht, nëse mund të ushtrosh ndikim, e ke një person që është vajza ime, nëse mund të ma punësosh në qeveri të Albin Kurit ka me qenë mirënjohës. Faleminderit.

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit kryesuese. Këtu, nëse ka dikush që mund të flasë për aktakuza më duket unë jam edhe Islami. Domethënë për çështjet e aktakuzës, për çështjet e që thanë edhe këta disa kuvendarët. Kur një person publik e ushtron një detyrë qoftë si shërbyes publik, civil apo qoftë edhe si udhëheqës i digasterit, edhe nëse është ngritur një çështje penale, një procedurë penale natyrisht që duhet të diskutohet në çdo nivel. Mua shumë mirë po më kujtohet kur është ngritur akta akuza ndaj ish-drejtorit Ertan Simitçi. Disa shoqëri civile u çuan në hava në Prizren edhe lypshin dorëheqjen time, ose largimin prej detyrës. Pas 24 dite, unë dola publikisht edhe e dhash dorëheqjen nga drejtoria në vitin 2019. E pastaj fillon me u ngrit akta akuza dhe në disa ish kolegëve të mi. Këtu e kam edhe Islamin, nëse nuk jam gabim, mbas meje drejtorit të katastrofit, drejtorit shërbimeve publike, disa drejtorive të tjera. Qoftë në kohën e PDK-së, qoftë në kohën e Vetëvendosjes, nuk ka lidhje. Krejt kanë qenë të angazhuar me një detyrë, me një përgjegjësi. Unë para disa muajve, nëse nuk jam gabim, plus edhe drejtorit mirëqënia sociale, nëse nuk jam gabim, nga radha e LDK-së. Para një muaj është publikuar akt vendim apo akt gjykimi i gjykatës apelit. Edhe këta kolegët e mi krejt dolën pafajshëm me një rastin e dhënies së pronës. Por shumë mirë po më kujtohet se edhe unë kam kaluar prej ato fazave kur as gjykata, as prokurorja, as eksperti financiar nuk ka mundur. Më keq ke, kur as eksperti financiar nuk po, nuk po mundet me dëshmuar keqpërdorimin detyrës, vepra. E në anën tjetër disa persona të cilët kanë dhënë kontribut për këtë komun, për këtë kuvend, janë dënuar, kanë kaluar prej fazave të ndryshme, po asnjë shoqatë, asnjë subjekt politik, asnjë person, nuk ka dalë publikisht me kërku falje ndaj personave që kanë dalë të pafajshëm. Mediat janë, postimet nëpër facebook janë, po këta drejtorët, kur kanë dalë pafajshëm, kurkush nuk ka dalë me kërkuar falje që para tre-katër viteve ne për shkak se çështjeve politike kemi bërë postime gabime. Andaj natyrisht që edhe tash kur ka akuza ndaj shërbyesve civil, ndaj shërbyesve publik apo të personave të tjer, natyrisht që duhet me pas një farë respekt ligjit të cilën krejt ata njerëz, janë të pafajshëm derisa përfundon procedurat përfundimtare me aktgjykim të fuqishëm. Por, nëse prokurori, nëse ne i besojmë drejtësisë, edhe nëse prokuroria ka ngritur akt akuzë, nuk ka mundur me ngritur aktakuzë pa elemente dyshuese. Se janë disa akta akuzë që kanë qenë politike, por janë disa aktakuzë që vijnë, që kanë ndoshta prova, elemente që ka dyshim. Andaj integritet është ata persona të cilat janë udhëheqës, të marrin përgjegjësi edhe vetë të kërkojnë nga kryetari apo nga eprori vetë, që të ndërprerët puna, po mendoj unë. Se tani ne do të kemi dyshim ndaj atyre udhëheqësve derisa përfundon procedura. E dyta, zoti Ymer ju thota që ka nevojë edhe duhet të integruar. Edhe ne se në pikën e radhës ka me parashtru, por mbasi që jeni këtu edhe juve po ju parashtroj si pyetje apo si rekomandim. Është gati hera e pestë apo hera e gjashtë si Komiteti për Komuniteteve të cilën jemi duke kërkuar nga komuna që të publikohet statistikën e përfaqësimit të komuniteteve shumicëve dhe jo shumicë. Po kërkojmë nga komuna, nga zyra e kryetarit, tani cila është ajo digaster nuk e di. Që të publikohet dhënat e përfaqësimit të komuniteteve shumicë dhe jo shumicë, domethënë shërbyesve civil. Sa janë shqiptarë, sa janë boshnjakë, sa janë turq, sa janë serb apo të tjerë. Nuk kemi informata, dhëna të sakta, andaj po kërkoj nga juve që të merrni me këtë punë për arsye edhe neve po na nevojitet, se edhe ne nuk po i dimë sa është përqindja e punësimit të komuniteteve.

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Faleminderit për kontributin. Unë po e marr kontribut që po japim këtu. Publikimi i të dhënave nga përkatësia etnike unë për herë të parë po e dëgjoj. Nuk e di është a e lejon ligji apo se lejon? Pa e pyetur personin vetë. A duhesh me ta publikuar? A lejon? Atëherë Ertan mos e zgjat. Unë e mora porosinë kam me u konsultuar ligjërisht cila është e vërteta.

Në qoftë se ti ke drejtë ligjore ato publikohen. Vetëm normalisht na duhet me i pyetur a duhet me ta për shembull unë shqiptar nuk e shkruajnë ashtu edhe s'dua me publiku. Institucioni nuk do duhet ose me ma marr mua të drejtën që si deklarohej unë. Atëherë e paske përgjigjen Ertan? Domethënë përgjigjen e paska Ertani. Faleminderit. Faleminderit ti drejtor.

Islam Thaçi (LVV): E pata fjalën që çdo i punësuar në komunë, i është nënshtruar regjistrimi të popullsisë, aty është deklaruar do të thotë ti s'mundesh çdo pesë minuta me ndryshuar kombësinë qysh teket, a kupton?

Ymer Berisha (Zyrtar Komunal): Veç edhe nja 30 sekonda, meqë e bën pak këtë diskutimin, më vjen mirë që u ngritën këto shqetësime. Ndihej i nderuar me pyetje edhe me ato që që s'më pëlqyen. Shkojmë drejt sukseseve të reja dhe unë e pata kënaqësinë që isha bashkë me ju dhe inshalla kemi shëndetin.

Pika e Njëmbëdhjetë

Raportet e punës së komiteteve të themeluara nga kuvendi i komunës për vitin 2024, Komiteti për politikë dhe financa, Komiteti për komunitete.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Meqë jam kryesuese e komitetit. Atëherë të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar të pranishëm, para jush po e paraqes raportin vjetor të Komitetit për Politikë dhe Financa për periudhën janar-dhjetor 2024. Ky raport është një dokument i cili ofron një pasqyrë të qartë dhe të kompletuar për qytetarët duke i njohur me punën dhe përpjekjet e KPF-së në shërbim të komunitetit. Pra, siç e dini kuvendi i komunës me vendim themelon komitetet e përhershme të cilat janë obligative si dhe komitetet e tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjithësive të cilat i ju delegohen. Pra komitetet obligative janë Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete. Siç e dini KPF është Komiteti obligativ i cili paraprakisht shqyron dhe rekomandon pothuajse të gjitha pikat e rendit të ditës të cilat janë parapar që të shqytohen, diskutohen dhe miratohen në kuvendin e komunës. Më konkretisht KPF është përgjegjëse për pikat si në vijim: shqyrtimin e tërë gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare si dhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatime, tarifat dhe pagesa, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës. Pra siç e dini përbërja përbëhet prej nëntë anëtarëve në bazë përbërjes së 41 anëtarëve sa i ka gjithsej kuvendi. Aktivitetet e KPF-së po mbledhjet dhe rekomandimet e KPF-së. KPF ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje në vitin 2024. Dy të jashtëzakonshme dhe 12 janë të rregullta. Mbledhja e parë është mbajtur në 29.01.2024, ku gjithëse i kemi pasur 16 pika të rendit të ditës. Mbledhja e dytë në 8 shkurt 2024. Kjo mbledhje është ndërprerë për shkak të mungesës së kuorumit. Pastaj mbledhja tjetër në 4 mars 2024 ku gjithsej kemi pasur 29 pika. Mbledhja e katërt e KPF-së në 27 mars 2024 gjithsej kemi pasur 11 pika. Mbledhja e jashtëzakonshme e KPF-së në 22 prill 2024 ku rend dite ka qenë pika e vetme pra bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të rritura nga ato të planifikuara të vitit 2023 në vitin 2024. Mbledhja e pestë me 26 prill ku gjithsej kemi pasur shtatë pika. Mbledhja e gjashtë më 28 maj 2024 ku gjithsej kemi pasur tetë pika. Mbledhja e shtatë e

rregullt me 26 qershor 2024 gjithsej nëntë pika. Mbledhja e tetë me 16 korriku gjithsej kemi pasur 10 pika. Mbledhje të jashtëzakonshme kemi mbajtur në 10 shtator 2024 me pikën e vetme shqyrtimindhe miratimi i projekt-budxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vite 2026 dhe 2027. Mbledhja e nëntë me 24 shtator gjithsej 11 pika. Mbledhja e dhjetë ka qenë me 29 tetor 2024 gjithsej me 15 pika. Mbledhja e 11 me 12 nëntor me gjithsej 14 pika. Dhe mbledhja e 12 e KPF-së me 17 dhjetor 2024 me gjithsej 10 pika. Këto janë shumë pika që, meqë i kemi materialin mos me u ndal me i lexu krejt ato që janë shqyrtuar dhe janë miratuar që ju kanë rekomanduar mbledhjeve të kuvendit. Transparenca dhe monitorimi i KPFe-së. KPF-së gjatë kësaj periudhe ka qenë shumë transparente ndaj të gjithëve, të cilët kanë qenë të interesuar për t'i përcjellë takimet e KPF-së. Vlen të ceket se KPF sa i përket punimeve të cilat i ka zhvilluar si dhe të gjitha dokumentat të cilat janë zhvilluar nga mbledhjet e KPFe-së, janë publikuar në web-faqe të komunës si dhe në të gjitha rrjetet sociale po ashtu edhe në media lokale. Për të gjitha këto që u cekën më lart, kemi të bashkangjitur edhe linkun e web-faqes zyrtare të komunës, ku gjendet databaza e KPF-së. KPF është monitoruar vazhdimisht nga mediat lokale dhe nga shoqëria civile dhe si përfundim ky raport është përmbledhës i punimeve të KPF-së të periudhës janar-dhjetor 2024. Po ashtu, është dëshmi sepse është bazuar në ligje dhe akte nënligjore në fuqi, siç dhe dëshmi për transparencën karshi qytetarëve të komunës së Prizrenit, por edhe ndaj atyre që monitoruan nga afër punimet që janë zhvilluar. Pasi që raporti do diskutohet në KPF dhe në kuvend do të publikohet në web-faqen zyrtare të komunës së Prizrenit. Mirëpresim komentet, vërejtjet, sugjerimet e juaja në qoftë se keni diçka me shtu. Në qoftë se jo, ju falenderoj shumë për vëmendjen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Tani e ftoj kryesuesin e Komitetit për komunitete që të bëj raportin

Ertan Simitçi (Kryesues i Komitetit për Komunitete): Faleminderit kryesuese. Komiteti për komunitete ka dorëzuar raportin e punës në muajin dhjetor të vitit 2024. Në vitin 2024 kemi mbajtur gjithësi 11 takime. Dikun mund të them që pjesëmarrja në këto takime ka qenë mbi 80% të anëtarëve të komitetit. Në vitin 2024 kemi pasur dy kërkesa nga komuniteti Goran dhe komuniteti Rom që të ndryshohet vendimi i kuvendit për themelimin e komitetit për arsyeja se dy anëtarët nuk kanë marrë pjesë në takimet, mbi gjashtë takime edhe jemi obliguar që të bëjmë ndryshimin e komitetit. Tani jemi 15 anëtarë. Nuk po du me cek krejt takimet, po që janë pak më rëndësishme. Në muajin shkurt të vitit 2024 është bërë një takim bashkë me Komitetin për komunitet të komunës së Gjakovës, kryesuesi Ergit Çili ka qenë prezent edhe kemi biseduar për këmbimin e përvojës e punës. Prandaj zyra për komunitet dhe kthim ka bërë prezantimin e raportit të vitit 2023. Në mars të vitit 2024 kemi bërë dy vizita në Shkolla, Ymer Prizreni dhe Luciano Motroni. Në prill të vitit 2024 kemi mbajtur një takim me komisionin për regjistrimin e popullsisë. Në maj të vitit 2024 është shqyrtuar rregullore për ndryshime dhe plotësimin e rregullores për gjuhët në komunën e Prizrenit. Në muajin qershor kemi bërë vizitë në QKMF dhe AMF në komunën e Prizrenit. Në muajin korrik 2024 është mbajtur takim me drejtorin Rasim Dimiri, drejtorisë për punë dhe mirëqënien sociale. Pastaj në vitin muajin gusht është diskutuar korniza afatmesme buxhetore të cilën zëvendëskryetari edhe një përfaqësues nga drejtoria për buxhet dhe financave ka qenë prezent. Pastaj në muajin tetor është bërë prezantimi i raportit të punës të zyrës për komuniteteve dhe kthim. Në muajin nëntor është bërë vizita në shkollat fillore dhe mesme në Mati Logoreci dhe Mustafa Bakiu. Dhe në muajin dhjetor kemi mbajtur takimin e punës vetëm si

komitet. Të gjitha takimet janë mbajtur këtu në sallën e Kuvendit të cilët kanë qenë edhe hapur për media, për shoqëritë civile dhe për të gjithë. Në sfida dhe çështjet e ngritura domethënë ka mbetur në këtë vit që të diskutojmë çështjen e përdorimit të gjuhëve zgjurtare ku kemi ende disa kërkesa apo ankesa në këtë drejtim, është punësimi domethënë i komuniteteve jo shumicë në vendet publike në komunale në ndërmarrjet komunale po ashtu edhe mospërkthimi i dokumenteve zyrtare pjesërisht do të diskutohet në vitin 2025. Po ashtu kryesuese në takimin e fundit kemi marrë një rekomandim me vota unanim nga komiteti, të cilin edhe që thashë edhe më herët do të kërkojmë nga zyra e kryetarit edhe nga zyra e kryesuesit të kuvendit, që brenda afatit 60 ditëve të sigurohet dhe publikohet të dhënat zyrtare sipas përfaqësimit të komuniteteve shumicë dhe jo shumicë në nivel lokal. Pasi që ligji për zyrtaret publik në neni 10 na jep këtë drejtë dhe këtë qasje. Andaj do të kërkojmë këtë. Pasi që ky pasqyrë apo ky publikim edhe për nevojat e komunës po edhe do të na mundësojnë neve të krijojnë dhe të zhvillojmë politika të reja me qëllim që të respektohen ligjet dhe respektohet barazimi apo përfaqësimi i barabartë të komuniteteve. Çështja e nënkryetarit do të jetë qysh është deri më tani nuk ka ndonjë lëvizje aty. Andaj që kjo është një raportim shkurt. Nëse ka ndonjë pyetje jem i gatshëm.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po Petrit? Petriti paska pyetje.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. I nderuar kryetar i komitetit, e vërejta që keni pasur shumë takime, shumë angazhime, mirëpo a keni mbajtur ndonjëherë takim për zgjedhjen e nënkryetarit të të komuniteteve? Ku ka mbetur procedura apo ku është problemi? Pse për herë të parë komuna e Prizrenit nuk po mundet me zgjedh një nënkryetar? Faleminderit.

Ertan Simitçi (Kryesues i Komitetit për Komunitete): Kështu, kemi biseduar, kemi biseduar në vitin 2023 në vitin 2024 nuk kemi biseduar. Domethënë zyrtarisht në komitet pasi që kjo çështje është ndodhur nga një udhëzim administrativ. Udhëzimin i administrativit, i cili ka caktuar kushtin për emërimin apo për propozimin e kandidatit për nënkryetar. E pastaj ky udhëzim administrativ është shfuqizuar nga ministri Elbert Krasniqi, andaj është e drejta të gjithë komunitetit jo shumicë, të propozojnë një emër nga radhat e komunitetit turk apo komunitetit boshnjak. Po tash krejt varet edhe te vullneti politik, vullneti i kryetarit, i cili ndoshta duhet në fakt të ulem edhe të bisedojmë të bëjmë një zgjedhje. Unë kam biseduar me kryetarin. Ka mbetur domethënë pezull. Kam biseduar pas para tre-katër muajve. Por kam mbetur qashtu siç e dini edhe ju. Domethënë nuk ka ndonjë lëvizje prej këtij.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Faleminderit Ertan. Ju përgëzoj për punën si komitet, e përcjellim dhe shoh që jeni shumë aktiv në këtë aspekt. Veç dashta me të pyet se tha që kemi vizituar edhe disa shkolla. A keni vizituar shkollën Motrat Çiriazit edhe me pa në çfarë gjendje komunitetet atje e marrin mësimin në klasë.

Ertan Simitçi (Kryesues i Komitetit për Komunitete): Domethënë në vitin 2024 kemi vizituar vizituar shkollën Abdyl Farshari, Hysen Rexhepi, Mustafa Bakiu, Mati Logoreci prej shkollave fillore të mesme dhe Emin Duraku. Vetë kam qenë vizitor. Ndërsa te Motrat Çiriazit jo po besoj që në muajin prill e kemi në axhendë këtë muaj, domethënë pas Ramazanit. Disa thojshin domethënë çka ka përfituar nga këto vizitat. Besoni që kur kemi qenë vizitë te shkolla Mustafa Bakiu vetë kemi qenë dëshmitar në gjendjen e izolimit të shkollës edhe pas bisedimit me drejtoreshën, ata

kanë pasur projekt të gatshëm edhe qaj projekti tani me vullnetin e juaj dhe votat e tona, domethënë ka kaluar edhe buxheti edhe është futur në buxhetin 2025 për izolimin e ndërtesës së shkollës. Besoj që edhe në muajin prill do të shkojmë edhe në vizitë në te Motra Çiriazhi dhe besoj që edhe aty ka nëse ka nevojë për investim do të shqyrtojmë. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Atëherë ju faleminderit anëtarë të kuvendit edhe juve kryesuesi i komitetit. Faleminderit për këtë raport. Kalojmë te pika e 12, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lejimin e ndarjes së mjeteve në përqindje për për projektet me bashkëfinancim me fermerët në komunën e Prizrenit. Drejtor, fjala për juve.

Pika e Dymbldhjetë

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lejimin e ndarjes së mjeteve në përqindje për projektet me bashkëfinancim me fermerët në komunën e Prizrenit

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqësisë): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për kolegët e mi drejtor, përshëndetje kuvendar, media, shoqëri civile dhe ju qytetarë të nderuar. Para jush keni propozim vendimin për lejimin e ndarjes së mjeteve në përqindje të pjesëmarrjes së fermerëve në projekte të cilat janë me bashkëfinancim në komunën e Prizrenit, nga drejtoria e bujqësisë. Ne nga drejtoria e bujqësisë kemi planifikuar pesë projekte me bashkëfinancim me fermer, për këtë vit, për vitin 2025. Këto projekte do të jenë ngritja e pemishteve me pemë të imta, në vlerë prej 300.000 eurove, hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore në vlerë prej 180.000 euro, furnizimi me mekanizëm bujqësor në vlerë prej 380.000 eurove, ngritja e serave në vlerë prej 110.000 euro dhe ngritja e pemishteve me pemë arror në vlerë prej 100.000 eurove. Drejtoria e Bujqësisë ka bërë propozim para juve që pjesa e participimit të fermerëve për këtë vit të jetë 20%. Unë ju kisha lut të gjithëve që të jeni masi që ke sot edhe integritetin në pyetje për me ruajtë integritetin edhe të fermerëve dhe të gjithë të tjerëve është mirë, është mirë që kjo përqindje mos të ulet të mbahet, po, prapë është propozimi juaj, po kisha ju kisha lutur që të jetë propozim i arsyeshëm edhe nëse dikush prej juve propozon. Ju faleminderit, diçka tjetër nuk kam për me shtu, pres prej juve nëse dikush ka ndonjë koment.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit drejtor, zotëri Qemal Krasniqi, pastaj Faruku.

Qemal Krasniqi (LDK): Faleminderit. Unë drejtor të përgëzoj për punën që po e bën. Shpesh herë, aty ku desh me të kritikuar, të kemi kritikuar. Po edhe ato të mirat që, ato punët e mirat që po i bësh duhet me t'i thënë. Kur është fjala te kjo përqindja e participimit. Vitin e kaluar ne si grup i kuvendarëve të LDK-së, kemi insistuar tek ai 15% shi. Gjithmonë duke marrë parasysh që ka nevojë fermerit të ndihmohet. Mirëpo kësaj radhe kemi ndryshuar. Pse kemi ndryshuar? Ne jemi për me i ndihmuar fermerit, mirëpo në shumicën e rasteve disa nga fermerët që s'mundesh me i thënë edhe bash fermer, po ju ka dhënë mundësia dhe kanë aplikuar, kanë marrë mjetin, mekanizmin bujqësor, por e kanë keqpërdorur. Në fakt ka pasur raste që atina që ju ka desh, për

një arsye apo tjetër nuk ka mundur me marrë. Deshta të them se ky 20% shi është për grupin tonë të kuvendarëve të LDK-së është i arsyeshëm. Kaq kisha, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zoti Krasniqi. Faruk Tahiri, pastaj Bajram Kastrati.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese, i nderuar drejtor. Ne gati çdo vit e votojmë subvencionet me bashkëfinancim apo me participim të fermerëve. Edhe për mendimin tim nuk është shumë edhe e rëndësishme se sa përqind fermerët marrin pjesë në këtë aspekt, sa është e rëndësishme këto mjete si po realizohen edhe si po shpenzohen. Ne kemi një raport që mbështetjen që ka bërë drejtoria e bujqësisë, fermerëve në vitin e kaluar me këtë formim të subvencionit me 20% apo 15% se di sa ka qenë. Cili ka qenë efekti të fermerëve? Sa kanë qenë të suksesshëm dhe cilat kanë qenë rezultatet? A ka pasur kërkesa prej fermerëve që ndoshta ky 20% ka qenë pengesë për me arritur të një rezultat që ne kishim mundur me arritur më shumë nëse s'e kishim pasur këtë 20%. Apo gjithçka ka shkuar okay dhe s'kanë nevojë për mbështetje të tjera.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqsisë): Po Faruk, faleminderit. Ky 15% shi apo 20% shi nuk është fare problem për fermer. Ju e dini që grandet që merren në kuadër të Ministrisë minimum jo 35%. Domethënë ju e keni mundësuar kuvendi që ky pjesa e participimit të jetë 15%. Unë nuk po e shoh ndonjë problem këtë çështje që ka qenë problem. Çdo gjë vitin e kaluar ka shkuar në rregull, ka shkuar sipas rregullave që ne i kemi pasur. Kështu që mirë ka shkuar.

Faruk Tahiri (LVV): Drejtor nuk e kisha qëllimin të 15-sh apo të 20% që unë thashë nuk është problem, ne mund me bë edhe 20 edhe 30 edhe 40%, nuk është telash ajo punë. Sa është e rëndësishme në momentin që fermeri e merr një subvencionim. Cili është rezultati i atij? A është a është okay? Prandaj ne si kuvendarë do të ishte mirë ta kishim një raport që me këtë subvencionimin që e kemi bë vitin e kaluar me 15%, fermerët që kanë përfituar, kanë bërë këto këto rezultate dhe atyre që kanë përfituar vitin e kaluar me 15% dhe nuk kanë pasur rezultate, do të ishte mirë që tash edhe me 20% edhe me 40% mos me i dhënë atyre.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqsisë): Faruk, gjërat kanë qenë shumë transparente, janë në web faqen të komunës të përfituesve, të fermerëve, të gjithë. Domethënë nuk ka ndonjë raport tjetër që ne i kërkojmë fermerëve sa ka punuar me atë pajisje, përpos që ne në drejtori, e kam obligim ligjor që ta formojmë një komision edhe dalim t'i verifikojmë pajisjet bujqësore se a janë aty apo nuk janë. Domethënë këtë e bëjmë çdo vit. Tani nuk e kemi bërë, domethënë deri me tani, po komisioni është formuar edhe shumë shpejt ka me dalë në terren për me i verifikuar pajisjet e vitit 2024. Ndërsa viti 2023, 2021, 2022 janë vërtetuar, domethënë kanë qenë në rregull vitin e kaluar. Këtë vit komisioni është formuar edhe kemi obligim ligjor me dalë me i verifikuar.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, Bajram Kastrati fjalën, pastaj Petrit Hoxhaj.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit, kryesuese. Drejtor, edhe në këtë radhe jemi të dakortit me përqindjen, përveç të hapja e puseve po mendoj, është kërkesë e një fermerit ta zëjmë shembull që e ka problem me përmbushje, po më duket është kosto pak më e madhe të hapja e pusave si të këto projekte të tjera. A e keni bë një analizë që së paku kjo me shkuar me një përqindje pak më

të vogël se mund të kemi një fermer që ka nevojë shumë për një pusë dhe ndoshta është pak ngarkesë me 20%. Faleminderit.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqsisë): Shiko, ne kemi pasur rast edhe vitin e kaluar, fermerët që nuk kanë pasur mundësi ndoshta me i paguar përqindjet, po ka has mirëkuptim edhe me kompaninë e cila ju hap edhe i e ka kryer ajo. Domethënë te ne është paguar 15% shi po ju ka paguar kompania që nuk është problem. Për një fermer nuk është problem, besoj që e kanë parasysh edhe kompania, operatori ekonomik, se nuk çon peshë, nuk ka kosto është shumë e madhe.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit Petrit Hoxhaj fjalën pastaj Levent Bush.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese, i nderuar drejtor kështu. Sa i përket participimit të disa kategori nëse është e mundur për shembull ngritja e pemishës me pemë të imta dhe ngritja e pemishëve me pemë arvore, është mirë të ulët përqindja në këtë pjesë sepse ka shumë fermerë që pas një viti po dështojnë do të thotë dhe është mirë që në këtë, të ulë sëpaku në 15%, ndërsa tek mekanizmat bujqësore është mirë në këtë pjesë ose me lënë 20 ose me rritë në 25, sepse kur po e shohim që është kur po e shohin që është participimi i vogël, po rritet edhe numri i aplikacionit më shumë se se po thotë me 100 euro unë po e marr një një motokultivator. Kështu që ku këtu është participimi pak më i madh, ai i mbat sendet edhe a me apliku apo mos me apliku. Ndërsa tek ngritja e serave, duhet me qen 20 sepse me sa di unë më herët duke qenë 15 dhe shumë fermerë kanë marrë serrat sepse ka qenë çmimi i vogël edhe i kanë marrë do të thotë edhe ata që s'e kanë merituar dhe sot e kanë shti, do të thotë bari kanë shti, kanë bërë diçka por nuk e kanë mbjellë serën brenda. Është mirë në disa, thashë në ngritjen e pemishteve është mirë me ul sepse ka gjasa që po dështon mbas një vjete, ndërsa në këto të tjerat nuk dështon. Faleminderit.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqsisë): Petrit, ne i kemi analizuar edhe si përfundim kemi pru, kemi pruar që të tërë gjitha projektet të jenë 20%. Sa i përket të pemëve të imta të pemëve të imta është kosto pak më e madhe, po mjetet, të cilat investohen brenda vitit i kthejnë fermerëve, bile me fitim. Brenda vitit. Të jesh i bindur se unë e kam marrë analiza, po, sidomos te dredhëzat, dredhëzat janë shumë shumë profitabile. Po, kështu që nuk kisha, nuk kisha thënë. Shiko, ne ta bëjmë tash sipas dëshirës të gjithëve, po mirë është me unifikuar këto edhe me përfunduar se.

Levent Bus (Kdtp): 1:15:34 – 1:16:25

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zotëri Bush. Islam Thaçi.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese. Drejtor, po mendoj se me kolegun Faruk nuk u kuptuat. Ajo që kërkoi Faruku e që besoj më thjesht me thënë, a kemi ndonjë databazë brenda komunës ku subvencionimi mos bëhet në fushat gjithnjë të njëjta. Prodhimtaritë, sa ka ndikuar subvencionimi pe zë kushtimish i një makinerisë që për tri vite radhazi është subvencionuar, a kemi arritur të prodhimt ku di unë, qumështit, makinerisë tjetër të drithrave të ndryshme apo kemi stagnim, pavarësisht subvencionit tonë. E dyta, edhe unë jam pro këtij subvencionimi, në këtë vlerë që të jetë 20% për shkak se mendoj se është subvencionimi i duhur. Në të vërtetë administratës komunale i mungon arkiva, se komuna jo vetëm në drejtorinë e juaj subvencion, po të gjitha drejtoritë bëjnë subvencionim. Mirëpo një arkiv e mirëfilltë nuk ekziston edhe ish kanë mirë me

mendu në këtë drejtim që të arkivohen gjërat, e jo vazhdimisht kemi makinerit e njëjtë për vite radhazi që i bën në subvencionim. Faleminderit.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqsisë): Zotri Thaçi, unë e kuptova shumë mirë, po kjo çështje është edhe këto planifikime që ne i kemi bërë. Planifikimet janë bërë në bazë të kërkesave të fermerëve, edhe në të gjitha këto fushat kanë pasur sukses. Në mbjelljet e dredhëzave kanë pasur sukses, në pemtë arror, ka pasur sukses edhe ka kërkesa. Mekanizma nujqësor nuk janë të njëjtat. Kemi ndryshuar këtë vit. Domethënë, ka pasur sukses, ka pasur sukses edhe të gjitha pesë projekte janë në bazë të kërkesave të fermerëve. E di që ka nevojë hala më shumë, po këto janë mundësitë tona. Diku 1.100.000 janë këtu vetëm, përpos subvencioneve të tjera që i ndajmë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zonja Sevil Kazas.

Seliv Kazaz (e pavarur): 1:19:05 – 1:20:20

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. Shkëlzen Kastrati fjalën e ka.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Faleminderit kryesuese. Në bazë të asaj që kam dëgjuar po mendoj që shumica jemi që të jetë 20%. Pjesë e falenderimeve e kryten Leventi edhe ata të tjerët kështu që s'po ndalna po edhe ne metëm veç ne të PDK s'pa folur kështu që edhe ne jemi dakord 20% le të jetë mos ta bëjmë shumë koment nuk ka vlerë e madhe nëse ulem në 15. Për 20 mendoj që shumica dhe atë mendimet e tyre dhe jemi dakord kështu që shkojmë në votim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit. Ju lutem, ju lutem, shqetësi, ju lutem. Zoti Shukri Quni fjalën e ka.

Shukri Quni (Nisma): Drejtor, unë edhe kështu të kam kritikuar. Po ti më ke thënë të gjithë që shko me emra. Ata emrat janë aty, gjithë. Ata që po i përfitojnë këto subvencionet. Unë jam për po jam për, po jam për ata që e meritojnë edhe që e punojnë tokën. Ky 20% për një fermer nuk është shumë. Bile unë i kisha bërë pak më tepër, do që s'kanë fare tokë edhe marrin. Bile ata le ta paguajnë mirë, gjysma le ta paguajnë që mos ta marrin me një 20%. Unë e shoh që ndahen shumë moto kultivator apo goldona ne i themi, për besë në fushë shumë pak shoh që janë ka punojnë, se unë tash ju shumica jeni të qytetit, unë jam i fshatit, i shoh atje përshëmbëll sa punojnë. Edhe qeto pusët i kisha heq krejt. Po po. Po po i kisha heq se unë të marr edhe të çoj edhe i sheh që i ka puse edhe nëpër oborra. Kishit bërë mirë mu bile si asambleist i vjetër me hap një pusë në oborr timin. Sinqerisht e kam, se s'kishit bërë nëm pale sa, q'atë 20%shin edhe unë e kisha paguar. Po po. Po. Edhe nuk është mirë që ai komision, kemi biseduar ne dhe kështu, ke thënë dil me emrin, e thashë s'po problem, dalim edhe me emra, emrat janë. Po nuk është mirë tash, unë po konkuroj, tjetër anë e shti edhe gruan me konkuru, edhe ajo me e marrë të njëjtën, s'është në rregull kjo. Merrni jepni atë që e punojnë tokën. Nëse ata mendojnë që i ke në komision ti, që ne s'marrim vesh kurrgjë, ata kanë gabim. Ju kanë dhënë edhe mëshjtjerë përshëmbuell njerzëve, që s'ka shtallë hiç. Edhe puse e kanë hapur. Nuk e ka hapur në vendin ku është ku duhet me u. Po shiko ju disa, nganjëherë po i merrni edhe si në humor, por unë jam ka flas, se unë kam biseduar me drejtoreshën edhe kështu, se me të vërtetë njerëzit që e kanë merituar me e marrë subvencionin, nuk i kanë marrë. Pse? Nuk e ka kërkuar aty me i ndihmuar, se ka aty me ja dhënë atë pikët çka ja japin, edhe ai janë disa që punojnë, po nuk i nënshtrohet askujt ai. Ai haptas më thotë, vetë e blej thotë, me vllaça, me ato

çka japin ato farë freza. Edhe nuk shkoj thotë, kujt me i rënë nër. E që ata që vijnë e sillen nëpër komunë edhe i marrin, mos se jeni tu hy në gjynah, se nuk punojnë me to ata. Po ti edhe në atje në zyrë më ke thënë, po unë po të them që shumë e vërtetë është. Derisa të më kris filmi e i them krejt me emra një ditë që ky e që ky është, që ky është filani i kësaj shtëpie, po ka konkuruar, e ka marrë frezën, e ka marrë pusin, e ka marrë mështjerrën, goldanin, një familje është. Që s'do atëherë po e verifikojmë edhe po e kqyrim atë. E për mua i kisha bërë 50%. Se ai fermeri i mirë që punon, ai nxjerr dhe qato 50%. Ai që s'punon veç e merr edhe besa mos i shitshin.

Bexhat Bytyqi (Drejtor i Bujqsisë): Zotëri Çuni, unë të falenderoj për bashkëpunim, gjithmonë ke qenë korrekt, po këtu nuk pajtohem me ty, për arsye se komisioni, me shumë bindje të lartë po them që komisioni i verifikon të gjitha dokumentacionet. Nëse dyshon te ndajkush eja edhe transparente, mundesh me kërkuar edhe qasje në dokumenta, e sheh vetë që e ka plotësuar kriterin çdo fermer. Ato me bindje plotë po të them, edhe mundesh me ardh me kërkuar me emrin edhe qasje në dokumenta mundesh me kërkuar pa kurrfarë problemi. Të jesh i bindur që me dokumenta te ne është në rregull. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit drejtor. Dikush tjetër a ka rreth kësaj pike? Në qoftë se jo unë me sa e pashë të gjithë anëtarët u pajtuan me 20%, përveç Petritit që i dha dy propozime prej 20-shit me u bë në 15-shit, po Petritit me sa e vërjta në fund u pajtave? Po, a me e qit? Domethënë nuk u pajtave për me qenë 20%. A kemi nevojë me qit propozimin e juaj në votim? Atëherë kështu, siç ka ardhur propozimi po e hedhi në votim. Prezent jemi, 27 anëtarë. Kush është për që të miratohet? Për 20% po. 25 jemi për, kundër a kemi? 1 kundër. Abstenim. 0 abstenim. Atëherë miratohet edhe pika e 12. Ju faleminderit shumë.

Pika e Trembëdhjetë

Diskutim për mundësinë e subvencionimit të dëmit të shkaktuar nga fishek zjarret në fund vit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Dafina meqë ke qenë propozuese në KPF, a do ta merrni fjalën? Po urdhëro.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese. Kjo kërkesë ka ardhë prej banorëve të lagjes së Bazhdarhanës. Për shkak që rasti ka ndodhur me 31 dhjetor. Edhe ashtu si është rekomanduar nga kryetari i komunës, banorët e kanë bërë kërkesën ndaj komunës. Ju është thënë që brenda shtatë ditëve do të kenë përgjegje. Jemi në fund të muajit shkurt edhe banorët ende nuk kanë përgjegje, ndërkohë dëmet janë ashtu qysh disa i kanë meremetuar me vetëfinancim. Janë në pritje të vlerësimit të dëmeve dhe janë në pritje të përgjegjës nga komuna e Prizrenit. Meqë na janë orientuar edhe tek ne asambleistët, e pamë të arsyeshme me pasur një përgjegje së paku ndaj vlerësimit që është bërë të dëmeve, pastaj ndaj shumës së mundur që mundet me u bë nga ekzekutivi dhe hapi i fundit është një vendim që mund ta marrim ne si legjislativ normal. Me rekomandime edhe me vlerësimet që janë bërë, në mënyrë që ata ta vazhdojnë t'i kthehen bizneseve të tyre, t'i kthehen objekteve ku banojnë, sepse aty ka edhe banesa që janë dëmtuar, edhe së fundi qytetarët kanë nevojë për ndihmë edhe ne jemi për qytetarët, andaj mendoj që jemi vonuar shumë

edhe në kthim të përgjegjes edhe në reagim të shpejtë. Unë do të isha tepër mirënjohëse me pas edhe kryetarin e komunës këtu, për shkak që përveç që ka mungesë edhe të përgjegjës unë me keqardhje e kam parë atë natë që pavarësisht që ka ndodhur një fatkeqësi në një lagje të komunës, është dalë me u festuar atë natë që kjo nuk ka qenë hiç në rregull. Po meqë festat edhe meqë shumë seanca nuk kemi pas në këtë hapësirë, unë mendoj që këta qytetarë, kjo lagje, e meriton një vendim konkret sa më të shpejtë, ku paksa i ndihmon atyre, mos ta harrojmë që është edhe një humbje jete aty, domethënë edhe ajo familje ka pasur edhe shpenzime edhe janë dërmuar një humbje një familjarit nuk është e lehtë edhe për ata. Mendoj që ja vlen edhe duhet të diskutohet edhe duhet të bëhet një mbulesë e shpenzimeve apo dëmeve që janë bërë. Në mënyrë që këta qytetarë të cilët kanë mbetur gjallë po janë dëmtuar shumë financiarisht, duhet ta gjejmë një motiv për me vazhdu. Faleminderit.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Faleminderit shumë. Përsëritet edhe herë për të gjithë. Më së pari, shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhur si në njerëz ashtu në dëme materiale. Unë personalisht jam për me i ndihmu dhe me i subvencionuar, do të thotë brenda mundësive ligjore. Besoj që është bërë ndonjë vlerësim i dëmit, jo vetëm për këtë, por edhe për të gjithë personat gjatë vitit 2024 nëse ka pasur ndonjë fatkeqësi natyrore. Do të thotë janë për subvencionim, mirëpo tashmë mos me bërë pak politike, do të thotë pasi që jemi për me ndihmuar dikujt, mos ta bëna shumë personale ose politike, disa kanë festuar, disa nuk kanë festuar, po mendoj që nuk duhet me hy në këtë temë, të paktën për këtu. Kërkoj falje nëse ndiheni keq në këtë, në këtë drejtim. Jemi, unë personalisht jam për subvencionim, po jo vetëm për këta, edhe të tjerët nëse ka pasur të raportuara ndonjë dëm, ndonjë shtëpi apo ku të di unë. E sa mundet atëherë besoj që ndoshta drejtoritë përkatëse munden me ofruar një sqarim derisa kanë mbulueshmëri apo a ka mjete në dispozicion e këto të tjera. Ju faleminderit.

Qemal Krasniqi (LDK): Gjithashtu edhe unë shpreh keqardhje për rastin pra për viktimën, por njëkohësisht edhe për ato familje të dëmtuara. S'jemi kundër që ato të mos ndihmohen. Por në fakt ne në komunën e Prizrenit kemi pasur raste të mëhershme. Këto familje janë dëmtuar nga fishekzjarret. Disa familje janë dëmtuar nga ujërat, disa familje janë dëmtuar nga zjarri. Tash këto familje t'i ndihmojmë, kurse të tjerat i kemi anashkaluar, s'di a është në rregull. Për familjen e të ndjerit krejt okay. Krejt në rregull. Mirëpo tash ju kanë dëmtuar gjamat. Ne para disa muajsh kemi pasur vërshime, kemi pasur breshër, janë dëmtuar, janë dëmtuar shtëpitë, janë dëmtuar pronat dhe askënd nuk e kemi subvencionuar. Unë nuk jam kundër, mirëpo kur të merret vendim për diçka atëherë se të gjithë janë qytetarët e komunës së Prizrenit. Kaq kisha, faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zoti Krasniqi, atëherë drejtoresha po e kërkon fjalën që disa herë besoj që ka me na dhënë ndonjë. Po dojmë me ditë ku jemi se s'kemi edhe ne informata. Për atë unë edhe me ja u lehtësu edhe juve për mu s'është problem. Për atë thashë mos po na ndihmon me informata diçka.

Ramize Shala-Sinanaj (Drejtoresh e Emergjencave): Faleminderit kryesuese. Fillimisht unë do me treguar kompetenca që i ka Komuna e Prizrenit, drejtorja për emergjencë dhe siguri. Dashta me ngushëlluar familjen edhe pse është shumë vonë edhe seriozisht nëse kishim mundur me mbështetur diçka është e vetmja familja, sepse ndoshta dëmet mundin me na u kompenzuar, mirëpo jeta e njerëzve është e pakthyshe. Drejtorja për emergjencë dhe siguri në bazë të

kompetencave që ka, edhe këtë rast duhet ta trajtojë njëjtë sikur rastet e tjera që janë të natyrës për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera. E tha Dafina që kryetari ka thënë që brenda shtatë dite do të marrin përgjigje. Qytetarët e kanë keqkuptuar këtë informacion. Qytetarët brenda shtatë ditë e kanë të drejtë me bë kërkesë në drejtorinë për emergjencë dhe siguri në mënyrë që në bazë të kërkesave të qytetarëve ne dalim dhe e bëjmë vlerësimin e dëmit. Pas shtatë ditë komisioni del dhe e bën vlerësimin e dëmit, gjë që është kryer si procedurë krejt çka krejt kërkesave ju kanë përgjigjur komisioni, edhe tash ka mbetur vetëm kosto. Si raport ka përfunduar, mirëpo vetëm si kosto, si çmim total ende nuk kanë arritur me vu se sa është çmim total për me dërgu në AMI. Disa herë po ju bëj thirrje edhe qytetarëve të komunës së Prizrenit sepse kur po kalon afatet ligjore mandej po kemi probleme. Kur ndodhin fatkeqësi natyrore brenda 8 dite duhet me bë kërkesë në emergjencë në drejtori për emergjenca dhe siguri. Pas 8 dite komisioni del edhe e bën vlerësimin e dëmit. Pasi që ta përfundojnë të gjithë raportin. I njëjti raport shkon në agjencionin për menaxhimin emergjent, ku edhe ata e kanë një komision të veçantë të cilin e shqyrtojnë edhe njëherë raportin e komunës. Kur ata e miratojnë këtë raport, atëherë dërgohet në qeveri për me i subvencionuqytetarët. Gjatë takimeve që kemi pasur të gjithë drejtorët për emergjenca dhe sigurinë në AMI. Kemi kërkuar që të paktën secila komunë me pas një fond emergjent për raste vërtetë emergjente siç na ndodhi rasti në vit për 31 janar. Mirëpo nuk na e kanë lejuar. Edhe unë nuk e di se si ka mundësi me këtë propozim tash komuna e Prizrenit me realizuar këtë. Kur ne kemi kërkuar që secila komunë të paktën 100.000 euro me pas. Na kishin mjaftuar ndoshta me çu në trajtim çat djalë. Por nuk na e kanë lejuar. E nëse ju si kuvendar, keni mundësi me bë një gjë të tillë, për besë unë nuk ja mohoj atë të drejtë. Mirëpo krejt këto çka unë e thashë, besomni, se që kjo që po e them unë që kjo është e vërtetë edhe është ligjore. Unë nuk jam kundër subvencionimit, po qytetarët e kanë keqkuptuar atë që ka thënë kryetari. Kryetari ka thënë brenda shtatë dite me bë kërkesë, jo me marrë përgjigje se është e pamundur me marrë përgjigje. Ju faleminderit, besoj që isha e qartë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, po e ju jap fjalën me radhë qysh e kemi pasur. Sevili ishte në radhë, pastaj Bajram Kastrati.

Sevil Kazaz (e pavarur): 1:36:00 – 1:37:55

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese. Sigurisht se shprehim keqardhjen ne për rastin edhe kemi shprehur edhe më herët. Meqë rastet e tilla trajtohen veç siç e ceki edhe zotëri Krasniqi që që tha duhet me-i trajtuar edhe të tjerët. Kërkesa ka qenë edhe prej kolegës që rasti të trajtohet. Unë e pata pyetjen për drejtoreshën që deri ku ka mbërritur dashta me u informu, mu informuar më saktë deri ku, po drejtoresha tha që nëse keni mundësi ju diçka kuvendar të bëni, urdhëroni, se di për çka e patë fjalën, çka kemi mundësi tash na në këtë rast me bërë. Faleminderit.

Ramize Shala-Sinanaj (Drejtoresh e Emergjencave): Jo, ne në takim atë ditë për politikë, financat që mora unë pjesë edhe ke ide e Dafinës që me propozu që me mbështet si komunë, si kuvend. Nuk e di sa keni të drejtë nëse keni diçka të drejtë ligjore unë e thashë, në këtë aspekt. Jo që unë tregova mundësitë të cilat ne i kemi, qysh neve na lejon në ligji si veç ta përfundoj këtë ligj. Domethënë, në këtë aspekt, unë e tregova mënyrën ligjore çka na takon edhe kompetenca të cilat ne i kemi si drejtoir. Domethënë, në këtë rast ne si drejtor jemi kompetent me trajtu si si rast të tjera. Mirëpo nëse keni ndonjë mundësi ju si kuvend, nëse keni baza ligjore, urdhëroni, nuk thashë për ndonjë qëllim tjetër.

Bajram Kastrati (AAK): Ju po thoni që e keni dërguar në AMI. AME, më fal. Edhe raste të tjera që i keni dërguar a kanë ndodhur që me dështu mos me bë pagesat ata? Edhe a mund të presim tash pakufijshëm edhe këta qytetarë apo qysh, shkon kjo procedurë.

Ramize Shala-Sinanaj (Drejtoresh e Emergjencave): Pyetje shumë me vend, fatkeqësisht ose fatmirësisht gjatë vitit 2023 ne e kemi marrë miratimin që me u subvencionu krejt raste të cilat janë dëmtuar. Kemi pas fatkeqësi natyrore. Është pranuar si raport, mirëpo deri tash sa po bisedojmë ne nuk janë subvencionuar. Si raport e kemi marrë që është pranuar, mirëpo nuk është subvencionuar nga ana e qeverisë.

Bajram Kastrati (AAK): Kryesuese, më duhet me ndërhy. Atëherë nëse veç nuk po pritkëm ne edhe për këtë rast, sikur raste të tjera, po dashka me marrë masa ne si kuvendar, përderisa edhe kemi propozuar edhe në KPF. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, atëherë Florent Ukaj fjalën e ka pastaj Selman Sokolaj.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit kryesuese, pak a shumë u thanë edhe ata. Unë desha me thënë çka e tha Bajrami, por drejtoresha pak na bëri njoftim për qytetarët që duhet brenda shtatë dite. Drejtoreshë, të jeshë e bindur që qytetarëve ju ka humbur besimi me lajmëruar, me raportuar raste të emergjencave që janë tu ndodhur. Për shkak që rezultatin po e din. Që sa vite jemi tu folur ne kështu, domethënë çdo seancë, shumicën e seancave kemi folur për për vërshimet bujqësi, për dëmet nëpër kësi fatkeqësi, domethënë, nuk ka ndonjë shpresë domethënë që ne mundemi me i me i bë një rrugëdalje. Ne e dimë që qëtu kemi votuar për komunë të Skënderajit e për një komunë të Turqisë. Nuk di çka ka ndodhur kryesuese me ato mjete. A kanë mundur me u transferuar qato mjete në ato komuna? Në rast se ato mjete janë transferuar nëpër ato komuna për ndihmë financiare për fatkeqësi, atëherë ne si kuvend kemi të drejtë me bë një komision ose me me propozuar një mbështetje financiare. Përndryshe nëse nuk ka ndodhur ajo, atëherë ne veç mundemi me bë votim por vlera, rezultati janë zero. Faleminderit shumë.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. E para, besoj është e padrejtë me i kategorizuar njëjtë fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë që shkaktohen nga faktori njeri. Në këtë rast kemi të bëjmë me një fatkeqësi që është e shkaktuar nga faktori njeri. Ose mungesa e veprimit të faktorit njeri. Në këtë rast, nëse flasim proceduralisht, mundet me qenë zyrtari kryesor administrativ në institucion, që është kryetar i komunës, i cili me kompetencat e tij ka mundur me ndërmarrë veprime që mos me ardhur deri te një gjendje e tillë. Edhe nëse më kujtohet saktë, kuvendari, kolegu ynë, Ilir Gashi, në një anën prej seancave ka kërkuar prej ekzekutivit me ndërmarrë masa që mos me ardh deri te ky rast. Fatkeqësisht masa s'janë ndërmarrë edhe si pasojë e mungesës e atyre masave kemi ardhur te ky rast. Domethënë nuk kemi të bëjmë këtu me vërshime ose me raste të tjera të fatkeqësive. Kështu që ky rast kjo tragjedi që ka dëme edhe në aspektin njerëzor edhe materiale është shkakuar si pasojë e mungesës e veprimeve të institucioneve. Tash qytetarët kanë shumë mundësi. Njëra prej mundësive është me paditë komunën ose personin përgjegjës. Spo më intereson kush është emri, mirëpo personi i përgjegjës në aspektin procedural është zyrtari kryesor administrativ edhe përmes organeve gjyqësore me konstatuar fajësinë apo pafajësinë e tij deri te ndodhja e këtij rasti. Nëse konstatohet fajësia, normal që tani vjen edhe padija civile për

kompensim të dëmit. Tjetra është kompensimi në bazë të një raporti. Tash në pyetje po ndërlidhna drejtoreshë me pyetjen që ua bëra. 2014-ën thatë kemi raste të zjarreve, dëmeve materiale qytetare, por nuk kemi pagesa. A është Komuna e obliguar t'i paguajë ata qytetarë edhe në fund të fundit nuk ka buxhet, nuk na intereson neve. Nuk intereson askujt, nuk ka buxhet. Juve si drejtoreshë nuk duhet me ju interesuar a ka buxhet. Se nëse është puna te buxheti, shkojmë atëherë te prioritetet. Edhe prioritet më të madh si me i subvencionu qytetarë që kanë pësuar prej një fatkeqësie nuk ka. Po besoj që kjo është në përgjegjësinë të juve si drejtoreshë që me bërë presion bordi drejtorëve, kryetarit, që me kategorizu buxhetin, me prioritzu se nuk është arsyetim nuk ka buxhet. Siç ju thatë edhe në 2024 nuk kanë ndodhur pagesa, por sigurisht ka edhe raste gjatë këtij viti në këtë dy mujorin që po e lëmë tash, për shkak se këto fatkeqësi, fatkeqësisht janë të paevitueshme për shembull çështja e zjarreve. Kështu që kjo procedura e pagesës, nëse ju jeni mbrapa në 2024-ën, a obligoheni patjetër me shkuar në bazë të hierarkisë ose në bazë të datës qysh ka ndodhur ngjarja apo si mund të vijmë deri te pagesa e parë ose deri te kompensimi i parë në këtë rast? Faleminderit.

Ramize Shala-Sinanaj (Drejtoresh e Emergjencave): Po, dëgjo, gjatë vitit 2022-2023 janë janë kompensuar të gjithë qytetarët, veç për vitin 2024. Edhe vitin 2024 kemi pasur probleme financiare për shkak të arsimit apo çfarë ka qenë diçka një farë, domethënë që ajo ka ndodhur, që ajo pagesë ka ndodhur edhe për atë punë na është është komplikuar pak puna. Kur kam biseduar në mbledhjen e fundit kam biseduar me kryetarin që duhet me u subvencionu dhe e kemi marrë si detyrë që të vitit 2024 me filluar dhe me i bërë pagesat për qytetarët. Qytetarëve ju kemi njoftuar edhe gjatë vitit 2024, që bëni kërkesën po për këtë vit nuk kemi mjete financiare për me i kompensuar. A përndryshe ne e kemi një rregullore ku maksimumi për amvisëri është 3000 euro ndërsa për biznes është deri në 5000 euro. E kemi rregulloren për të cilën ne e kemi sa mundemi me kompensuar. Kështu që jemi në procedura.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit drejtoresh. Fjalën e ka Adrit Krasniqi, pastaj Ilir Gashi.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesuese. Po dua edhe unë ndoshta është pak vonë po me i shpreh ngushëllime familjarëve të të humburit. Po duhet me nda edhe keqardhje për disa kolegë këtu që po tentojnë me politizu situatën. Unë nuk besoj që dikush duke ja nisur prej kryetarit e ekzekutivit e të gjithë qytetarëve që ka dashur me ndodh ajo gjë që ka ndodh me datën 31 dhjetor. Përtej kësaj unë desha me ja bërë një pyetje drejtoreshës. Drejtoreshë a i keni marrë informatat a kanë aplikuar të gjithë palët e dëmtuara në atë afatin shtatë ditor që e keni. Tjetra, a ka mundësi nëse s'kanë aplikuar të gjithë me u hap edhe njëherë një afat brenda ligjit për aplikim? Edhe tjetra nëse e kemi zyrtarin ligjor, kishte qenë e udhës me dalë ai këtu me na treguar çka kemi mundësi ne si kuvendar me e bë. A kemi mundësi me subvencionuar apo cila është baza ligjore e kësaj pike? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Do ta marrim edhe propozimin, mendimin që do ta jep zyrtari ligjor, vetëm le t'i përfundojmë me anëtarët e kuvendit. Ilir Gashi, pastaj Islam Thaçi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zonja kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Në natën e vitit të ri ndodhi një incident i tmerrshëm që rezultoi edhe me humbje jetës së një qytetari, një punëtor i zellshëm nga ky incident dhe po ashtu si shkak pasuan edhe dëmet materiale të shumta, qoftë në

në banesa, qoftë në lokale. Njëra prej tyre ka pësuar dëme të konsiderueshme. Vetëm dëmi material i mallit vlerësohet mbi 50.000 euro dhe po ashtu inventari mbi 15.000 euro, duke mos përfshirë edhe dëme të tjera që i kanë ndodhur lokalit. Dhe krejt kjo pa asnjë faj të atyre pra kanë qenë në shtëpitë e tyre, mbrëmje të viti të ri dhe kur kanë marrë lajmin që ka ndodhur ky incident i tmerrshëm. Dhe tash këta qytetarë që kanë biznese familjare nga e cila edhe jetojnë dhe të gjithë e dimë kush ka biznes familjar se sa vështirë bëhet idare prej asaj, t'ju ngarkohet tash kjo barrë me dhjetra-mija euro që ata me punu edhe pjesën tjetër të jetës tyre vështirë e kanë me e mbulu. E kam qartë që komuna e Prizrenit nuk është kompani sigurimi që i rimbursion dëmet, por duhet të ta kemi parasysh se ka qenë një incident që pak edhe me fajin e komunës, për mos inspektim me kohë. Erdhëm deri në këtë situatë që e humbëm një djalë të ri dhe pësuan shumë dëme materiale. Dhe ta kemi parasysh se ekonomitë familjare, bizneset familjare nuk kanë mundësi të bëjnë sigurime kasko që përfshinë çdo lloj të sigurimit nga çdo formë e incidenteve. Ne si komunë edhe gjatë pandemisë edhe gjatë dëmeve që kanë ndodhur bile edhe jashtë Kosovës, si rasti i tërmetit në Turqi kemi ndarë mjete materiale. Edhe këtë rast duhemi si kuvend komunal, ta ndajmë një buxhet dhe t'i dalim në mbështetje këtyre bizneseve familjare, shtëpive, banimit, banesave që janë dëmtuar si dhe familjes që e ka humbur djalin e tyre, të ndajmë një buxhet dhe t'i dalim në krah atyre në këto momente të vështira për ta. Ashtu qysh kemi vepruar dhe herave të kaluara që ashtu në që atë formë edhe këtë herë të dalim, po normal, pas një vlerësimi të dëmit që besoj se është bërë nga ana e drejtorisë. Ta ndajmë një përqindje, ta marrim atë ne si kuvend dhe t'i rimbursojmë pra edhe njëherë edhe familjen që ka humbur djalin edhe banesat që janë dëmtuar edhe bizneset familjare që kanë pësuar dëme materiale. Faleminderit për dëgjim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit Ilir. Fjalën e ka Islam Thaçi pastaj Petrit Hoxhaj.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese, unë po shoh që zotëri Naim është bërë gati, mirëpo nga mundësitë që i ka ky kuvend, unë po propozoj hapa konkrete. Fillimisht propozoj që të formohet një komision, se e di që ka bazë ligjore edhe mundësi financiare, se buxheti është në dorë të ekzekutivit, kështu që ajo që na duhet në këtë rast është vullneti i të gjithëve që qoftë edhe në formë simbolike të jemi për krah tyre. Propozoj formë konkrete, do të thotë ky kuvend, ta formoj një komision se ligjshmëria ne të gjithë e dimë që për çdo vendim ligjshmëria e çdo akti po shkon në verifikim në Ministrinë përkatëse, e kështu që tash po duhet me shkuar me hapa konkrete, duhet formimin e komisionit nga anëtarët e kuvendit qoftë me tre apo edhe më shumë edhe më pak, edhe një pjesë të ekzekutivit, po vjen keq që nuk është kryetar i komunës këtu edhe drejtorit i financave. Drejtoresha na njoftoi se është një rregullore, ne do t'i përmbahemi asaj rregullores, mirëpo e di që mundësitë financiare janë. Kur janë mundësitë financiare për ekzekutivin të bëhen mjetet nga një kod në kodin tjetër, janë mundësitë edhe për qytetarët e një lagjes që t'ju dalim krah.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese, unë kam një pyetje për drejtoreshën e emergjencës se familja të ndërjet a ka aplikuar në këtë ndihmë që nëse komuna do të jep? Arsyeja është sepse unë, personalisht, i njoh edhe familjarisht dhe dje ka qenë koha kur kam filluar procedurat për mbylljen e biznesit të të ndërjet. Ne mund të folim për çështje materiale, mirëpo këtu ka të bëjë me humbjen e një jete dhe dallon prej fatkeqësive të tjera natyrore që shumica e kolegëve që thonë që prej prej vërshimeve për këto, por kjo e ka specifikën e vetë, dhe mendoj që ne si komunë dhe si

kuvend obligohemi së pakut që dëmet në natën që ka ndodhur ky aksident, duhet t'i kryjë komuna dhe mos presim që të shkojë me vite e me vite për me i kryer ministritë ose kushdo. E di që nuk është në rregull, shumica mendon që bëjnë politikë me këtë rast, por ky është një rast më specifik prej rasteve të tjera dhe jam shumë i bindur që ne si kuvend jemi të gjithë unanimit që të formojmë një komision dhe tek e fundit së paku për këto familje dhe për këto biznese të cilat kanë pasur dëme, që ky kuvend t'i ndihmoj dhe t'ju paguaj. Me të vërtetë ishte shumë shqetësuese dhe shumë jam ndje keq dhe kur kam marrë do thotë dhe kam fillu procedurat për mbylljen e biznesit të të ndjerit dhe nuk e di se a ka aplikuar do thotë në këtë formën e skemës së kësaj ndihmës. Nëse nuk ka aplikuar, a ka kohë, do të thotë a ka afat që edhe familja të aplikojë për biznesin e të ndjerit. Faleminderit.

Ramize Shala-Sinanaj (Drejtoresh e Emergjencave): Dëgjo Petrit. Familja nuk ka aplikuar. Familjes me ja pas dhënë krejt Prizrenin, nuk e kish vyjtë. Ai një djalë e ka humb, tjetrin e ka pas të lënduar rëndë. Edhe për mua është absurd në atë kohë me ardhur ata me këqyrë çka po i ndihmon komuna. Ata kanë ngatë mbas dhimbjes së djalit vetë. Edhe unë nuk e di edhe sot po them prap me ja dhënë krejt Prizrenin, nuk e di a i vyenë familjes. Unë vetë jam prind. Vetë e di çka domethënë me pas dikë të sëmur, ose aq më e keq është me humb dikë, fatmirësisht nuk e kam përjetuar atë. Kështu që kjo është një çështje shumë e ndjeshme. Edhe unë po mendoj që sigurisht as dyshimin më të vogël nuk e kam se është e turpshme me menduar se kjo gjë është politike. Mirëpo nëse mundeme me bë diçka të mirë, po bëjmë. Mirëpo, aq sa na thotë ligji. Unë isha shumë e qartë me të gjithë ju, kompetencat të cilat ne aktualisht i kemi si drejtori edhe si komunë. Për çështje të tjera, janë zyrtarë ligjor, të cilët mund me ju sugjeruar se çka mundeni me bë. Thjesht unë po ju them se rasti pavarësisht që është shumë i ndjeshëm, do të trajtohet njëjtë sikur raste të tjera të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Për më shumë detaje se si me zhvillu këtë procedurë, ndoshta është më mirë të bisedojn zyrtarët ligjor.

Levent Bush (Kdtp): 1:56:50 - 1:58:15

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit kryesuese, shpejt e shpejt. Unë kisha pas qejf sot me pa edhe një farë zyrtar domethënë nga drejtorja e financave. Ata kanë pasur një informat që sot do diskutohet kjo çështje. Po pasi që e pashë edhe Naimin, domethënë besoj që edhe Naimi mund të na jepë neve sqarim lidhur me aspektin ligjor. Po po mendoj që kuvendi ka të drejtë edhe ka kompetencë me marrë vendim për mbulimin e shpenzimeve të dëmit. Por është mirë që të formohet edhe komisioni si tha edhe Islami edhe Leventi. Ta formojmë komisionin, komisioni bashkëpunon me drejtorin përkatës edhe të caktohet domethën, totali i dëmit. Domethënë ai duhet me dalë në një shifër. E pastaj në aspektin buxhetor, drejtoret e financave e merr vendimin edhe e zbaton mjetet. Aty s'besoj që ka ndonjë tejkalim kompetencave apo diçka. Krejt varet domethënë kuvendi a ka vullnet me marrë vendim apo jo.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Këtu është një rast i rëndë që edhe me diskutu është goxha vështirë sepse ne kemi humbur aty një djalë, një djalë të ri që edhe ai ka dalë në punën e vetë për me ekzist. E këtu ne duhet me dalluar këtë rast, këtë fatkeqësi me fatkeqësi të tjera që kanë ndodhur, fatkeqësitë natyrore. Ky rast shumë i rëndë. Njeri këtu edhe shpreh për rastin edhe familjes me i shpreh ngushëllime. E unë nuk deshta me diskutu sepse thashë është shumë rast i rëndë po e pashë që pjesa dërmuese e morët fjalën. Edhe të gjithë jeni që të ndihmohet, të gjithë të

gjendet një zgjidhje. Edhe na jep edhe zyrtari tash edhe ky, besoj që na informon mirë edhe drejtoresha që të përkrahet edhe t'i ndihmojmë. Sepse është me të vërtetë rast, rast i rëndë pra. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zotëri Quni. Atëherë zotëri Naim fjala për ju. Ju lutem t'i keni parasysh edhe kërkesat e anëtarëve të kuvendit, kështu që ta bëjmë një zgjidhje nëse kemi mundësi.

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Unë u mundova me i ndëgju kolegët, po mendoj deputetët. Për sa i përket komisionit është vendim i juaj, por ju e dini që është një komision që ka formuar kryetari për të gjitha rastet e fatkeqësive natyrore, konform ligjit për fatkeqësi natyrore. Tash po më duket dyfishim edhe nuk e di sa është i nevojshëm për këtë rast.

Dafina Alishani (LVV): Ku është ai komision?

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Po së pakut Urimi është një far Jakup Kastrati janë një pesë anëtarë. Ata dalin janë komision katër vjeçar me mandat, me sa e di unë që ashtu është. Po, edhe ata janë në punë që e din drejtoresha, janë në proces i sipër të hartimit të raporteve. Për sa i përket subvencionimit, rregullorja për subvencione nuk e ka pasur një kompetencë që i ka ja ka lënë kuvendit me nda mjete. Për subvencionim e kam fjalën, pare kesh subvencione. Edhe se di a mundet kuvendi me interferu, përveç se me i rekomanduar kryetarit. Jo me marrë vendim, për shembull do ja 10.000, 12.000, 17.000, vetëm me i rekomanduar kryetarit të komunës ose ekzekutivit që me pas parasysh këtë çështje në afat sa më të shkurtër mundshëm. Për tjetër se s'po di çka me i thën.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po Dafina urdhëro pastaj edhe Sevil.

Dafina Alishani (LVV): Pastaj po thuhet mos e politizoni po kjo nuk është në rregull se prej takimit të KPFe-së, edhe ekzekutivi, edhe kryetari besoj që e ka informatën që kjo pikë do të diskutohet. Meqë paska pasur komision vlerësues që e ka këtë detyrë, ishte dashur sot komisioni me ardh këtu në kuvend edhe me i informuar edhe banorët të cilët janë këtu prezent, edhe anëtarët të cilët kanë vullnet me bë një gjë të tillë. Tash, problemi është që vullneti politik po mungon. E tani thoni mos bëni politikë. Ne hajde po e formojmë edhe një komision. Po edhe sa kanë me e prit këta banorë të cilët janë dëmtuar financiarisht, nuk po flas pjesën e humbjes të jetës së djalit, se ajo ka ardhur për shkak neglizhencës, për shkak arrogancës qëtu që ne vazhdimisht themi, na merrni parasysh kërkesat. Kemi pasur kërkesë të caktume nga Ilir Gash. Veç që s'ju ka vizatuar që zot runa ka me ndodh diçka edhe ndodhi fatkeqësisht. Unë nuk jam në atë pjesën tash me diskutuar kush është dëmtuar më shumë, kush më pak. Meqë është futur në rend ditës, sot është dashur na me ditur më së pari punën e këtij komisionit se ideja e futjes në rend ditës është se nuk ka pasur përgjigje prej komisionit. Edhe banorët në hall kanë ardhur tek kuvendarët. E tash nëse ne bëjmë demagogji këtu. Del zyrtari thotë komision kemi, del dikush tjetër thotë AME-në e presim, del dikush tjetër thotë po bëni politikë, fund ditës këta banorët a kanë me pas zgjidhje prej komunës a jo, kaq. Edhe kur është mundësia me subvencionu, kemi subvencionuar këtu këto kompani të autobusëve, e s'po mundemi me subvencionuar një lagje e cila ka ka përjetuar tmerrin natën e festës, edhe për çfarë jemi ne këtu? Mua po më duket pak e jo arsyeshme nëse asnjëri përgjegjës përveç drejtoreshës që e falënderoj, ishte dashur me qen inspektoriati këtu me na tregu ku kanë

dështur inspektoriati. Ishte dashur me na tregu kryetari, kush ka marrë vërejtje për këto lëshime. Ishte dashur me qenë edhe drejtori i urbanizmit me thënë dëgjoni, drejtorja e emergjencave ka këtë kompetencë, maksimumin e ka këtë, po banesën unë e meremetoj me një kod buxhetor të cilën e kemi për meremetime. Drejtorja e shërbimeve publike ishte dashur me u deklaruar me thënë komplet lagjen ku ka mundësi me ndërhyrë, ndërhyjmë kur ka vullnet politik. A kur s'ka, kemi heshtje edhe kemi tash arsye time jo ju mundeni, jo ju s'mundeni. Kjo është tipik mungesë e vullnetit politik. Kaq.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Po zonja Sevil fjalën.

Sevil Kazaz (e pavarur): 2:05:20 – 2:05:20

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju kisha lutur për një takim pesë minuta nga një anëtar të subjektit të partive politike dhe po vendosim bashkë me zyrtarin çfarë po bëjmë.

PAS TAKIMIT

Atëherë, të nderuar koleg-kuvendar, meqë informatat e sotme nuk qenë të mjaftueshme për të marrë ndonjë vendim më konkret. Ne si përfaqësues të subjekteve politike u pajtuam që në seancën e radhës e cila do të mbahet, komisioni për vlerësimin e dëmeve që është i themeluar nga komuna, të vijë këtu më detajisht të na raportojnë në mënyrë që të kemi informata më të detajuara. Pra do të jetë përsëri si pikë e rendit ditës në mbledhjen e ardhshme. Ky ishte dakordimi për me marrë informata ma të tytjeshme. Unë duke ju falenderu për pjesëmarrjen gjithashtu të gjithë besimtarëve muslimanë ua uroj edhe muajin e shenjtë të ramazanit.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi

